



ZHVILLIMI DHE EDUKIMI I FËMIJËVE 0-3 VJEÇ



Save the Children



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



KORNIZA KURRIKULARE DHE KURRIKULA BËRTHAMË
PËR FËMIJËRINË E HERSHME 0-3 VJEÇ



ZHVILLIMI DHE EDUKIMI I FËMIJËVE 0-3 VJEÇ

KORNIZA KURRIKULARE DHE
KURRIKULA BËRTHAMË PËR
FËMIJËRINË E HERSHME 0-3 VJEÇ

Ky material mundësohet në kuadër të projektit “Drejt Arsimit Gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët në moshë parashkollore në Shqipëri” që mbështetet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe Save the Children si dhe zbatohet në partneritet me MEDPAK dhe Universitetin e Bolonjës.

Autorë:

Arjan Kamburi- Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
Olger Brame - Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Konsulente: Dhurata Nixha - Save the Children në Shqipëri

Redaktor gjuhësor: Olger Brame

© Të gjitha të drejtat të rezervuara

Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit për zhvillim politikash dhe praktikash arsimore, prej edukatorëve/kujdestarëve të shërbimit për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme dhe jo vetëm, por jo për qëllime fitimprurëse, pa patur nevojë për të marrë leje më parë nga Save the Children, por në çdo rast duke cituar burimin, nga i cili janë marrë.

Këndvështrimet e autorëve të këtij publikimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

TABELA E PËRMBATJES

LISTA E SHKURTIMEVE	5
PËR JU PËRDORUES	6
PJESA I : HYRJE NË KORNIZËN KURRIKULARE PËR FOSHNJËRINË DHE FËMIJËRINË E HERSHME	7
KUADRI I PËRGJITHSHËM	7
QËLLIMI I KORNIZËS KURRIKULARE	8
PARIMET THEMELORE	9
MARRËDHËNIET	10
FUSHAT E ZHVILLIMIT	11
NDIKIMET NË ZHVILLIM DHE NË TË NXËNË	11
LOJA	12
PERIUDHA E FËMIJËRISË SË HERSHME 0-3 VJEÇ - KONTEKSI	13
STRUKTURA - ORGANIZIMI I KURRIKULËS NË NIVELE	14
PROCESI I TË NXËNIT	14
PJESA II: KURRIKULA BËRTHAMË PËR FOSHNJËRINË DHE FËMIJËRINË E HERSHME 0-3 VJEÇ	17
PLANIFIKIMI I KURRIKULËS	17
CIKLI I PLANIFIKIMIT TË KURRIKULËS	19
PARTNERITETI ME FAMILJET NË PLANIFIKIMIN E KURRIKULËS	21
PARIMI 1: Njohja dhe respekti	21
PARIMI 2: Komunikimi i dyanshëm	22
PARIMI 3: Vendimmarrja e përbashkët	22
PARIMI 4: Njohja dhe pranimi i diversitetit	22
PARIMI 5: Krijimi i rrjeteve mbështetëse	22
TERMA SPECIFIKË QË DUHET TË MBAHEN PARSYSH	23
FUSHA: ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL	24
Nënfusha: Atashimi.....	26
Nënfusha: Shprehja e emocioneve	28
Nënfusha: Marrëdhënia me të rriturit.....	30
Nënfusha: Koncepti për vetveten.....	32
Nënfusha: Marrëdhënia me moshatarët	34
Nënfusha: Empatia	36
FUSHA: SHËNDETI, MIRËQENIA FIZIKE DHE ZHVILLIMI MOTOR	39
Nënfusha: Aftësitë motorike bazë.....	41
Nënfusha: Aftësitë motorike fine.....	43
Nënfusha: Zhvillimi i aftësive senso-lëvizore	46
Nënfusha : Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten	49
FUSHA: ZHVILLIMI GJUHËSOR, KOMUNIKIMI DHE LEXIM-SHKRIMI	51
Nënfusha : Komunikimi Social.....	53
Nënfusha: Komunikimi marrës (receptiv).....	55
Nënfusha: Komunikimi shprehës (ekspresiv).....	57
Nënfusha: Lexim-shkrimi fillestar	59

FUSHA: ZHVILLIMI KONJITIV	61
Nënfusha: Zhvillimi i konceptit.....	64
Nënfusha: Kujtesa.....	66
Nënfusha: Marrëdhëniet hapësinore	68
Nënfusha: Të menduarit simbolik.....	71
Nënfusha: Shprehja krijuese.....	73
Nënfusha: Logjika dhe arsyetimi	75
Nënfusha: Sasia dhe numrat.....	77
Nënfusha: Konceptet shkencore dhe eksplorimi.....	79
Nënfusha: Siguria dhe mirëqenia.....	82
FUSHA: QASJET NDAJTË NXËNIT	84
Nënfusha: Kurioziteti & Nisma.....	86
Nënfusha: Zgjidhja e problemeve.....	88
Nënfusha: Besimi & Marrja e rrezikut.....	90
Nënfusha: Këmbëngulja, Përpjekja dhe Vëmendja.....	93
Nënfusha: Krijueshmëria dhe Imagjinata	95
PLANIFIKIMI DHE PROJEKTI EDUKATIV/PEDAGOGJIK.....	97
ELEMENTËT E PROJEKTIT EDUKATIV.....	99
PROJEKTIMI EDUKATIV	102
MODELE TË NJËSIVE EDUKATIVE.....	106
PLAN NDËRHYRJEVAZHDIMËSIEVERTIKALE (NGA ÇERDHJA NË KOPËSHT).....	113
VËZHGIMI DHE VLERËSIMI	114
DOKUMENTIMI SI REFLEKTIM MBI PËRVOJËN	115
ROLET DHE FUNKSIONET E PERSONELIT NË ÇERDHE.....	115
Drejtuuesi i institucionit të çerdhes	115
Roli i koordinimit pedagogjik (koordinatori pedagogjik).....	115
Edukatori në çerdhe	116
Personeli ndihmës në çerdhe.....	117
BIBLIOGRAFIA.....	129

LISTA E SHKURTIMEVE

ECEC	– Early Childhood Education and Care
FFH	– Foshnjëria dhe Fëmijëria e Hershme
ISSA	– International Step by Step Association
IZHA	– Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KDF	– Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
MASHT	– Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NE	– Njësia Edukative
OECD	– Organization for Economic Co-operation and Development
PE	– Projekt Edukativ
UNESCO	– United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
UNICEF	– United Nations International Children's Emergency Fund

PËR JU PËRDORUES

Kjo paketë udhëzuese është produkt i bashkëpunimit të Departamentit të Edukimit të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë me Save the Children në Shqipëri, falë edhe përvojës së fituar nga Departamenti i Edukimit “Giovanni Maria Bertin” i Universitetit të Bolonjës, bashkëpunim i cili mundësoi të hapet për herë të parë në Shqipëri një program studimi universitar kushtuar edukimit në foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme.

Ne këtë dokument jemi përqendruar në projektimin e një dokumenti në formën e një kornize kurrikulare për grupmoshën 0-3 vjeç dhe hartimin e një udhëzuesi në formën e kurrikulës bërthamë për këtë grupmoshë, duke mbajtur parasysh linjën e kurrikulës për grupmoshën 3-6 vjeç

Palët e interesuara, të përfshira në këtë projekt, u nxitën nga qëllimet e mëposhtme për këtë paketë udhëzuese:

- Udhëzimet do t’ju vijnë në ndihmë, profesionistëve në fushën e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve 0-3 vjeç, me qëllim që të mund të projektohet se çfarë ndodh çdo ditë me këta fëmijë në mjedisin e çerdhës.
- Udhëzimet do t’ju vijnë në ndihmë që të kuptojnë dhe diskutojnë zhvillimin e fëmijëve 0-3 vjeç dhe praktikatat e të nxënësve në varësi të moshës.
- Udhëzimet do t’ju vijnë në ndihmë profesionistëve që të pajisen më mirë me njohuri për të planifikuar ndërveprime të qëllimshme me fëmijët 0-3 vjeç.
- Udhëzimet do t’ju vijnë në ndihmë që të forcojnë angazhimin e profesionistëve ndaj praktikave zhvillimore të përgjegjshme dhe të përshtatshme me fëmijët 0-3 vjeç.
- Shpresojmë që udhëzimet të përmirësojnë sistemin e besimit rreth natyrës individuale të trajektores së zhvillimit dhe rolit thelbësor që luan familja dhe konteksti në zhvillimin e secilit fëmijë të grupmoshës 0-3 vjeç.

Përmes kësaj pune ne po përpiqemi të krijojmë një grup të përbashkët besimesh rreth asaj që fëmijët 0-3 vjeç duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë, si dhe duke evidentuar se cila është përgjegjësia për të parë këto rezultate te fëmijët e kësaj grupmoshe.

PJESA I HYRJE NË KORNIZËN KURRIKULARE PËR FOSHNJËRINË DHE FËMIJËRINË E HERSHME

KUADRI I PËRGJITHSHËM

Shërbimet për foshnjat dhe fëmijët e vegjël deri në moshën tre vjeç po bëhen gjithnjë e më shumë fokus i politikave kombëtare, kërkimit dhe mbështetjes financiare. Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve deri në tre vjeç në shërbimet e fëmijërisë së hershme po rritet. (OECD, 2001); (UNESCO, 2014), sepse realisht, të nxënët dhe edukimi nuk fillojnë me shkollimin e detyrueshëm, por ato fillojnë që nga lindja. Vitet e para nga lindja deri në moshën shkollore janë vendimtare në aspektin formues në jetën e fëmijëve dhe vendosin themelet për zhvillimin e përjetshëm të fëmijëve dhe modelet e tyre për jetën. Në këtë kontekst, edukimi dhe kujdesi me cilësi të lartë që në fëmijërinë e hershme është një element thelbësor për të nxënët e suksesshëm të të gjithë fëmijëve, integrimin shoqëror dhe zhvillimin personal të tyre. (European Commission, 2014).

Historikisht, ka qenë e mjaftueshme në shumë kultura që për fëmijët nën tre vjeç do të ishte e mjaftueshme që ata të mbaheshin të sigurt, të pastër dhe të ushqyer. Sot dihet se të nxënët fillon që para lindjes dhe se të gjitha përvojat që përjeton një fëmijë janë përvoja të nxëni, pavarësisht nëse synojnë të jenë të tilla apo jo. Fëmijët nën tre vjeç mësojnë veçanërisht përmes proceseve të të tjerëve që kujdesen për ta. Ata mësojnë nëse janë vlerësuar dhe nëse dëgjoen dhe respektohen kur komunikojnë. Përveç kësaj, ata mësojnë të koordinojnë lëvizjet e trupit, së bashku me një gamë të gjerë aftësish të ndihmës për veten, vetërregullimit, shoqërizimit dhe komunikimit që ata do të përdorin gjatë gjithë jetës së tyre.

Kujdesi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme përfshin të gjitha llojet e mbështetjes për të cilat ka nevojë një fëmijë i vogël për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar në jetë, pra shëndetin, ushqyerjen, zhvillimin psiko-emocional, krijimin e mundësive për arsimim dhe të mësuarin aktiv. Vitet e hershme të jetës janë kritike për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës dhe vendosin themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë mbi sjelljen, të mësuarin dhe shëndetin e tyre. Ndërhyrjet e hershme për promovimin e zhvillimit të fëmijës gjatë kësaj periudhe kritike kanë përfi time afatgjata në gjithë jetën e fëmijëve tanë. (Unicef & Ministria e Shëndetësisë, 2005)

Duke pranuar se "*cilësia*" është një vlerë që evoluon vazhdimisht, rrënjët e saj artikuloen në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (KDF) dhe Udhëzuesin për Komente të Përgjithshme të KDF për fëmijërinë e hershme.

Mosofrimi i shërbimeve të përshtatshme për fëmijët në vitet e tyre të hershme, që konsiderohen dhe vitet më të rrezikuara, është një shkelje e të drejtave themelore të njeriut. KDF përcakton të drejtat e çdo fëmije, duke përfshirë: të drejtën për jetë, mbijetesë dhe zhvillim; mosdiskriminim; angazhim për t'u përqendruar në interesat e tyre më të mira dhe respektim për ndjenjat dhe pikëpamjet e tyre. Një qasje e bazuar në të drejta buron nga besimi se fëmijët e vegjël dhe familjet e tyre kanë të drejtë për politika mbështetëse, shërbime cilësore dhe përvoja që nga fillimi i jetës.

Çdo e drejtë e përcaktuar në KDF është e natyrshme për dinjitetin njerëzor dhe zhvillimin harmonik të çdo fëmije. Ajo pasqyron një vizion të ri të fëmijës si qenie njerëzore që janë subjekt i të drejtave të tyre. Konventa ofron një vizion të fëmijës si individ dhe si anëtar i një familjeje dhe bashkësie me të drejta të përshtatshme për moshën e tij dhe për fazat e zhvillimit. Duke njohur të drejtat e fëmijëve, në këtë mënyrë, Konventa vendos në mënyrë të fuqishme fokusin për fëmijën në tërësinë e tij. Ajo i mbron ato të drejta, duke vendosur standarde në kujdesin shëndetësor, edukim dhe shërbime ligjore, civile dhe sociale (UNICEF, 2014).

Komisioni Evropian, bazuar në një analizë të provave të fundit ndërkombëtare dhe diskutimeve me ekspertë të nivelit të lartë, ka theksuar që qasja në shërbimet gjithëpërfshirëse me cilësi të lartë, është e dobishme për të gjithë. Propozimi për parimet kryesore të një Kornize të Cilësisë në kontekstin e politikës evropiane përqendrohet në çështjet transversale dhe përfshin dhjetë deklaratat e gjera veprimi, secila prej të cilave është një ftesë për shtetet anëtare për të forcuar cilësinë e ECEC¹. Ndër këto propozime bazohen pritshmëri të mëdha dhe kërkohet mes të tjerash:... një kurrikul e bazuar në qëllimet pedagogjike, vlerat dhe qasjet që u mundësojnë fëmijëve të arrijnë potencialin e tyre të plotë në një mënyrë gjithëpërfshirëse; një kurrikul e cila kërkon që personeli të bashkëpunojë me fëmijët, kolegë dhe prindërit dhe të reflektojë në praktikën e tyre. (European Commission, 2014).

QËLLIMI I KORNIZËS KURRIKULARE

Korniza Kurrikulare për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme (FFH) synon t'u sigurojë profesionistëve të fëmijërisë së hershme një strukturë se si ata mund ta përdorin atë për të marrë vendime të informuara në lidhje me praktikën e kurrikulës.

Ky dokument paraqet udhëzime të përgjithshme për planifikimin e mjediseve të të nxënimit dhe përvojat për foshnjat dhe fëmijët e vegjël të moshës 0-3 vjeç. Korniza ka për qëllim të jetë në përputhje dhe në koherencë me kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor të Shqipërisë. Korniza Kurrikulare për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme synon të jetë një dokument themelor nga i cili rrjedhin të gjithë dokumentet e tjerë, që përmbushin qëllimin e mirërritjes dhe të edukimit të foshnjave dhe fëmijëve në moshat 0-3 vjeç.

Në ndërtimin e këtij dokumenti u jemi referuar teorive më të njohura të zhvillimit të fëmijës, të cilat janë të konfirmuara, duke mbajtur parasysh strategjitë për të ndërtuar kompetencat e foshnjave dhe fëmijëve, interesat në fushat kryesore zhvillimore, si dhe përshkrimin e llojeve të mjediseve dhe materialeve që lidhen me foshnjat dhe fëmijët e vegjël gjatë procesit të të nxënimit.

Një konsideratë themelore në planifikimin individual të kurrikulës për foshnjat dhe fëmijët, u përgjigjet kompetencave, përvojave, interesave dhe nevojave që çdo fëmijë sjell në mjedisin e çerdhes, duke mbajtur parasysh diversitetin e tyre në aspektin kulturor, gjuhësor, diversitetin në aftësi dhe me prejardhje të larmishme socio-ekonomike. Gjithashtu partneriteti me familjen është një strategji e rëndësishme për t'u përgjigjur individualisht fëmijëve. Një faktor gjithnjë e më i spikatur në diversitetin e fëmijëve, janë përvojat e tyre të hershme me gjuhën. Zhvillimi i gjuhës dhe i lexim-shkrimit, ndihmon në suksesin e fëmijëve të vegjël në shumë mënyra të ndryshme.

1. ECEC i referohet çdo marrëveshjeje të rregulluar që siguron arsim dhe kujdes për fëmijët që nga lindja deri në moshën e detyrueshme të shkollës fillore.

Diversiteti socio-ekonomik është një tjetër prirje që meriton vëmendje. Përçindja e fëmijëve që jetojnë në familje me të ardhura të ulëta është e lartë. Në të njëjtën kohë, përfitimet e kujdesit dhe edukimit me cilësi të lartë janë më të dukshme për fëmijët me që vijnë nga familje me nivel më të ulët socio-ekonomik sesa për nëngrupet e tjera të popullsisë. Fëmijët me familje me nivele të ndryshme socio-ekonomike kanë më shumë të ngjarë të përfitojnë nga kujdesi dhe edukimi me cilësi të lartë kur kurrikula fokusohet në pikat e forta dhe nevojave të tyre edukative.

Fëmijët me aftësi të kufizuara ose nevoja të tjera të veçanta është një element tjetër që mbahet parasysh në ndërtimin e një kurrikule. Fëmijët me aftësi të kufizuara ose nevoja të tjera të veçanta përfitojnë nga mësimi në mjedise gjithëpërfshirëse me fëmijë zakonisht në zhvillim.

Studimet kanë treguar që me mbështetje dhe ndihmë të përshtatshme, fëmijët në mjedise gjithëpërfshirëse arrijnë më shumë sesa fëmijët në mjedise të ndara. Siç sugjerojnë studimet, diversiteti i fëmijëve të vegjël do të thotë që çdo program për këtë grupmoshë ka nevojë për

një qasje fleksibël ndaj kurrikulës në mënyrë që të jetë përgjegjës për të gjithë fëmijët që hyjnë në dyert e saj. (California Department of Education, 2012, pp. 2-5).

PARIMET THEMELORE

Në hartimin e parimeve mbi të cilat ndërtohet ky dokument, janë mbajtur parasysh parimet e përgjithshme në arsimin parashkollor, të cilat kanë shërbyer si referenca kryesore (IZHA & UNICEF, 2016) duke e përshtatur me kontekstin çerdhe dhe duke i harmonizuar me principet bazë të Kornizës Kurrikulare për Fëmijërinë e hershme të Kalifornisë. (California Department of Education, 2012) dhe sidomos parimet e edukimit në fëmijërinë e hershme të paraqitura në kurrikulën bërthamë për edukim në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç të Kosovës.

Kryesisht këto prime mbajnë parasysh:

Çdo fëmijë është i gatshëm të mësojë që nga lindja e tij

Të gjithë fëmijët janë të gatshëm të zhvillohen dhe të mësojnë që nga lindja, me karakteristika dhe mënyra të ndryshme. Stimulimi, nxitja, përkrahja dhe udhëzimet e edukatorëve/kujdestarëve krijojnë mundësi që fëmijët të zhvillohen dhe të pasqyrojnë fuqimisht në periudhë më të vonshme.

Barazia

Kjo nënkupton sigurinë që fëmijët të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh gjininë, dallimet socio – ekonomike, përkatësinë fetare, dhe nevojat e tyre të ndryshme.

Gjithëpërfshirja

Nëpërmjet këtij parimi pranohet se kurrikula njeh, pranon, respekton dhe u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave dhe vlerave të të gjithë fëmijëve, duke u dhënë mundësinë të zhvillojnë mundësitë e tyre.

Zhvillimi dhe të nxënët e integruar

Nëpërmjet këtij parimi synohet zhvillimi tërësor i fëmijëve dhe nxitja e të nxënët të integruar, që ndërtohet në mënyrën më të plotë kur fëmijëve u ofrohen mundësi të pafundme.

Të nxënët nëpërmjet lojës

Loja përcaktohet si elementi thelbësor që siguron të nxënët dhe zhvillimin e fëmijëve.

Pjesëmarrja aktive

Filozofia bazë sipas këtij parimi lidhet me “Fëmija në qendër të gjithë procesit”, gjë që mundëson zhvillimin dhe të nxënët e tij, duke u ballafaquar me sfida.

Bashkëpunimi

Në bazë të këtij parimi çdo element bashkëpunues me natyrë edukative konsiderohet si domosdoshmëri, sepse ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Elementë të rëndësishëm konsiderohen familja, institucioni i çerdhës, komuniteti dhe të gjithë faktorët e tjerë lokalë apo qendrorë.

Autonomia, fleksibilitet dhe përgjegjësia në nivel institucional

Kjo nënkupton se secili institucion i çerdhëve është i lirë që, bazuar në kushte e veta, të jetë autonom në hartimin e programve dhe projekteve pedagogjike, duke u mbështetur në kornizën e kurrikulës. Në këtë mënyrë krijohet fleksibilitet dhe frymëmarrje në projektimin dhe ecurinë e veprimtarisë së institucionit të çerdhës, duke justifikuar institucionalisht përgjegjësinë për zgjedhjet e bëra, në varësi të kushteve konkrete. (MASHT, 2018, pp. 9-10).

Kuadri i kurrikulës së foshnjërisë dhe fëmijërisë së hershme që mbështetet në këto parime kyçe, përpiket të sigurojë një vështrim gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm të zhvillimit të fëmijëve, nga ku mund të përmbledhim: (University of Illinois, 2012, pp. 2-5)

- Marrëdhëniet e hershme janë më të rëndësishmet dhe thelbësore për zhvillimin e fëmijëve të vegjël.
- Zhvillimi ndodh në fusha të shumta dhe të ndërvarura në mënyrë të njëkohshme.
- Fëmijët zhvillohen dhe mësojnë me ritmin e tyre unik dhe në kontekstin e familjes, kulturës dhe komunitetit të tyre.
- Loja është mënyra më e kuptueshme që fëmijët mësojnë dhe zotërojnë aftësi të reja.

MARRËDHËNIET

Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive me fëmijët e vegjël është detyrë thelbësore dhe një përbontekstit të të nxënët. Të gjithë fëmijët rriten dhe ecin përpara në kontekstin e marrëdhënieve të ngushta dhe të besueshme që ofrojnë dashuri dhe ushqim, siguri dhe ndërveprime të përgjegjshme. Një marrëdhënie pozitive e rritur dhe fëmijë e ndërtuar mbi besimin, mirëkuptimin dhe kujdesin do të nxisë bashkëpunimin dhe motivimin e fëmijëve dhe do të rrisë rezultatet e tyre pozitive në drejtim të të nxënët (Webster-Stratton, 1999).

Të nxënët e hershëm ndodh në kontekstin e marrëdhënieve. Marrëdhëniet pozitive dhe të sigurta janë themeli për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve në të gjitha fushat dhe ofrojnë modele për marrëdhëniet e ardhshme që ata do të krijojnë. Këto marrëdhënie u japin fëmijëve sigurinë dhe

mbështetjen e nevojshme për të eksploruar me besim mjedisin, për të provuar aftësi të reja dhe për të realizuar detyra. Fëmijët, të cilët kanë lidhje të forta, pozitive me të rritur të rëndësishëm në jetën e tyre, i përdorin këto marrëdhënie për të komunikuar, për të drejtuar sjelljen dhe për të ndarë emocione dhe arritje. Këto ndërveprime dhe marrëdhënie domethënëse janë thelbësore për zhvillimin e fëmijëve, sepse i ndihmojnë ata të kuptojnë se kanë një ndikim domethënës në botën e tyre dhe njerëzit përreth tyre. (University of Illinois, 2012) .

FUSHAT E ZHVILLIMIT

Zhvillimi i fëmijëve shihet përmes fushave kryesore të zhvillimit: zhvillimit shoqëror, emocional, zhvillimit fizik dhe mirërritjes, zhvillimit gjuhësor dhe zhvillimit njohës. Fëmijët zhvillohen në këto fusha në të njëjtën kohë, me secilën fushë zhvillimi të varur nga rritja në të gjitha fushat e tjera. Mund të ketë raste kur fëmijët duket se përqendrohen në një fushë të veçantë të zhvillimit, ndërkohë që kanë një rritje të vogël në një fushë tjetër. Për shembull, një fëmijë 12-muajsh që përqendrohet në gjuhë, mund të mos shfaqë ndonjë interes të ecë vetë. Pastaj, disa javë më vonë, fëmija papritmas fillon të ecë. Ky është një shembull i mënyrës se si rrjedh zhvillimi dhe, megjithëse mund të duket se mund të "ngecin" në periudha të caktuara, fëmijët në të vërtetë rriten dhe nxënë në të gjitha fushat në çdo kohë. (University of Illinois, 2012)

NDIKIMET NË ZHVILLIM DHE NË TË NXËNË

Fëmijët kanë një ecuri që shtrihet në vazhdimësi ndërsa zhvillohen dhe secili prej tyre do të arrijë pikat e tij të zhvillimit me ritmin e tij individual përmes përvojave dhe marrëdhënieve të veta. Zhvillimi ndikohet nga faktorë të ndryshëm:

✓ **Kultura**

Kultura luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve, sepse ndikon në praktikat, besimet dhe vlerat e familjeve për fëmijët e vegjël. Synimet për mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve ndryshojnë nga kulturat. Është e nevojshme të kuptojmë se fëmijët nuk e krijojnë kuptimin mbi botën me vetëdije analitike në këtë moshë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që profesionistët që merren me fëmijërinë e hershme të njohin dhe reagojnë me ndjeshmëri ndaj larmisë së kulturës dhe variacioneve gjuhësore që shfaqin familjet dhe fëmijët. Domethëniet janë të bazuara në lidhje trupore me gjërat dhe janë vazhdimisht të lidhur me procesin e të vepruarit. Gjatë periudhës nga lindja deri në moshën 5 vjeç, fëmijët pësojnë shndërrime masive në madhësi, organizim biologjik, aftësi të sjelljes dhe organizim shoqëror të përvojës që e komplikojnë shumë kuptimin tonë për lidhjen midis kulturës dhe proceseve të tyre të të mësuarit. (M.Cole, P. Hakkarainen & M. Bredikyte, 2012.)

✓ **Dallimet në aftësitë e të nxënit të fëmijëve**

Hulumtimet tregojnë se ka ndryshime të mëdha zhvillimore në mënyrën se si nxënë fëmijët. Ndërsa fëmijët zhvillohen, ata formojnë mënyra të reja të përfaqësimit të botës dhe gjithashtu ndryshojnë proceset dhe strategjitë që përdorin për të manipuluar këto përfaqësime. Fëmijët kanë aftësi të ndryshme zhvillimi dhe stile të ndryshme të të nxënit që ndikohen nga koha dhe mënyra e arritjes së pikave të tyre të zhvillimit. Të gjithë fëmijët janë unikë dhe këto dallime

duhet të merren parasysh kur kujdesemi për ta. Është e rëndësishme që të nxitim pranimin dhe vlerësimin e dallimeve në aftësitë e të nxënit, me qëllim që të lidhim qëllimet individuale për fëmijët. (S.Vosniadou, 2001)

✓ **Temperamenti**

Temperamenti u referohet tipareve unike të personalitetit që janë të lindura me fëmijët. Temperamenti ndikon në atë se si fëmijët reagojnë në botën rreth tyre dhe se si të tjerët do të bashkëveprojnë me ta. Disa fëmijë janë bindës dhe duan të provojnë gjëra të reja. Të tjerët janë më të ngadalshëm për t'u afruar, kanë nevojë për kohë dhe mbështetje nga të rriturit për t'u përfshirë në veprimtari të reja. Të rriturit duhet të jenë të ndjeshëm ndaj temperamentit të fëmijëve dhe të bashkëveprojnë me ta në një mënyrë që të mbështesin temperamentin e tyre për të nxitur ndjenjat e sigurisë dhe të ushqyerit. (Brazelton, 1992)

✓ **Rendi i lindjes**

Rendi i lindjes së fëmijës mund të ndikojë në personalitetin e tij dhe në mënyrën se si ata lidhen me familjen e tyre. Secili fëmijë ka tiparet e veta unike të personalitetit, megjithatë, rendi i lindjes mund të ketë një ndikim në mënyrën se si shprehen tiparet e personalitetit të fëmijëve. Për shembull, fëmijët e mesëm mund të jenë më shoqërorë, sepse kanë përvojë të bashkëveprojnë me një motër/vëlla më të rritur. Fëmijët më të vegjël mund të jenë më këmbëngulës, sepse mund të duhet të punojnë më shumë për vëmendje të pandërprerë. (Shulman, Bernard H. & Mosak, Harold H., 1977, pp. 114-121) .

Dallimet në aftësi, gjuhë, kulturë, personaliteti dhe përvoja, nuk duhet të shihen si deficite, por përkundrazi, të njihen si karakteristika unike që përcaktojnë se cilët janë fëmijët.

LOJA

Shpesh loja përshkruhet si "punë e një fëmije". Loja është thelbësore për mënyrën sesi fëmijët mësojnë dhe kuptojnë botën përreth tyre. Loja është shpesh spontane, e zgjedhur nga vetë fëmija dhe e këndshme. Loja përbëhet nga angazhim aktiv dhe nuk ka ndonjë shpërblim ekstra. (Chen, 2002).

Loja është mjeti me të cilin fëmija zbulon botën

Është shumë e rëndësishme të theksohet se loja **NUK** përfshin të parit e televizorit, lojëra në kompjuter ose pajisje të tjera teknologjike. Fëmijët përdorin lojën për të mësuar në lidhje me botën e tyre fizike, veten dhe të tjerët. Fëmijët përdorin lojën për të zgjidhur ndjenjat e tyre dhe për të eksploruar marrëdhëniet, ngjarjet dhe rolet që kanë kuptim për ta. Loja mundëson ndryshime thelbësore në tri vitet e para. Për shembull, një fëmijë 6-muajsh luan me një objekt thjesht duke e prekur dhe duke e futur atë në gojë; një 18-muajsh e lëviz me qëllim një objekt në një mënyrë të caktuar dhe, një 3-vjeçar, përdor gjuhën dhe veprimet ndërsa luan me një objekt.

Lojë është një nga mënyrat më të rëndësishme me të cilat fëmijët e vegjël fitojnë njohuri dhe aftësi thelbësore. Për këtë arsye, mundësitë e lojërave dhe mjediset që promovojnë lojën, eksplorimin dhe mësimin praktik janë në thelb të programeve efektive të të nxënësve në fëmijërinë e hershme. (UNICEF, 2018).

PERIUDHA E FËMIJËRISË SË HERSHME 0-3 VJEÇ - KONTEKSI

Përvojat e fëmijëve në tre vitet e para të jetës ndikojnë në mënyrën se si ata zhvillohen, mësojnë dhe bashkëveprojnë me botën e tyre. Kjo periudhë karakterizohet nga një sasi e jashtëzakonshme e rritjes dhe vendos themelet për të nxënësit e ardhshëm të fëmijëve dhe zhvillimin e vazhdueshëm të tyre.

Meqenëse në këtë grupmoshë është shërbyer në mënyrë tipike në një model të bazuar në aspektin mjekësor, është promovuar përkujdesja ndaj fëmijëve, e cila ka vendosur më shumë theksin në praktikën e shëndetit dhe higjienës. Sidoqoftë, ky model nuk i pranon pikat e forta dhe nevojat e shumfishta të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe nuk është i mjaftueshëm kur pranon zhvillimin holistik të fëmijëve. Edukimi social dhe emocional për këtë nivel të moshës është po aq i rëndësishëm sa edhe kujdesi fizik. Në mënyrë të ngjashme, cilësia për fëmijët nën tre vjeç nuk është një version i zvogëluar i një programi parashkollor për të promovuar aftësitë e gatishmërisë shkollore. Kjo do të thotë që është e nevojshme një qasje e specializuar. Ofrimi i shërbimit cilësor për fëmijët 0-3 vjeç në mjediset edukative dhe të përkujdesjes është përmendur gjithnjë e më shumë si një *pedagogji e kujdesit*, bazuar në nocionin e një etike të kujdesit në edukimin e hershëm të fëmijërisë. Në këtë aspekt, takimet e konsiderohen të jenë përvoja të përshtatshme të të nxënësve për më të vegjëlit. Një *pedagogji e kujdesit* do të thotë të shkosh përtej administrimit në mënyrë efektive të fëmijëve dhe kryerjes së detyrave bazuar në rutinat dhe procedurat e paracaktuara, duke i konsideruar "*perspektivat etike të përfshira në atë se si një shoqëri kujdeset për qytetarët e saj më të rinj*" (Rockel, 2009)

Pedagogjia e kujdesit pranon që foshnjat dhe fëmijët e vegjël luajnë një rol aktiv në të nxënësit e tyre. Fëmijët nën tre vjeç janë mrekullisht të aftë si partnerë aktivë socialë, të cilët kontribuojnë në mënyrë krijuese në krijimin dhe mbajtjen e ndërveprimeve me të rriturit kryesorë në jetën e tyre. Kjo qasje pranon që zhvillimi dhe të nxënësit përmirësohen kur të rriturit njohin mënyrat individuale me të cilat foshnjat dhe fëmijët e vegjël shprehin dëshirën e tyre për kujdes të përgjegjshëm. Ajo bazohet në konceptin thelbësor se është lidhja e të rriturve dhe fëmijëve dhe raporti ndërpersonal gjatë përkujdesjes së fëmijës që ndërton themelet për të nxënësit dhe zhvillimin dhe se qasja nuk ka të bëjë zyrtarisht me "të nxënësit" e fëmijës. (ISSA, 2016)

STRUKTURA - ORGANIZIMI I KURRIKULËS NË NIVELE

Kurrikula e FFH (0-3 vjeç) është e organizuar në nivele. Secili nivel i referohet karakteristikave të përbashkëta, të cilat shoqërojnë proceset e zhvillimit të fëmijëve. Nivelet, shërbejnë si pika referimi për përcaktimin e aftësitë dhe shkathhtësitë kryesore, të cilat duhen zotëruar respektivisht për secilin nivel nga fëmijët.

Organizimi i kurrikulës në nivele mundëson:

- ➔ respektimin e karakteristikave të zhvillimit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme, me qëllim përcaktimin e procedurave specifike dhe të kompetencave, që duhen zotëruar prej tyre;
- ➔ respektimin e ritmeve individuale që paraqet çdo fëmijë drejt zotërimit të kompetencave të detajuara, në çdo nivel të kurrikulës;
- ➔ fleksibilitet në planifikimin dhe organizimin e procedurave edukative nëpërmjet zgjerimit të ciklit të planifikimit nga një vit në tjetrin;
- ➔ përgatitjen e udhëzimeve të detajuara për organizimin e punës edukative sipas niveleve, duke theksuar fleksibilitetin e regjimit ditor, metodat e të nxënës, ndërthurjen e llojeve të ndryshme të veprimtarive të të nxënës, argëtuese, çlodhëse; vëzhgimin, matjen dhe vlerësimin e zhvillimit të fëmijëve.
- ➔ forcimin e llogaridhënies së institucionit dhe të autoriteteve vendore përkatëse për cilësinë e edukimit që ofrohet në këtë nivel.

PROCESI I TË NXËNËT

Hulumtimet kanë treguar që foshnjat janë të gatshme të mësojnë që nga lindja; ato mund të përvetësojnë informacionin nga pamjet, tingujt dhe aromat rreth tyre, ta ruajnë atë, ta radhisin dhe ta përdorin. Ky informacion ndihmon foshnjat të kuptojnë botën dhe njerëzit përreth tyre.

Hulumtimet kanë treguar gjithashtu se foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë mjaft të varur nga marrëdhëniet parësore për nevojat e tyre fizike dhe emocionale që duhen përmbushur. Të vetëdijshëm për këtë nevojë, edukatorët planifikojnë ndërveprimet e tyre me foshnjat dhe fëmijët e vegjël për të adresuar dobësinë dhe kompetencën e fëmijëve.

Duke vepruar kështu, edukatorët njëkohësisht marrin pjesë në nevojën e fëmijëve për marrëdhënie të ngushtë e të qëndrueshme me ushqimin e të rriturve dhe kuriozitetin dhe motivimin e fëmijëve për të mësuar.

Katër aspektet e zhvillimit të foshnjave theksojnë një qasje të veçantë në planifikimin dhe mbështetjen e të nxënës të tyre: (California Department of Education, 2012, pp. 13-15).

1. Foshnjat ndjekin “programimin” e tyre të të nxënës.
2. Foshnjat mësojnë në mënyrë holistike.
3. Foshnjat përfuturojnë tranzicione të mëdha zhvillimore në tre vitet e para të tyre.
4. Foshnjat janë në proces të zhvillimit të ndjenjës së tyre të parë rreth vetvetes.

1. Foshnjat ndjekin “programimin” e tyre të të nxënit

Në lidhje me përmbajtjen e të nxënit, programimi i të nxënit të foshnjave është shumë më i përqendruar në kompetencat themelore sesa programimi i një fëmije më të rritur. Themelet e të nxënit të mëvonshëm në të gjitha fushat vendosen gjatë foshnjërisë.

Për shembull foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë të prirur:

- për të kërkuar dhe formuar marrëdhënie me njerëz që i ushqejnë dhe i mbrojnë ata;
- për të mësuar gjuhën në mënyrë që të komunikojnë;
- për të ndërtuar njohuri për konceptet

themelore siç janë marrëdhënia midis shkakut dhe efektit dhe mënyrës se si lëvizin, si përshtaten gjërat në hapësirë; etj.

Foshnjat angazhohen në mënyrë aktive në zotërimin e përbërësve të ndryshëm të këtyre kompetencave në kohë relativisht të ngjashme në zhvillimin e tyre. Rruga e zakonshme e të nxënit dhe e zhvillimit të foshnjave, varet plotësisht nga bashkëveprimi i vazhdueshëm me të rriturit.

Pa të rriturit, foshnjat nuk janë në gjendje të ndjekin “programimin” e tyre të të nxënit. Në fakt, një pjesë e këtij programimi të të nxënit, lidhet me bashkëveprimin me të rriturit për të pasur përvoja thelbësore në marrëdhëniet që vendosen mes tyre. Të kuptuarit e këtij programimi të nxënit ndihmon të rriturit të bashkëveprojnë me foshnjat në mënyrë që të lehtësojnë më mirë të nxënët dhe zhvillimin e fëmijëve.

2. Foshnjat mësojnë në mënyrë holistike

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël marrin informacione vazhdimisht, natyrisht dhe rrjedhshëm. Edhe pse ata shpesh përqendrohen në një gjë në një kohë, fokusi mund të ndryshojë shpejt.

Nga veprimet, ndërveprimet dhe vëzhgimet e tyre, ata kapin të gjitha llojet e informacionit që ata përdorin për të ndërtuar njohuri dhe aftësi. Një ndërveprim i vetëm mund të çojë në të nxënë për shumë gjëra në shumë fusha. Megjithatë një fëmijë mund të fillojë një përvojë duke u përqëndruar në diçka me interes në një fushë, përbërësit fizikë, emocionalë, intelektualë, shoqërorë dhe gjuhësorë të asaj përvoje përpunohen pothuajse njëkohësisht.

Për shkak se foshnjat dhe fëmijët e vegjël mësojnë në mënyrë holistike, ato jo gjithmonë mund të përqendrohen në fushën e përmbajtjes që një i rritur dëshiron të theksojë.

Nëse të rriturit strukturojnë ndërveprimin me qëllim që të krijojnë rezultate specifike në një zonë të veçantë përmbajtjeje, për shembull në gjuhë, ata shpesh do të humbasin përvojën më të madhe të të nxënit të fëmijës. Kështu, planet për të ndihmuar në të nxënët e foshnjave krijohen më së miri në mënyra që pasqyrojnë hapjen e fëmijës ndaj të gjitha aspekteve të një përvoje.

3. Foshnjat përjetojnë tranzicione të mëdha zhvillimi në tre vitet e para të tyre

Gjatë tre viteve të para të jetës, pjesa më e madhe e jetës së një fëmije është e organizuar rreth çështjeve që lidhen me sigurinë, eksplorimin dhe identitetin. (California Department of Education, 2012, pp. 16-18)

Siguria

Nga lindja deri në moshën rreth tetë muajsh, shumica e foshnjave organizojnë vëmendjen dhe sjelljen e tyre rreth zhvillimit të një ndjenje sigurie. Gjatë tetë muajve të parë të jetës, foshnjat përqendrohen në kërkimin e sigurisë, ushqimit dhe mbrojtjes. Ata eksplorojnë mjedisin e tyre përmes përdorimit të shqisave dhe përmes aftësisë së tyre gjithnjë e në zgjerim për të lëvizur. Komoditeti fizik dhe kujdesi i përgjegjshëm që ndihmon foshnjat e vogla të rregullojnë veten e tyre, do të ndërtojnë besimin e foshnjave në veten dhe kujdesin e dhënë nga të tjerët.

Eksplorimi

Fokusimi i foshnjave te siguria gjatë tetë muajve të parë të jetës çon në sjellje të organizuar të marrëdhënieve. Gjatë muajve që vijojnë, foshnjat gjithnjë e më shumë përdorin marrëdhënie të ngushta si baza të sigurta për eksplorim. Ato përdorin aftësitë e tyre mendore dhe fizike në rritje për të eksploruar.

Foshnjat nga 8 deri në 18 muaj e shohin veten si eksplorues aktivë, për periudha të shkurtra kohe dhe nuk janë më të lidhur fizikisht me besimin të rriturit. Ata kanë ende nevojë për siguri dhe kontrollojnë në bazën e tyre të sigurt ndërsa hulumtojnë. Në këtë moshë, foshnjat kërkojnë nga edukatorët/kujdestarët e tyre të vërtetojnë shpërthimin e tyre eksplorues dhe të tregojnë besim në kompetencën e tyre në zhvillim. Fëmijët e kësaj moshe ecin përpara kur ata kanë një mjedis të sigurt dhe u lejohe të përdorin edukatorin/kujdestarin si një bazë të sigurt nga e cila ata mund të ecin përpara me fuqinë emocionale, duke mbajtur një lidhje me edukatorin/kujdestarin përmes kontaktit me sy dhe komunikimit me zë.

Identiteti

Foshnjat nga mosha 18 deri në 36 muajsh ndryshojnë fokusin e tyre kryesor drejt identitetit. Ata përqendrohen në çështje të tilla si: *unë dhe mua*, *e mirë dhe jo e mirë* dhe *vetja ime dhe tjeri*.

Ndërveprimet me të tjerët çojnë në të nxënë të veten e tyre si qenie të pavarura, të varura dhe të ndërvarura. Ato interpretojnë ndjenjën e tyre të sigurisë dhe eksplorimet e tyre përmes kësaj mënyre të re. Ato eksplorojnë mjedisin përreth tyre, por edhe mundësitë e tyre për ta ndryshuar atë. Shpesh, ata rezistojnë ndaj atyre që u kanë dhënë siguri emocionale për të parë se sa larg mund të shkojnë vetë ose kur janë të ndarë.

4. Foshnjat janë në procesin e zhvillimit të ndjenjës të tyre të parë rreth vetvetes

Mënyra se si foshnjat ndërtojnë ndjenjën e parë rreth vetvetes realizohet përmes përvojave se si i trajtojnë të tjerët. Foshnjat e vogla besojnë plotësisht dhe janë të hapura për të marrë me padurim mesazhe nga të rriturit që kujdesen për to. Ato përdorin përgjigjet e të rriturve ndaj tyre për të krijuar një "mendim" të parë për veten. Të rriturit kanë ende një ndikim të thellë në ndjenjën e fëmijëve për veten deri në 4 vjeç.

PJESA II KURRIKULA BËRTHAMË PËR FOSHNJËRINË DHE FËMIJËRINË E HERSHME 0-3 VJEÇ

PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël kanë një aftësi të mahnitshme për t'u angazhuar në të nxënë dhe organizojnë sasi të madhe informacioni të ri. Është e qartë që një foshnjë ose fëmijë i vogël, i cili eksploron se si funksionon diçka ose si bashkëvepron me një të rritur ose fëmijë të tjerë, zbulon një mendje aktive që po eksploron dhe ka kuptim për botën përreth njerëzve dhe gjërave. Foshnjat dhe fëmijët e vegjël e përjetojnë botën dhe ndërtojnë njohuri në mënyrë holistike gjatë momenteve të thjeshta të lojës, eksplorimit dhe ndërveprimit me objektet dhe me njerëzit e tjerë.

Mendjet e tyre "thithin" në mënyrë aktive tinguj, fjalë, modele lëvizjeje dhe veprime e reagime të njerëzve, krijesave dhe objekteve. Ata integrojnë informacione të reja në një sistem gjithnjë e më kompleks të njohurive. Ndërsa foshnjat zgjerojnë takimet e tyre me objektet dhe njerëzit, ato provojnë aftësi të shfaqura, zbulojnë veprime të reja dhe përjetojnë ndjenja në mënyra të reja. Në momentet e lojës, ata eksperimentojnë, hetojnë dhe shpikin zgjidhje, duke u përpjekur të kuptojnë se si funksionojnë gjërat.

Planifikimi i kurrikulës së foshnjërisë dhe fëmijërisë së hershme kërkon që edukatorët/ kujdestarët të kuptojnë dhe respektojnë mënyrën se si nxënë foshnjat e kësaj grupmoshe. Kur ata luajnë, ata shpesh fillojnë iniciativën e të nxënit, duke ndërtuar në mënyrë aktive aftësi, koncepte dhe lidhje midis ideve. Zhvillimi i mendimeve në koncepte dhe veprime të reja, ndjenjat në sensin e identitetit dhe fjalët e frazat në përfaqësime të mendimeve, ideve dhe ndjenjave, shpesh ndodhin njëkohësisht.

Në planifikimin e kurrikulës për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme për moshën 0-3 vjeç, edukatorët/ kujdestarët duhet të jenë të vetëdijshëm për atë që foshnjat dhe fëmijët e vegjël bëjnë në lojë, si në rastin kur veprojnë në objekte, ashtu edhe kur bashkëveprojnë me të rriturit dhe moshatarët. Në thelb, loja është "puna" e tyre.

Në hartimin e kurrikulës për këtë grupmoshë, edukatorët/kujdestarët planifikojnë për **tre kontekste mësimore:** (California Department of Education, 2012, pp. 19-27).

1- Mjedisi i lojës si kurrikul

❖ Fushat e interesit për të mbështetur të nxënit e fëmijës përmes lojës

Planifikimi i kurrikulës përfshin zgjedhjen e materialeve për lojëra që shtojnë interesin dhe kompleksitetin në zona të dallueshme ku foshnjat dhe fëmijët e vegjël luajnë lirshëm. Një përzgjedhje e menduar e materialeve fton foshnjat dhe fëmijët e vegjël të eksplorojnë përvojat që sfidojnë aftësitë e tyre në zhvillim, koncepte dhe ide. Kurrikula për këtë grupmoshë përfshin mënyra në të cilat edukatorët/kujdestarët planifikojnë mjediset fizike të brendshme dhe të jashtme për të mbështetur lojën dhe mësimin. Kur mjedisi fizik është planifikuar me mësimin e

ndërmarrë në mendjen e vetë fëmijëve, ata hasin në vende ku mund të eksplorojnë lirshëm se si janë dhe si funksionojnë gjërat. Në një mjedis të tillë, fëmijët hetojnë, shpikin dhe eksperimentojnë. Për të mbështetur lojën e vetiniciuar të fëmijëve dhe të mësuarit gjithëpërfshirës, edukatorët/ kujdestarët krijojnë mjedise me një rrjet të zonave të interesit, secila me një fokus të veçantë dhe inventar të parashikueshëm të materialeve dhe secili përdoret nga mësuesit për të zgjatur kërkimin aktiv të fëmijëve për njohuri. Fushat e interesit janë krijuar për të ofruar një inventar bazë të materialeve me të cilët fëmijët mund të aplikojnë aftësi të reja dhe të zhvillojnë koncepte ndërsa ata luajnë.

Disa shembuj të zonave të interesit në një mjedis për këtë grupmoshë janë:

- një zonë komode për libra dhe tregime;
- një zonë vogël si sallë force;
- një zonë e perceptimit shqisor;
- një zonë me lëvizje aktive;
- një zonë e shprehjes krijuese

Me të njëjtin qëllim, edukatorët/kujdestarët konsiderojnë cilat përshtatje duhet të jenë bërë për të siguruar akses më të madh për fëmijët me aftësi të kufizuara ose nevoja të tjera të veçanta. Si mjediset e brendshme, ashtu dhe ato të jashtme duhet të ofrojnë mundësi për të krijuar zona interesi që zgjasin lojën e fëmijëve, eksplorimin dhe "kuptimin e të bërit" nga fëmijët në mënyra të shumta.

❖ **Koha e pandërprerë për kërkime dhe lojë në mjedis**

Për të përfituar plotësisht nga mundësitë e mësimit të ofruara nga zonat e interesit, fëmijëve u duhet kohë e gjatë dhe e pandërprerë për lojë të nisur prej atyre vetë. Edukatorët/ kujdestarët lehtësojnë mësimin e nisur të foshnjave duke krijuar me kujdes fusha interesi dhe më pas duke ndjekur drejtimin e fëmijëve. Foshnjat dhe fëmijët në përgjithësi, entuziasmohen kur kanë mundësi të eksplorojnë dhe manipulojnë materialet në mënyrat e tyre të zgjedhjes pa ndërprerje.

2. Ndërveprimet dhe bisedat si kurrikul

Kujdesi për foshnjat dhe fëmijët e vegjël në grupe të vogla lejon edukatorët/ kujdestarët të bashkëveprojnë me fëmijët në mënyra që i nxisin ata për të eksploruar idetë dhe përvojat e tyre dhe zgjerojnë të nxënë të tyre. Përmes ndërveprimit verbal dhe joverbal, edukatorët/ kujdestarët veprojnë si udhëzues, dëgjues dhe "krijues të problemeve" për foshnjat dhe vogëlushët.

3. Kujdesi për rutinat si kurrikul

Kurrikula përfshin mënyra për t'i foshnjat dhe vogëlushët pjesë në rutinat e përkujdesjes, duke i bërë rutinat në këtë mënyrë një kontekst të rëndësishëm për të mësuar. Rutinat e përditshme ofrojnë mundësi të natyrshme për fëmijët që të përdorin njohuri dhe aftësi në zhvillim. Edukatorët/ kujdestarët integrojnë mundësi të nxëni të përfshira në rutinat e përditshme të mbërritjeve, nisjeve, ngrënies, orëve, ndryshimeve të pelenave, larjes së duarve, si dhe pastrimin, brenda dhe jashtë.

CIKLI I PLANIFIKIMIT TË KURRIKULËS

Për të planifikuar një kurrikul, duhet të merren në konsideratë gjithë fazat që përbëjnë ciklin e plotë të saj. Në këtë cikël mbahen parasysh faza të tilla si vëzhgimi, dokumentimi, diskutimi, planifikimi, zbatimi dhe reflektimi dhe mënyrat si kombinohen ato me njëri-tjetrin për të formuar një cikël të plotë planifikimi.

Modeli i planifikimit të ciklit të kurrikulës për grupmoshën 0-3 vjeç është përshtatur sipas modelit të Kornizës Kurrikulare për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme të Departamentit të Edukimit të Kalifornisë. (California Department of Education, 2012) dhe mban parasysh fazat e mëposhtme.

Vëzhgimi, reflektimi

Vëzhgimi dhe reflektimi i secilit moment do të thotë të jesh i pranishëm me fëmijët dhe i vëmendshëm kur bashkëveprojnë me të tjerët dhe mjedisin. Kjo prani e ndërgjegjshme është e ndryshme nga pjesëmarrja në lojën e fëmijëve ose drejtimi i lojërave të tyre. Nuk ka rëndësi 1 minutë apo 15 minuta; një prani e vëmendshme dhe e ndërgjegjshme do të thotë të vëzhgosh dhe të presësh për të parë se çfarë ndodh moment pas momenti, ndërkohë që foshnjat apo fëmijët e vegjël luajnë. Duke vëzhguar, duke pyetur veten dhe duke reflektuar, edukatorët/kujdestarët krijojnë gjithnjë e më shumë një panoramë të plotë të eksplorimit dhe zbulimit të fëmijëve. Kur vëzhgon fëmijët “*me mend*”, me një qëllim të caktuar, një edukator do të zbulojë shkencëtarë të vegjël në punë, do të mbledhë informacion, do të krahasojë, do të bëjë supozime, do të vlerësojë supozimet përmes veprimeve të tyre, eksperimentimit dhe, me kalimin e kohës, edhe ndërtimit të zotërimit të një game të gjerë konceptesh dhe aftësish.

Dokumentimi, reflektimi

Dokumentimi nënkupton mbledhjen dhe mbajtjen e provave të eksplorimit dhe interesave të fëmijëve për t'i përdorur në të ardhmen. Një formë e zakonshme e dokumentimit në mjediset e kujdesit të hershëm është shënimi me shkrim. Format e tjera të dokumentimit përfshijnë foto, regjistrime video dhe mostrat e punës (për fëmijët e vegjël).


Dokumentimi i shërben një qëllimi të dyfishtë. Së pari, ai ruan në kujtesë vëzhgimet e edukatorëve/kujdestarëve për të nxënë të fëmijëve - shprehjet e fëmijëve, ndjenjat, idetë, konceptet dhe aftësitë e fëmijëve. Së dyti, edukatorëve / kujdestarëve u krijohen mundësi komplekse për të nxënë të foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël.

Reflektimi, diskutimi, planifikimi

Ndërsa edukatorët / kujdestarët reflektojnë në eksplorimin dhe ndërveprimet e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, ata zbulojnë mundësi për të mbajtur, zgjeruar dhe ndihmuar fëmijët të bëjnë lojën e tyre më komplekse dhe në këtë mënyrë të mbështesin vazhdimin e mësimin të fëmijëve. Edukatorët / kujdestarët duhet të rishikojnë idetë për hapat e ardhshëm të mundshëm në kurrikul. Këto hapa mund të përfshijnë shtimin e materialeve në zonat e interesit për të ofruar përvoja të reja që sfidojnë kompetencat në zhvillim; zgjerimi i pjesëmarrjes së foshnjave në rutinat e kujdesit; ose duke qenë i qëllimshëm për përfshirjen e fëmijëve në biseda rreth temave të caktuara.

Zbatimi, reflektimi

Sapo hartohet një plan, edukatori/kujdestari e zbaton atë. Në zbatimin e një plani, edukatori/kujdestari vëzhgon, reflekton dhe dokumenton. Cikli i planifikimit të kurrikulës fillon përsëri (ose vazhdon) ndërsa edukatori/kujdestari vëzhgon për të zbuluar se si fëmijët reagojnë në kurrikulën e planifikuar dhe si fëmijët tregojnë dëshmi të zhvillimit të tyre gjatë takimeve të planifikuara të mësim.



Cikli i planifikimit të kurrikulës (Përshatur nga: The Reflective Curriculum Planning Process në: *California Infant/Toddler Curriculum Framework*, 2012)

PARTNERITETI ME FAMILJET NË PLANIFIKIMIN E KURRIKULËS

Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijëve; ata kanë qëllime, përcjellin ideale, vlera dhe kanë dëshira për fëmijët e tyre. Prindërit janë të parët që njohin më mirë se çfarë njihet më mirë fëmija e tyre, çfarë i intereson dhe për çfarë është i zoti të bëjë.

Prindërit ose personat e kujdesit për fëmijën, gjithashtu, njohin më mirë se të gjithë personalitetin dhe temperamentin e fëmijës.

Shumë studime konfirmojnë se përfshirja e prindërve në procesin e të nxënës dhe veprimtaritë jashtë shtëpisë kontribuon pozitivisht në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Këta fëmijë, kanë treguar se njohin dhe përdorin një fjalor më të gjerë dhe shfaqin nivel më të lartë vetëbesimi. Autorë të shumtë përshkruajnë si përfiton gjithkush në komunitetin e institucionit arsimor, kur mësuesit dhe prindërit bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Edukatorët/ kujdestarët e shohin veçanërisht të dobishëm të ndajnë dokumentacionin e të nxënës të fëmijëve me anëtarët e familjes së fëmijëve. Kur familjet dhe edukatorët/ kujdestarët reflektojnë së bashku në dokumentimin e eksplorimit dhe të të nxënës të fëmijëve, anëtarët e familjes ofrojnë njohuri për sjelljet dhe idetë e fëmijëve, si dhe ndajnë pritjet e fëmijëve të tyre në shtëpi ose në komunitet. Mësuesit dhe familjet së bashku zbulojnë mënyra për të lidhur përvojat e fëmijëve në programin e foshnjave / fëmijëve të vegjël me përvojat e tyre në shtëpi dhe në komunitet. Përvojat e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël në shtëpi dhe në komunitetet e tyre janë një burim i fuqishëm i lidhjeve për ta. Lidhja e përvojave në shtëpi me ato të çerdhës së foshnjës , sjell koherencë në përvojat e foshnjës ose fëmijës për krijimin e kuptimit. Po kaq të rëndësishme janë lidhjet midis shtëpisë dhe programit të edukimit në çerdhe edhe për të mbështetur fëmijët emocionalisht dhe nga ana sociale.

Parimet kryesore të bashkëpunimit me prindërit ose me figurat e kujdesit për fëmijën janë marrë sipas modelit të evidentuar në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parashkollor 3-6 vjeç: (IZHA & UNICEF, 2016) .

PARIMI 1: Njohja dhe respekti

Edukatori/kujdestari duhet të njihet me familjen dhe të respektojë njohurinë dhe ekspertizën e saj; gjithashtu, fëmijët vijnë të pasuruar me një gamë të gjerë dijeshe, të cilat i kanë formuar në familjet e tyre. Familjet kanë rituale dhe tradita, që i japin formë mënyrës se si fëmijët e perceptojnë dhe marrin pjesë në botë. Familja njihet dhe respekton dijet dhe ekspertizën e edukatorit/ kujdestarit.

PARIMI 2: Komunikimi i dyanshëm

Komunikimi i dyanshëm ndërton partneritet ndërmjet familjeve dhe e edukatorit/ kujdestarit dhe mund të marrë forma të ndryshme. Edukatorët / kujdestarët, mund të organizojnë takime me prindërit, për të zhvilluar biseda për ecurinë e fëmijës, mund të komunikojnë duke shkëmbyer letra me prindërit, mund t'u dërgojnë foto të fëmijës për t'i treguar më shumë rreth një aktiviteti ku fëmija ka marrë pjesë etj. Duhet patur parasysh që të gjitha gjërat e sipërpërmendura kërkojnë kohë dhe është detyra e edukatorëve / kujdestarëve ta manaxhojnë mirë kohën, në mënyrë që të mund të zhvillojnë të gjitha veprimtaritë e planifikuara.

PARIMI 3: Vendimmarrja e përbashkët

Kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve që lidhen me fëmijët është thelbësore që edukatorët / kujdestarët t'i përfshijnë prindërit. Është shumë e rëndësishme që prindërit të marrin pjesë në vendimmarrje, kur bëhet fjalë për zhvillimin e qëllimeve mësimore, zhvillimin e strategjive, si dhe për të trajtuar sjelljet sfiduese. Ata duhet të kontribuojnë në hartimin e politikave të programit, të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat e prindërve ose në grupet këshillimore, si dhe të marrin pjesë në diskutime me edukatorët / kujdestarët, për të diskutuar se si politika të caktuara ndikojnë te fëmija i tyre.

PARIMI 4: Njohja dhe pranimi i diversitetit

Diversiteti kulturor i fëmijëve, të cilët ndjekin çerdhen, është një dukuri e pranishme në shoqërinë tonë dhe që vazhdon të rritet; kjo për shkak të lëvizjeve të shumta demografike. Fëmijët me *background* të ndryshëm kulturor, etnik, gjuhësor etj., sjellin dinamikë dhe kompleksitet në komunitetet ku jetojnë. Drejtuesit e çerdheve janë të parët që duhet të sigurojnë që, pavarësisht këtij diversiteti, të mos zhvillohen paragjykime te fëmijët, si dhe me anë të veprimtarive të ndryshme të zbusin paragjykimet që mund të kenë prindërit e fëmijëve.

PARIMI 5: Krijimi i rrjeteve mbështetëse

Rrjetet dhe marrëdhëniet ndërmjet edukatorëve / kujdestarëve dhe familjeve mund të shërbejnë si një sistem i rëndësishëm mbështetës për familjet me fëmijë të vegjël. Këto rrjete, mund të jenë formale ose jo formale. Rrjetet e formuara mund të jenë mikse edukatorë/ kujdestarë-prindër ose mund të jenë rrjete të formuara vetëm për prindërit. Shpeshherë edukatorët/kujdestarët mund të jenë koordinatorë të cilët lehtësojnë marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të rrjetit.

Fëmija zhvillohet si tërësi, pra në të gjitha fushat zhvillimore. Mbivlerësimi apo nënvlerësimi i secilës fushë në veçanti do të ishte e gabuar, sepse fëmija nuk zhvillohet njëherë në aspektin fizik, pastaj atë emocional, intelektual etj. Prandaj, edhe ndarja në mes fushave është kryesisht formale. Ashtu si zhvillimi i fëmijës është tërësor edhe fushat e veçanta të zhvillimit duhet të shikohen si pjesë të një tërësie, efikasiteti i të cilave kryesisht varet nga niveli i integritimit në mes tyre.

Standardet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 0-3 vjeç u përkasin këtyre fushave të zhvillimit²:

- **Shëndeti, mirëqenia fizike dhe zhvillimi motorik;**
- **Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi;**
- **Zhvillimi social dhe emocional;**
- **Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme;**
- **Qasjet ndaj të nxënit.**

TERMA SPECIFIKË QË DUHET TË MBAHEN PARSYSH

Fushë zhvillimi

Fushat e zhvillimit janë aspektet e ndryshme të zhvillimit të tërësishëm të fëmijës. Këto fusha duhet të shihen në lidhje të ngushtë dhe reciproke me njëra-tjetrën, pra kushtëzohen dhe kushtëzojnë zhvillimin e tërësishëm të fëmijës.

Nënfushë zhvillimi

Nënfushat e zhvillimit konsiderohen si veçanti zhvillimore brenda një fushe zhvillimi. Përmbajtja e nënfushave është e përqendruar vetëm në veçantitë e fushës së zhvillimit, P.sh. janë: zhvillimi i aftësive lëvizore bazike (muskujt e mëdhenj), zhvillimi i aftësive lëvizore fine (muskujt e vegjël), zhvillimi i aftësive senso-lëvizore, zhvillimi i shëndetit fizik dhe kujdesit për veten.

Standard

Standardet janë formulime rreth rezultateve të pritshme për sjelljen e fëmijëve dhe arritjet e tyre në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe të nxënit duke reflektuar çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët. Këto standarde vendosen për nënfushat e ndryshme të zhvillimit dhe janë të njëjta për të gjitha grupmoshat prej 0-3 vjeç.

Tregues

Treguesit janë të lidhur me standardet, janë manifestime të dukshme dhe të matshme të veprimeve të fëmijëve. Treguesit janë shembuj konkretë të njohurive apo shkathtësive të fëmijëve dhe vendosen për grupmosha të veçanta. Treguesit ndihmojnë dhe sigurojnë realizimin e standardit përkatës për tërë grupmoshën 0-3 vjet.

Strategji

Janë shembuj të veprimtarive të thjeshta, të cilat mund të realizohen nga të gjithë individët që janë afër me fëmijët. Zhvillimi dhe realizimi i tyre, nxit dhe siguron arritjen e treguesit. Shembujt e dhënë në strategjitë për ndërveprim mund të shërbejnë si udhërrëfyes apo modele edhe për shembuj të tjerë të veprimtarive që i shërbejnë qëllimit të njëjtë. Nga treguesit dhe strategjitë, mbështetet edhe hartimi i planeve dhe programeve i orientuar në fushat e zhvillimit.

2. Standardet e zhvillimit dhe të nxënit 0-3 vjeç janë përshtatur duke iu referuar Dokumentit "Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç" hartuar në kuadrin e bashkëpunimit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit me UNICEF-in, Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç të MASHT të Kosovës, si dhe Udhëzuesit për të Nxënë të Hershëm për fëmijët nga lindja deri në moshën tre vjeç, Illinois, USA, 2012.

FUSHA: ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL

Fëmijët lindin me temperamentin e tyre, i cili është mënyra e tyre unike e të menduarit, sjelljes dhe reagimit.

Zhvillimi social dhe emocional i fëmijës është një fushë e veçantë e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, e cila së bashku me fushat e tjera të zhvillimit luan rol të rëndësishëm në procesin e formimit të personalitetit të fëmijës dhe të përgatitjes së tij/saj për procesin e shkollimit. Zhvillimi social dhe emocional i fëmijës zhvillon vetëdijen për identitetin personal dhe rrit përgjegjësinë për veten dhe të tjerët. Zhvillimi i shëndetshëm social dhe emocional të fëmijët e vegjël varet nga marrëdhëniet pozitive me të rriturit e rëndësishëm në jetën e tyre. Marrëdhëniet janë themeli për zhvillimin shoqëror dhe emocional të fëmijëve dhe përkrahjen dhe ndikimin se si ata mësojnë rreth botës përreth tyre.

Zhvillimi emocional ka të bëjë me aspektin si ndjehet fëmija për vetveten dhe për botën që e rrethon, si i shpreh ndjenjat, emocionet ndaj vetes dhe të tjerëve. Po ashtu, përmes zhvillimit emocional të fëmijës bëhet rritja dhe edukimi i ndjenjës së besimit, miqësisë dhe bashkëpunimit. Zhvillimi i emocioneve ndikohet nga mjedisi shoqëror dhe mënyra se si u përgjigjen atyre. Ndërveprimi i mirëfilltë i këtyre dy aspekteve të zhvillimit, rezulton me kompetencën sociale dhe emocionale të fëmijës që manifestohet përmes aftësisë për të krijuar relacione të afërta dhe të sigurta me moshatarët dhe të rriturit duke i përjetuar, njohur, kuptuar, shprehur dhe kontrolluar emocionet e veta dhe të tjerëve përreth tyre.

Stereotipet gjinore³ ndikojnë në masë të madhe në zhvillim emocional e social të fëmijës (djalë dhe vajzë) prandaj për një realizim të plotë e përmbajtësor të përmbajtjes së kësaj fushe duhet kushtuar vëmendje të veçantë gjithëpërfshirjes së fëmijëve.

NËNFUSHAT:

❖ **Atashimi**

Marrëdhëniet e atashimit konsistojnë në plotësimin e nevojave themelore të fëmijëve përmes kujdesit të ndjeshëm. Nëse këto nevoja plotësohen vazhdimisht, zhvillohet besimi. Kur fëmijët fillojnë të zvarriten dhe të ecin, ata përdorin elementet e tyre të atashimit si një bazë e sigurt për eksplorim.

❖ **Shprehja e emocioneve**

Në foshnjëri, fëmijët shprehin ndjenjat e tyre përmes komunikimit verbal dhe komunikimit joverbal dhe varet nga kujdestarët/edukatorët e tyre për të lexuar dhe njohur shenjat e tyre.

3. Stereotipet gjinore: Janë përgjithësimet e thjeshta për qëndrimet, rolet, bindjet dhe dallimet në mes të individëve ose/dhe grupeve (djalë, vajzë; mashkull, femër; motër, vëlla) të cilat janë të përcaktuara nga aspekti shoqëror. Stereotipet edhe pse portretizojnë këto dallime si shoqërore, për femrat rrallëherë japin informata të sakta meqë bazohen në ndarje/diferencim tradicional e kulturor.

Shprehja emocionale nuk është zhvilluar në izolim; ajo lidhet me aftësinë e tyre për të rregulluar emocionet, të cilat varen shumë nga kujdestarët/edukatorët e tyre se si i ndihmojnë ata.

❖ **Marrëdhëniet me të rriturit**

Ndërveprimet shoqërore dhe marrëdhëniet janë jashtëzakonisht të rëndësishme për një zhvillim të shëndetshëm shoqëror dhe emocional. Marrëdhëniet e para që vendosin fëmijët janë me personin që janë atashuar. Ndërsa këto marrëdhënie atashimi zhvillohen, fëmijët fillojnë të bashkëveprojnë dhe t'u përgjigjen më shumë të rriturve të tjerë që shpesh janë të pranishëm në jetën e tyre. Fëmijët përdorin marrëdhëniet e tyre atashuese si një "trampolinë" për të zhvilluar këto marrëdhënie me të rriturit e njohur. Sidoqoftë, fëmijët akoma preferojnë personat atashues në shumicën e rasteve, veçanërisht kur janë të dëshpëruar ose në situata të reja.

❖ **Koncepti për veten**

Koncepti për veten përfshin mendimet dhe ndjenjat e fëmijëve për veten e tyre. Fëmijët nuk kanë lindur me aftësinë për të njohur ndjenjat dhe mendimet e tyre; ato varen nga marrëdhëniet dhe përvojat e tyre të hershme me kujdestarët/edukatorët për të formuar dhe ndikuar në zhvillimin e konceptit të tyre për veten. Ndërgjegjësimi i fëmijëve për veten e tyre si njerëz të veçantë me mendime dhe ndjenja, është thelbësor në krijimin e marrëdhënieve pozitive me të tjerët, ndërsa ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit në aftësitë e tyre.

❖ **Marrëdhënia me moshatarët**

Përvojat dhe marrëdhëniet pozitive me të rriturit i ndihmojnë fëmijët të vendosin marrëdhënie kuptimplote dhe të veçanta me bashkëmoshatarët. Fëmijët përjetojnë ndërveprime dhe sjellje me të rriturit që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nevojshme për të bashkëvepruar pozitivisht me moshatarët. Marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm si në zhvillimin e konceptit për vetveten, ashtu edhe në shfaqjen e empatisë.

❖ **Empatia**

Fëmijët e vegjël zhvillojnë empati me kalimin e kohës. Foshnjat e vogla nuk kanë aftësinë të kuptojnë dhe të ndajnë ndjenjat me të tjerët, megjithatë ekzistojnë sjellje dhe përvoja të caktuara që mbështesin zhvillimin e empatisë. Përmes marrëdhënieve të veçanta dhe kuptimplote me kujdestarin/edukatorët, fëmijët vëzhgojnë dhe mësojnë rreth sjelljeve shoqërore që mbështesin vetëdijen për ndjenjat tek të tjerët dhe, përfundimisht, një të kuptuar të tyre. (Karen, 1998).

Nënfusha: Atashimi

STANDARDI: Fëmijët formojnë marrëdhënie të sigurta atashimi me kujdestarët/edukatorët që janë të disponueshëm emocionalisht, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm në plotësimin e nevojave të tyre

<p>PERIUDHA MOSHORE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të krijojnë besim, nisin bashkëveprim dhe kërkojnë afërsi me një (ose disa) kujdestarë/edukatorë</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët besojnë, angazhohen dhe kërkojnë siguri nga kujdestari/ edukatori i tyre. Ata mund të hulumtojnë me siguri mjedisin e tyre</p>
<p>Ankthi i ndarjes fillon të ndodhë midis nëntë dhe katërbëdhjetë muajsh dhe shprehet në lot, trishtim ose zemërim kur një fëmijë ndahet fizikisht nga prindit/ kujdestari i tij/saj.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë: Vendos, mirëmban dhe shkëput kontaktin me sy. I përgjigjet kujdestarit/edukatorit duke buzëqeshur dhe duke qeshur. Kërkon ngushëllim nga një kujdestar/edukator i njohur. I limiton gjestet dhe tingujt e të rriturve të njohur. Shfaq preferenca për të rriturit e njohur. Eksponon ankthin e ndarjes, p.sh., nuk dëshiron ta mbajë një person tjetër kur mbahet nga kujdestari/ edukatori i tij.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë: Dallon ndërmjet të tjerëve kujdestarin/edukatorin e tij. Përpiaqet për të ndryshuar situatën kur shfaqet ankthi i ndarjes, p.sh., ndjek kujdestarin/edukatorin kur ai largohet nga dhoma. Përdor referencat sociale me kujdestarin/edukatorin kur është në situatë të pasigurt, p.sh., do të shikojë në fytyrën e kujdestarit/edukatorit për sugjerime se si t'i përgjigjet një personi të panjohur ose një situatë të re. Përdor të rriturit si një "bazë e sigurt" kur eksploron mjedisin. Paraqet ankth të çuditshëm në prani të një të panjohuri ose një situatë të re. Kërkon ngushëllim nga kujdestari/edukatori dhe / ose nga një objekt i njohur, p.sh. batanija. Ndërmerr dhe mban ndërveprime me kujdestarin/edukatorin.</p>
<p>Ankthi i çuditshëm është pjesë normale e zhvillimit në të cilin fëmijët mund të "ngjiten" me një të rritur të njohur, të qajnë ose të duken të frikësuar kur një person i panjohur shfaqet shumë shpejt ose shumë afër.</p>	<p>Strategjitë për ndërveprim: Siguroni kujdes të shpejtë, të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm për nevojat e fëmijës. Mbajeni, përkëdheleni, buzëqeshni dhe ndërveproni me të. Ndiqni shenjat e fëmijës; lejoni që fëmija të shkëputet nga shoqëria kur të jetë gati. Siguroni një mjedis të dashur me të rritur të besueshëm dhe caktoni një kujdestar që të kujdeset vazhdimisht për nevojat e fëmijës.</p>	<p>Strategjitë për ndërveprim: Flisni dhe këndojni shpesh fëmijës; përdorni mundësi të tilla në kohën kur ndërroni pelenat ose kohën e ushqyerjes. Rehatoni dhe siguroni fëmijën sipas nevojës. Ndërroni shembullin e fëmijës dhe lexoni shenjat e tij kur jeni angazhuar në ndërveprim me fëmijën. Kur ndaheni nga fëmija, bëni gjeste dhe i thoni lamtumirë, duke e siguruar atë që do të takoheni sërish; Rehatoni dhe siguroni fëmijën në çerdhe pasi të jetë ndarë nga prindi.</p>

STANDARDI: Fëmijët formojnë marrëdhënie të sigurta atashimi me kujdestarët/edukatorët që janë të disponueshëm emocionalisht, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm në plotësimin e nevojave të tyre

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët fillojnë të përdorin komunikim verbal dhe joverbal për t'u lidhur dhe për t'u rilidhur me personin e tyre të atashimit.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët demonstrojnë dëshirën që personi i tyre atashues të ndajë ndjenjat, përgjigjet dhe përvojat e tyre. Sjelljet që tregojnë një nevojë për afërsi fizike me kujdestarin/edukatorin zvogëlohen, ndërsa në raste të caktuara shqetësimi, disa fëmijë kërkojnë të jenë afër figurës së tyre atashuese.



Treguesit për fëmijë përfaqshues:	Treguesit për fëmijë përfaqshues:
<p>-Tregon lidhje emocionale me të rritur të njohur përveçse me kujdestarin/edukatorin.</p> <p>-Përdor imitim dhe pretendon në lojë për të kuptuar marrëdhëniet, p.sh., përdor një lodër për të folur në telefon, ose ushqen një kukull sikur ta kishte bebe.</p> <p>-Luan fizikisht më larg kujdestarit/edukatorit me besim në rritje; lëviz më afër tij sipas nevojës.</p> <p>-Kërkon afërsi fizike kur shqetësohet.</p> <p>-Kërkon në mënyrë aktive përgjigje emocionale nga kujdestari/edukatori, duke iu përkëdhelur, duke e përqaftuar, duke qarë.</p>	<p>-Përdor shikime dhe fjalë për të qëndruar i lidhur, pa qenë nevoja të jetë afër fizikisht ose të prekë kujdestarin/edukatorin.</p> <p>-Ndërmerr veprimtari që kanë kuptim në marrëdhënie, p.sh. sjell një libër të preferuar për t'u lexuar së bashku.</p> <p>-Kommunikon mendime, ndjenja dhe plane për të rriturit e njohur.</p> <p>-Kërkon ndihmë nga të rriturit për sfidat.</p> <p>-Ndahet me ankth më të vogël nga figura atashuese, me pak ndërhyrje dhe ndihmë</p>
Strategjitë për ndërveprim:	Strategjitë për ndërveprim:
<ul style="list-style-type: none"> • Mbështesni me fjalë emocionale që po shfaq fëmija. • Sigurohuni që të merrni në konsideratë pritje realiste. • Ofroni mundësi të mjaftueshme për lojë dhe ndërveprim. • Jini i disponueshëm fizikisht dhe emocionalisht për fëmijën • Përgjigjuni përpjekjeve të fëmijës p.sh. i ktheni mbrapa një puthje duke fryrë, pasi fëmija fryn një puthje për ju. • Modeloni sjelljet e duhura, p.sh., si të reagoni emocionalisht brenda situatave, si të flasim me bashkëmoshatarët. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregoni empati dhe pranoni se si po ndihet fëmija. • Falënderoni me vërtetësi fëmijën kur ai ndan arritjet. • Përgjigjuni me interes ndërsa fëmija angazhohet në bisedë. • Nijhni dhe përgjigjuni verbalisht dhe joverbalisht komunikimit të fëmijës. • Përgatiteni fëmijën për ndarje duke i dhënë lamtumirën dhe duke i thënë se do të kthehet përsëri.

Baza e sigurt e sjelljes përshkruhet si aftësia e fëmijës për ta përdorur kujdestarin/edukatorin e tij si bazë fizike ashtu edhe emocionale, ndërsa eksplorojnë mjedisin e tyre.

Nënfusha: Shprehja e emocioneve

STANDARDI: Fëmijët shfaqin vetëdije dhe aftësi për të identifikuar dhe shprehur emocione

<p>PERIUDHA MOSHORE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të shprehin një gamë të gjerë të ndjenjave përmes komunikimit verbal dhe joverbal dhe fillojnë të zhvillojnë shprehje emocionale me ndihmën e kujdestarit/edukatorit të tyre.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të shprehin disa emocione me qëllim dhe me ndihmën e kujdestarit/edukatorit të tyre fëmijët mund të rrisin gamën e tyre të shprehjes emocionale</p>
<p>Shfaqja e buzëqeshjes sociale dhe ndërveprimet me kujdestarin/ edukatorin janë sjelljet e para të qëllimshme ose të drejtuara nga qëllimi që shfaqin fëmijët. Sjelljet e qëllimshme bëhen gjithnjë e më komplekse dhe të qëllimshme ndërsa fëmijët rriten.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor shprehjet dhe tingujt e futyrës për të përmbushur nevojat, p.sh., qan, buzeqesh, vështron ngultas, gugat. • Shpreh emocione përmes tingujve dhe gjesteve, p.sh., klith, qesh, përplas duart. • Demonstron siklet, stres, ose pakënaqësi përmes trupit, gjuhës dhe tingujve, p.sh., harkohet mbrapa, lëviz kokën, qan... 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh dëshira me qëllim të caktuar, p.sh., shtyn një objekt të padëshiruar jashtë rrugës për të arritur te një i rritur i njohur kur dëshiron. • Shpreh frikën duke qarë ose duke u kthyer drejt kujdestarit/ edukatorit për rehati. • Tregon zemërim dhe zhgënjim, p.sh., qan kur i merret një lodër. • Njeh dhe shpreh emocion ndaj një personi të njohur, p.sh., tregon emocion duke përqaftuar motrën/vëllain; shokun/shoqen.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rehatoni fëmijën për të përmbushur nevojat; veproni si një bashkërrëgjues për fëmijën, p.sh. ushqeni fëmijën kur ka uri, lëkundeni fëmijën kur lodhet. • Përkrahuni emocionin që po shpreh fëmija, p.sh., gëzohuni edhe ju kur fëmija gëzohet kur arrin lodrën që kërkonte të kapte! • Modeloni shprehjet e futyrës për të përputhur emocionet me fëmijët, p.sh., zgjeroni sytë dhe qëndroni gojëhapur për të shprehur befasi... 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjiguni shfaqjes së frikës ose shqetësimit të fëmijës; siguroni dhe rehatoni fëmijën. • Modeloni shprehjen emocionale për fëmijën duke bërë shprehje në futyrë dhe duke përdorur fjalë për të emërtuar emocionin. • Kthejuni reciprokisht veprimeve dhe gjesteve që fëmija ndërmer, p.sh., lëkundjeve, përshëndetjeve, puthjeve, perqafimeve...

STANDARDI: Fëmijët shfaqin vetëdije dhe aftësi për të identifikuar dhe shprehur emocione**16 muaj deri në 24 muaj:**

Fëmijët vazhdojnë të përjetojnë një gamë të gjerë emocionesh (p.sh., afekcion, zhgënjim, frikë, zemërim, trishtim). Në këtë pikë zhvillimi, fëmijët do të shprehin dhe veprojnë me impulse, por fillojnë të mësojnë aftësi nga kujdestarët/edukatorët e tyre se si të kontrollojnë shprehjen e tyre emocionale.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Demonstron zemërimin dhe zhgënjimin përmes një sërë shprehjesh fizike, vokale dhe të fytyrës, p.sh., shpërthime të çastit.
- Shpreh krenari, p.sh., buzëqesh ose thotë: "Unë e bëra atë" pasi ka kryer një "detyrë".
- Përpiqet të përdorë një fjalë për të përshkruar ndjenjat te një i rritur i njohur.
- Shpreh habi dhe kënaqësi gjatë eksplorimit të mjedisit dhe angazhimit të të tjerëve.

Strategjitë për ndërveprim:

- Përdorni fjalë për të përshkruar emocionin; kjo e ndihmon fëmijën të shoqërojë ndjenjat me emrtimin e tyre.
- Kushtojini vëmendje të madhe shenjave që po shpreh fëmija.
- Modeloni mënyra të përshtatshme për të shprehur ndjenja të ndryshme.
- Pranoni dhe vërtetoni emocionet që po ndjen fëmija, p.sh. "Unë e kuptoj që je kaq i gëzuar se po kërcen shumë bukur..."

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët fillojnë të përçojnë dhe shprehin emocione përmes përdorimit të komunikimit verbal dhe joverbal. Fëmijët gjithashtu fillojnë të zbatojnë strategji të mësuara nga kujdestarët/edukatorët e tyre për të rregulluar më mirë këto emocione.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Përpiqet të përdorë fjalë për të përshkruar ndjenjat dhe për të emërtuar emocionet.
- Aktivizon emocione të ndryshme ndërsa luan; p.sh., qan, kur pretendon se është i trishtuar, kërcen lart e poshtë për të shprehur ngazëllim...
- Fillon të shprehë emocione komplekse si krenari, siklet, turp dhe faj.
- Angazhohet në lojë për të shprehur emocion, p.sh., vizaton një figurë për kujdestarin/edukatorin sepse ai ose ajo i mungon; fsheh një "përbindësh" në kuti për shkak të frikës prej tij...

Strategjitë për ndërveprim:

- Diskutoni ndjenjat me fëmijën; sigurojeni atë se sa mirë është të ndiejë emocione të ndryshme
- Pranoni që fëmija mund të ketë nevojë për ndihmë për të shprehur ndjenjat.
- Lejoni mundësi të tjera në të cilat fëmijët mund të shprehin emocionet e tyre, p.sh., arti, vallëzimi, loja imagjinare.
- Respektoni dallimet kulturore kur bëhet fjalë për të shprehur emocione; asnjëherë mos e përçmoni atë që po tregon dhe po shpreh fëmija.
- Sigurohuni që të vazhdoni të lexoni shenjat e fëmijës edhe pasi fëmija fillon të përdorë fjalë për të përshkruar ndjenjat...

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Bashkërrëgjullatori i referohet kujdestarit/ edukatorit të fëmijës i cili e ndihmon atë në arritjen e rregullimit përmes përgjigjeve, ndërveprimeve dhe komunikimit.

Nënfisha: Marrëdhënia me të rriturit

STANDARDI: Fëmijët shfaqin dëshirën dhe zhvillojnë aftësinë për t'u përfshirë, bashkëvepruar dhe për të ndërtuar marrëdhënie me të rriturit e njohur

<p>PERIUDHA MOSHORE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët zhvillojnë aftësinë për të sinjalizuar kujdestarët/edukatorët. Deri në fund të kësaj periudhe moshe, fëmijët fillojnë të përfshihen në një komunikim të këndshëm me të rritur të njohur.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët përdorin të rriturit e njohur për marrëdhënie dhe siguri. Fëmijët gjithashtu ndërmarrin dhe përfshihen në ndërveprime me të rriturit e njohur.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor sinjale për të komunikuar nevojat e tij, p.sh., qan, përdor gjuhën e trupit, dhe shprehjet e fytyrës. • Përpiqet për të përfshirë të rritur të panjohur dhe të njohur. • Angazhohet në bashkëveprime shoqërore me të rriturit përmes buzëqeshjeve, gjuetive, dhe kontaktit me sy. • Demonstron preferencën për të rriturit e njohur, p.sh., shtrin duar drejt për të kujdestarit/edukatorit. • Tregohet i matur ndaj të rriturve të panjohur. • Fillon të përfshihet në ndërveprime të thjeshta me një të rritur të njohur, p.sh., "luan kukamfshehti", duke iu përgjigjur një të rrituri dhe përsërit këtë ndërveprim. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkon përgjigjen e kujdestarit/edukatorit në situata të pasigurta. • Angazhohet me të rriturit gjatë lojës, p.sh., godet një daulle lodër dhe përsërit veprimin pasi edhe një i rritur kryen të njëjtin veprim. • Përdor të rriturit si një "bazë e sigurt" kur eksploron mjedisin. • Përdor "referencë sociale" kur has përvoja të reja, p.sh., shikon fytyrën e kujdestarit/edukatorit për sugjerime se si t'i përgjigjet një personi të panjohur për të ose një objekti të panjohur. • Tërheq një të rritur të njohur në një ndërveprim, p.sh., i jep librin ose lodrën për t'u përfshirë së bashku. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <p>Ndriqni shembullin e fëmijës në lojë, përgjiguni me vërtetësi ndërsa ndërveproni.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjiguni fëmijës në mënyrë të vazhdueshme; kjo ndihmon në ndërtimin e besimit. • Ofroni mbështetje përmes sjelljeve të sigurta siç janë buzëqeshjet, përqaftimet dhe përkëdheljet. • Siguroni periudha të dedikuara kohore për të luajtur dhe angazhuar me fëmijë me ndërprerje të kufizuara.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni kujdes të shpejtë, të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm për nevojat e fëmijës. • Siguroni një mjedis të dashur dhe stimules me besueshmëri të rritur dhe kujdesuni vazhdimisht për nevojat e fëmijës. • Angazhohuni me fëmijën përmes bashkëveprimeve të përditshme, që ai dëshiron. • Rehatooni fëmijën kur mërzitet, frikësohet ose mbingarkohet, p.sh. me përqaftime të buta ose duke përdorur një zë qetësues. • Ndriqni shembullin e fëmijës kur bashkëveproni dhe luani. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <p>Ndriqni shembullin e fëmijës në lojë, përgjiguni me vërtetësi ndërsa ndërveproni.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjiguni fëmijës në mënyrë të vazhdueshme; kjo ndihmon në ndërtimin e besimit. • Ofroni mbështetje përmes sjelljeve të sigurta siç janë buzëqeshjet, përqaftimet dhe përkëdheljet. • Siguroni periudha të dedikuara kohore për të luajtur dhe angazhuar me fëmijë me ndërprerje të kufizuara. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <p>Ndriqni shembullin e fëmijës në lojë, përgjiguni me vërtetësi ndërsa ndërveproni.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjiguni fëmijës në mënyrë të vazhdueshme; kjo ndihmon në ndërtimin e besimit. • Ofroni mbështetje përmes sjelljeve të sigurta siç janë buzëqeshjet, përqaftimet dhe përkëdheljet. • Siguroni periudha të dedikuara kohore për të luajtur dhe angazhuar me fëmijë me ndërprerje të kufizuara.

STANDARDI: Fëmijët shfaqin dëshirën dhe zhvillojnë aftësinë për t'u përfshirë, bashkëvepruar dhe për të ndërtuar marrëdhënie me të rriturit e njohur



<p>16 muaj deri në 24 muaj: Fëmijët kërkojnë në mënyrë aktive të rriturit e njohur dhe fillojnë të tregojnë interes për detyrat dhe rolet e të rriturve</p>	<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët bashkëveprojnë me të rriturit për të komunikuar ide, për të ndarë ndjenjat dhe për të zgjidhur problemet. Fëmijët gjithashtu shqyrtojnë në mënyrë aktive rolet dhe detyrat e të rriturve</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërton lidhje emocionale me të rritur të tjerë të njohur, përveç kujdestarit/edukatorit. • Kërkon ndihmë nga të rriturit për sfidat, por mund të refuzojë ndihmën dhe të thotë "jo". • Përgjigjet për udhëzimet, p.sh., vendos formën në vendin e duhur ndarës pas demonstrimit të kujdestarit/edukatorit. • Imiton veprimet e një të rrituri të njohur, p.sh., lëviz duart ndërsa pretendon të flasë në telefon pasi sheh kujdestarin/edukatorin të bëjë të njëjtat veprime. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Imiton rolet dhe veprimtaritë e të rriturve përmes lojërave të pretenduara, p.sh. shkon në market, ose përgatit një vakt... • Nis të bëjë veprimtari që kanë kuptim në marrëdhënie, p.sh. sjell një libër të preferuar për t'u lexuar së bashku. • Komunikon mendimet, ndjenjat, pyejtet dhe planet si për të rriturit e njohur dhe të panjohur. • Demonstron dëshirën për të kontrolluar ose marrë vendime të pavarura nga të rriturit.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rehatoni fëmijën dhe pranoni atë ose ndjenjat që e shqetësojnë atë; siguroni fjalë për emocionet që fëmija po shfaq. • Vendosni kufijtë e duhur dhe të qëndrueshëm; sigurohuni që të merrni në konsideratë pritje realiste. • Siguroni zgjedhje për fëmijën, p.sh., «Të pëlqen gota blu apo gota e verdhë?» • Vendosni rutinat dhe ritualet e përditshme. • U lini kohë të bollshme për të luajtur lojën e tyre. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Luani dhe kaloni kohë cilësore me fëmijën çdo ditë. • Përgjigjuni me interes kur fëmija angazhohet në bisedë. • Siguroni materiale me të cilat fëmija mund të luajë, p.sh., kuzhinë lodër, telefon, kukull bebe etj. • Siguroni zgjedhje që ta ndihmojë fëmijën ose ta bëjë atë të ndihet më shumë brenda kontrollit, p.sh., "Mund të pish qumësht ose lëng."

Nënfusha: Koncepti për vetveten

STANDARDI: Fëmijët zhvillojnë identitetin për vetveten

GJATË KËSAJ PERIUDHE	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të njohin veten si individë, të ndarë nga të tjerët. Në fillim, foshnjat e vogla nuk janë të vetëdijshme se janë qenie më vete. Sidoqoftë, midis moshës gjashtë dhe nëntë muaj, ato kuptojnë se janë njerëz të veçantë.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të kenë një vetëdije më të madhe për karakteristikat e tyre dhe fillojnë të shprehen me mendimet dhe ndjenjat e tyre.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron interes për fytyrat dhe zërat e të tjerëve. • Eksploron duart dhe këmbët e tij. • Njeh emrin e vet, p.sh., shikon lart, ose kthen kokën drejt një personi që po thotë emrin e tij. • Njeh dhe preferon të rriturit e njohur, p.sh., shtrin duart drejt kujdestarit/ edukatorit kur mbahet nga dikush tjetër. • Fillon vetë ndërveprime me të tjerët, p.sh., imiton veprime, shfaqje "lojë kukamshehtë" ... • Fillon të shfaqë fillimin e vëmendjes së përbashkët, p.sh., tregon për objekte dhe njerëz. • Demonstron ankthin e ndarjes, p.sh., qan kur kujdestari/ edukatori largohet. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjësohet për njerëzit e rëndësishëm duke i thirrur ata me emër, p.sh., "baba" "dada". • Angazhohet në vëmendjen e përbashkët me personat e tjerë të njohur, p.sh., angazhohet duke kërkuar objekte dhe njerëz. • Përgjigjet me vokalizime ose gjeste kur dëgjon emrin. • Demonstron interes për të parë në pasqyrë. • Përdor gjeste dhe disa fjalë për të shprehur ndjenjat, p.sh., "jo". • Përdor referencën sociale për të drejtuar veprimet dhe fillon të testojë kufijtë. • Tregon dhe identifikon pjesët e trupit, p.sh., vendos gishtat te sytë kur pyeten: "Ku janë sytë e?" 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni emra kur iu referoheni njerëzve të rëndësishëm për fëmijën • Përdorni një veshje afektive që përputhet me ndjenjat e fëmijës; përdorni shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit për të shprehur të njëjtën gjë me emocionet që po vokalizon fëmija. • Lejoni fëmijën të shprehë dëshirat dhe ndjenjat; siguroni zgjedhje me qëllim që t'i lejonin edhe atij kontroll; siguroni kufij dhe limite për fëmijën. • Përdorni këngë dhe lojëra që e ndihmojnë të identifikojë pjesët e trupit.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkëdhelni, ushqeni dhe përgjiguni me kujdes sinjaleve të fëmijës. • Përdorni emrin e tij gjatë ndërveprimeve. • Siguroni pasqyra që fëmija të shikojë veten. • Pranoni përpjekjet e fëmijës, ndërmerrni angazhime, p.sh., të kërkoni drejt vendit ku fëmija po tregon dhe emërtoni atë që po tregon fëmija. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni emra kur iu referoheni njerëzve të rëndësishëm për fëmijën • Përdorni një veshje afektive që përputhet me ndjenjat e fëmijës; përdorni shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit për të shprehur të njëjtën gjë me emocionet që po vokalizon fëmija. • Lejoni fëmijën të shprehë dëshirat dhe ndjenjat; siguroni zgjedhje me qëllim që t'i lejonin edhe atij kontroll; siguroni kufij dhe limite për fëmijën. • Përdorni këngë dhe lojëra që e ndihmojnë të identifikojë pjesët e trupit. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni emra kur iu referoheni njerëzve të rëndësishëm për fëmijën • Përdorni një veshje afektive që përputhet me ndjenjat e fëmijës; përdorni shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit për të shprehur të njëjtën gjë me emocionet që po vokalizon fëmija. • Lejoni fëmijën të shprehë dëshirat dhe ndjenjat; siguroni zgjedhje me qëllim që t'i lejonin edhe atij kontroll; siguroni kufij dhe limite për fëmijën. • Përdorni këngë dhe lojëra që e ndihmojnë të identifikojë pjesët e trupit.

Koncepti për veten i referohet aftësisë së zhvillimit të fëmijës për të kuptuar që trupi, mendja dhe veprimet e një personi janë të ndara nga ato të të tjerëve.

STANDARDI: Fëmijët zhvillojnë identitetin për vetveten**16 muaj deri në 24 muaj:**

Fëmijët bëhen të vetëdijshëm për veten e tyre si të dallueshëm nga të tjerët si fizikisht ashtu edhe emocionalisht. Gjatë kësaj periudhe, fëmijët shpesh luftojnë me ekuilibrin e të qenurit të pavarur dhe kanë nevojë për edukim nga kujdestarët/edukatorët e tyre.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Demonstron vetëdijen për veten, p.sh., prek hundën e vet në pasqyrë.
- Është në gjendje të shprehë emrin e tij.
- I referohet vetes me gjepte dhe gjuhë.
- Demonstron të kuptuarit dhe përdorimin e koncepteve përmes fjalëve "imi", "unë" dhe "ti".
- Tregon vetveten në imazhe dhe lloje të tjera të mediave (foto, video).
- Teston shpesh kufijtë deri ku mund të arrijë.
- Kërkon ndihmë nga të rriturit e njohur, por mund të fillojë të përpiqet të bëjë diçka vetë në mënyrë autonome.

Strategjitë për ndërveprim:

- Mundësoni fjalë për emocionin që po shpreh fëmija; provoni ndjenjat e tij.
- Siguroni kujdes stimules, veçanërisht kur fëmija po kërkon rehati.
- Angazhohuni shpesh në biseda me fëmijën; ofroni mundësi që fëmija të flasë për vetveten në një kontekst kuptimplotë.
- Vendosni disa limite me fëmijën dhe sigurojini atij zgjedhje gjatë gjithë ditës.
- Përdorni ridrejtimin, p.sh., jepini një lodër një fëmije që është gati të qajë sepse një fëmijë tjetër ka lodrën që ai e dëshiron...

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët fillojnë të identifikojnë dhe diskutojnë lidhjet e tyre me njerëzit dhe gjërat e tjera. Fëmijët gjithashtu mund të identifikojnë ndjenjat dhe interesat e tyre dhe t'i komunikojnë ato të tjerët.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Emërton njerëzit në familjen e tij dhe ndan histori rreth tyre.
- Kërkon ndihmë nga të rriturit e njohur, por mund të përpiqet dhe/ose refuzojë ndihmë.
- Përfshin rolet e anëtarëve të familjes në lojë.
- Fillon të tregojë një interes për të përshkruar karakteristikat fizike, p.sh., "Unë kam sy blu".
- Demonstron preferencat, p.sh., "Unë dua filxhanin jeshil".
- Komunikon ndjenjat, p.sh., mund të thotë "Unë jam i mërziur" ose përplas këmbët kur është i zemëruar.
- Fillon të kuptojë konceptin e zotërimit p.sh., "juaji", "i saj", "i tij".

Strategjitë për ndërveprim:

- Dëgjoni me interes dhe përgjigjuni në kohën që fëmija ndan informacione me kuptim për jetën e tij.
- Pyesni fëmijën për ditën e tij, miqtë dhe gjërat e preferuara.
- Njihuni me përpiqjet e fëmijës në ndarjen e tregimeve, mendimeve dhe pyetjeve, p.sh., komentoni dhe përgjigjuni menjëherë dhe me vërtetësi.
- Jini të vetëdijshëm dhe respektues ndaj dallimeve kulturore në lidhje me pavarësinë.
- Nxiteni fëmijën të sjellë një fotografi të familjes së tij dhe mbajeni atë në një vend ku fëmija mund ta shohë.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nënfisha: Marrëdhënia me moshatarët

STANDARDI: Fëmijët shfaqin dëshirën dhe zhvillojnë aftësinë për t'u përfshirë dhe bashkëvepruar me fëmijët e tjerë

<p>Loja është pjesë integrale e mënyrës sesi fëmijët mësojnë dhe kuptojnë botën e tyre. Loja është e këndshme dhe spontane dhe fëmijët e përdorin atë për të zbuluar, pretenduar dhe zgjidhur problemet.</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të bashkëveprojnë me mjedisin e tyre dhe njerëzit përreth tyre; shfaqin një interes për fëmijët e tjerë të moshës së tyre</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron përpjekje për të bashkëvepruar dhe për t'u angazhuar, p.sh., përdor syrin për kontakt, gjuetjet, buzëqeshjet... • Vëzhgon fëmijët e tjerë në mjedis; tregon interes si për bashkëmoshatarët e njohur dhe për ata të panjohur. • Qan kur dëgjon një fëmijë tjetër duke qarë; shtrihet për të prekur një fëmijë tjetër; përpiqet për të imituar veprime,p.sh., bën zhurmë me një lodër. 	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët do të fillojnë të vëzhgojnë dhe imitojnë sjelljet e fëmijëve të tjerë të moshës së tyre</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon interes për një fëmijë tjetër duke u afruar më shumë, p.sh. rrotullohet, zvarritet ose ecën drejt fëmijës. • Imiton veprimet e një fëmije tjetër, p.sh., lëviz një makinë. • Angazhohet në një lojë të thjeshtë, reciproke . • Fillon të angazhohet në lojë paralele, në afërsi të fëmijës tjetër, por nuk tentohet asnjë ndërveprim.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjiguni pozitivisht ndaj gjuetjeve dhe vokalizimeve të fëmijës si me shprehjet verbale ashtu edhe ato gjestuale. • Qëndroni, përkëdhelni, buzëqeshni dhe ndërveproni me fëmijën. • Imitoni tingujt dhe veprimet e fëmijës në mënyrë pozitive. • Lexoni dhe luani shpesh me fëmijën; nëse është e mundur • Angazhohuni me fëmijën në eksplorim dhe lojë; ndiqni atë që kërkon fëmija. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni mundësi që fëmija të luajë dhe bashkëveprojë me fëmijë të tjerë. • Modeloni ndërveprimin pozitiv ndërsa luani dhe kaloni kohë me fëmijën. • Siguroni veprimtari që mund të bëhen në grup, si p.sh. të kënduarit, veprimtari të lëvizjes ose të lexoni një histori. • Siguroni një larmi lodrash që fëmijët të eksplorojnë dhe të luajnë me to.

STANDARDI: Fëmijët shfaqin dëshirën dhe zhvillojnë aftësinë për t'u përfshirë dhe bashkëvepruar me fëmijët e tjerë

<p>16 muaj deri në 24 muaj: Me zhvillimin e lojës dhe komunikimit, fëmijët fillojnë të kërkojnë ndërveprime me bashkëmohatarët.</p>	<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët përfshihen dhe ruajnë ndërveprime me bashkëmohatarët e tyre, përmes përdorimit të aftësive sociale dhe të lojërave.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bën gjeste për të komunikuar një dëshirë, për të luajtur pranë një bashkëmohatari. • Demonstron entuziazëm për fëmijët e tjerë; shpreh zhgënjimin kur një fëmijë tjetër heq diçka prej tij p.sh., një lodër. • Fillon të përfshihet në ndërveprime të thjeshta reciproke, p.sh., hedh me radhë një top para-mbrapa.. • Demonstron preferencë për lojë paralele, p.sh., luan pranë fëmijëve të tjerë me lodra të ngjashme me pak ose aspak ndërveprim. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron preferencë ndaj bashkëmohatarëve të zgjedhur. • Bëhet i irrituar me bashkëmohatarët, p.sh., bërtet "jo" nëse një bashkëmohata-tar përpiqet të ndërhyjë në diçka me të cilën është angazhuar. • Merr pjesë në ndarje, kur ju kërkohet. • Komunikon me fëmijë të tjerë në mjedis të ndryshme, p.sh. bisedon me një bashkëmohatar gjatë kohës kur ha zemër, ose i jep një libër shokut. • Fillon të angazhohet në një lojë më komplekse me dy ose tre fëmijë.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njihni dhe përgjigjuni ndaj komunikimit verbal dhe joverbal. • Krijoni një kohë të veçantë kur dy ose tre fëmijë "lexojnë" një libër bashkë me ju . • Pranoni të ndani sjelljet e menduara, p.sh. fëmija përqafton një fëmijë tjetër që është i mërziur, ose i jep një lodër një fëmijë tjetër. • Siguroni më shumë se një lodër të njëjtë për fëmijët dhe /ose bashkëmohatarët e tij për të luajtur me të. • Përdorni zbatimin dhe ridrejtimin për të ndihmuar në kufizimin e konflikteve midis fëmijëve. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijoni grupe të vogla, secili me një kujdestar/edukator, për të ndarë një kohë cilësore me fëmijë të veçantë. • Siguroni lodra me të cilat mund të luhen dy ose më shumë fëmijë në të njëjtën kohë. • Siguroni veprimtari që nxisin ndarjen e mjeteve/lodrave, ndërsa kufizoni rrezikun për zhgënjimin, p.sh., për projekte arti, siguroni më shumë materiale në dispozicion për fëmijët pjesëmarrës.

Nënfusha: Empatia

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi për të kuptuar ndjenjat e dikujt tjetër dhe për të marrë pjesë në emocionet dhe përvojat e të tjerëve

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Foshnjat fillojnë të ndërtojnë vetëdijen për ndjenjat e të tjerëve duke vëzhguar dhe reaguuar. Në fund të kësaj periudhe, foshnjat kuptojnë që janë individë, janë të ndarë nga kujdestari/edukatori i tyre, një etapë thelbësore në interpretimin e ndjenjave të të tjerëve.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët kanë më shumë përvojë me një gamë të gjerë emocionale, pasi fillojnë të njohin dhe përgjigjen ndaj shprehjeve të fytyrës dhe emocioneve të ndryshme. Fëmijët gjithashtu fillojnë të demonstrojnë të kuptuarit se si sjellja sjell reagime dhe emocione nga të tjerët.</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shikon dhe vëzhgon të rriturit dhe fëmijët e tjerë. • Qan kur dëgjon një fëmijë tjetër të qajë. • U përgjigjet ndërveprimeve nga kujdestari/edukatori p.sh., buzëqesh kur kujdestari/edukatori buzëqesh, shikon drejt kujdestarit/edukatorit kur ai tund një lodër që lëshon tinguj/zhurme. • Tregon shenja ankthi nga ndarja, p.sh., kundërshton kur kujdestari/edukatori largohet nga dhoma. • Fillon të ndajë në emocione të thjeshta duke lexuar fytyrën dhe gjestikulacionin e sugjeruar, p.sh., përsërit veprime që i bëjnë të tjerët të qeshin. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Buzëqesh me qëllim të tërheqë një buzëqeshje nga një tjetër i njohur. • Përdor referenca sociale me kujdestarin/edukatorin kur është i pasigurt në disa situata, p.sh., shikon fytyrën e kujdestarit/edukatorit për sugjerime se si përgjigjet ndaj një personi të panjohur ose situatë të re. • Reagon ndaj një fëmije që është i mërzitur duke vëzhguar ose lëvizur fizikisht më afër fëmijës. • Vepron me emocione pozitive dhe negative me kujdestarin/edukatorin p.sh., veprime që shprehin në çudi, habi, kënaqësi dhe zhgënjim. • Fillon të ketë një vetëdije më të madhe për emocionet e veta, p.sh., thotë ose tregon me gjeste "jo" për të refuzuar, klith dhe vazhdon të qeshë kur është i lumtur.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni kujdes dhe qëndrueshmëri emocionale; përgjigjuni shpejt, por jo pa menduar, për tingujt dhe klithmat e fëmijës. • Përshtroani se çfarë mund të ndiejë fëmija me fjalë; etiketoni tingujt dhe gujtjet e fëmijës. • Ofroni mundësi që fëmija të shohë shprehje të ndryshme të fytyrës: libra për fëmijë me fotografi të foshnjave të tjera etj. • Shprehni dhe ndani ndjenjat me fëmijën, p.sh., lëvizjet e trupit, fjalët, shprehjet e fytyrës, dhe modulimet e zërit. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjuni përpjekjeve të fëmijës për të kërkuar përgjigje emocionale; përpiqui të përdorni shprehjet e fytyrës për t'i përputhur me tonin e zërit të fëmijës, tingujt dhe gjuhën e trupit. • Modeloni sjelljen empatike dhe kontrolloni emocionet tuaja, p.sh. shmangni kontrollin dhe forsimet; në vend të kësaj përdorni ridrejtimin. • Emërtoni emocionet dhe njihni sjelljet që fëmija po shfaq, p.sh., duke thënë, "Unë e shoh që po kënaqeni sepse po hidheni nga gëzimi!" • Mos u përgjigjuni pa u menduar, por me vërtetësi ndaj përpjekjeve të fëmijës për t'u angazhuar dhe bashkëvepruar shoqërisht.

STANDARDI: Fëmijët demonstronjë aftësi për të kuptuar ndjenjat e dikujt tjetër dhe për të marrë pjesë në emocionet dhe përvojat e të tjerëve



<p>16 muaj deri në 24 muaj: Fëmijët fillojnë të vërejnë emocione të ndryshme që fëmijët e tjerë po shprehin dhe mund të fillojnë të përgjigjen ndaj këtyre emocioneve</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Imiton sjellje ngushëlluese nga kujdestari/edukatori p.sh., përkëdhel ose përqafton një fëmijë kur mërzitet. • Njeh disa nga emocionet e tij, p.sh., kap një objekt ngushëllues, ose rehatues, kur është i trishtuar. • Shfaq vetëdije për emocione dhe ndjenja të ndryshme gjatë lojës, p.sh., e tund një kukull dhe i pëshpërit "shhhttt". • Ndan dhe komunikon emocione të thjeshta me të tjerët, p.sh. "mama e mërzitur", "baba i gëzuar". 	<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët fillojnë të shfaqin të kuptuarit se njerëzit e tjerë kanë ndjenja të ndryshme nga ndjenjat e tyre</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komunikon se si mund të ndjehen fëmijët e tjerë dhe pse, p.sh. shprehet se një bashkëmohatar është i trishtuar sepse lodrën e tij e mori shoku/shoqja. • I përgjigjet një fëmijë që është i shqetësuar në një mënyrë që përpiqet ta bërë që të ndihet më mirë, p.sh., i jep një përqaftim një fëmijë që qan, përdor fjalë qetësuese ose përdor diçka argëtuese. • Ndan dhe tregon përgjigje emocionale për ndjenjat e bashkëmohatarëve, p.sh., mund të tregojë shqetësim për një fëmijë të lënduar, ose buzëqesh për një fëmijë i cili është i lumtur dhe kërcen hopa.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni të përdorni fjalë për ndjenjat e fëmijës, sa më shpesh të jetë e mundur, gjatë gjithë kohës. • Njihni dhe respektoni përgjigjet emocionale, individuale dhe kulturore p.sh., një fëmijë që nuk dëshiron të përqaftohet kur është i mërzitur. • Ndhmoni fëmijën të njohë emocione të caktuara, duke përshkruar dhe duke emërtuar atë që ai po ndjen. • Ndhmoni fëmijën të zhvillojë dhe të kuptojë ndjenjat e të tjerëve, duke përdorur fotografi, postera, libra dhe pasqyra. • Lini shumë kohë për të pretenduar se luani dhe bashkëveproni me fëmijën, ndërsa modeloni empatinë. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Modeloni praktika të menduara dhe të ndjeshme kur dëgjoni dhe i përgjigjeni përshkrimit të fëmijës për ndjenjat e tij. • Vazhdoni të emërtoni dhe diskutoni ndjenjat, p.sh., thoni pse fëmija mund të jetë duke ndjerë emocione të caktuara. • Fatënderoni vërtet fëmijën kur ai i përgjigjet në mënyrë të ndjeshme një fëmijë tjetër. • Drejtoni butësisht lojën e fëmijëve për të nxitur empatinë, p.sh. "Edhe Miri i është i uritur. Ai ka nevojë për për të ngrënë diçka".

MBANI PARASYSH:

Në mënyrë që fëmijët të ndërtojnë aftësinë e tyre për të identifikuar, ata duhet të jenë në gjendje të njohin ndjenjat e tyre dhe shprehjet emocionale të të tjerëve. Shprehja e emocioneve është e lidhur ngushtë me ndikimet kulturore dhe shoqërore të familjes dhe mjedisit të fëmijëve. Emocionet forcohen nga kujdestarët/edukatorët në varësi të emocioneve të cilat ata ndiejnë, duke e përgatitur më mirë fëmijën për sukses në kulturën dhe shoqërinë e tyre të veçantë (Gonzalez-Mena, 2001).

Megjithatë, në të gjithë kulturat, ekziston një grup emocionesh që përjetojnë nga të gjithë, pavarësisht kulturës ose përvojës. Këto emocione janë: lumturia, trishtimi, frika, befasia, zemërimi dhe pakënaqësia. Ato konsiderohen si emocione themelore, universale, për shkak të idesë se ato janë instinktive (Eckman, 1992).

FUSHA: SHËNDETI, MIRËQENIA FIZIKE DHE ZHVILLIMI MOTOR

Zhvillimi motor fizik dhe lëvizor është një faktor mjaft i rëndësishëm në periudhën e hershme të zhvillimit të fëmijës. Rritja dhe zhvillim i fëmijës është i vullshëm sidomos në periudhën e parë të fëmijërisë së hershme 0- 3 vjeç. Megjithëse përdoren shpesh si terma të njëjtë, rritja dhe zhvillimi nuk kanë të njëjtin kuptim. Rritja e fëmijës, i referohet ndryshimeve specifike në strukturën trupore, ndryshime që kanë të bëjnë kryesisht me rritjen e peshës apo gjatësisë së fëmijës, rritjen e duarve apo këmbëve etj. Ndërkohë zhvillimi u referohet ndryshimeve në nivelin funksional dhe nivelin e kompleksitetit të këtyre ndryshimeve, kompleksitet që ndjek rregullin nga më i thjeshti, te më i ndërlikuari. Zhvillimi fizik u referohet ndryshimeve në nivelin funksional të strukturave trupore me kalimin e kohës, ndërkohë që, maturimi është i programuar në pikëpamjen gjenetike dhe ndodh natyrshëm me kalimin e kohës. Ai është i lidhur ngushtë me rritjen. Zhvillimi fizik dhe lëvizor është mjaft i vullshëm në tre vitet e parë të jetës së fëmijës, periudhë gjatë së cilës kockat dhe muskujt e fëmijës zhvillohen shumë. Gjithashtu edhe aftësitë e tyre koordinuese, të forcës dhe ekuilibrit zhvillohen po kaq vullshëm, duke bërë që ata të zhvillojnë me energji veprimtaritë e tyre ditore. Gjatë viteve të para të jetës, fëmijët përsosin aftësitë e tyre të zhvendosjeve si dhe aftësitë e tyre manipulative, duke u bërë kështu të aftë të gjenden në mjedisin e tyre. Një tjetër karakteristikë e zhvillimit është se fëmija zhvillohet prej reagimeve të përgjithshme më pak specifike drejt reagimeve më të kontrolluara specifike, përmes procesit që quhet diferencim. Zhvillimi fizik dhe lëvizor mbështet zhvillimin edhe në fusha të tjera, si ai social kur fëmija luan dhe bashkëvepron me fëmijë të tjerë, fushën njohëse kur fëmija eksploron jo vetëm objektet, rekuizitat, ambientin, por edhe strukturën e re lëvizore, etj. Procesi i zhvillimit të fëmijës në fushën e zhvillimit fizik dhe lëvizor, është paraqitur më poshtë sipas këtyre nënfushave:

NËNFUSHAT:

❖ *Aftësitë motorike bazë*

Zhvillimi i motorikës bazë përfshin kontrollin dhe lëvizjen e muskujve të mëdhenj të siç është trunghi, koka, këmbët dhe krahët. Fëmijët fillojnë të punojnë në aftësitë e tyre motorike bazë sapo lindin. Këto aftësi zhvillohen nga lart poshtë. Fëmijët, të cilët nuk kanë ndonjë sfidë zhvillimore apo shëndetësore, së pari fitojnë kontrollin mbi kokën e tyre. Në vazhdim, fëmijët fitojnë kontrollin e trungut të tyre dhe fillojnë të mësojnë ekuilibrin, të cilin e dëshmojnë nga aftësia e tyre për t'u përkulur dhe ulur.

❖ *Aftësitë motorike fine*

Motorika fine i referohet lëvizjes dhe koordinimit të muskujve të vegjël, siç janë ato në duar, kyçe, gishtërinj dhe këmbë. Foshnjat fillojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre të motorikës fine gjatë vitit të parë. Ata sjellin gishtërinjtë dhe shputat e këmbës në gojën e tyre, kapin objektet dhe mësojnë t'i rrotullojnë dhe t'i kthejnë ato. Kështu ata jo vetëm që përmirësojnë aftësitë e tyre të motorikës fine, por gjithashtu përmirësojnë koordinimin e tyre fizik. Koordinimi i tyre me sytë përmirësohet dhe fëmijët fillojnë të manipulojnë objektet e vogla, duke eksploruar të gjitha mënyrat se si

objektet mund të kombinohen ose ndryshohen. Veprimtaritë e përditshme të fëmijëve ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të tyre të motorikës fine. Këto aftësi përfshijnë ushqyerjen, shfletimin e librave dhe luajtjen me një larmi objekte të ndryshme. (Shelov, S.P. & Altman, T.R., 2009)

❖ **Aftësitë senso-lëvizore**

Zhvillimi perceptues i referohet mënyrës sesi fëmijët fillojnë të marrin, interpretojnë dhe kuptojnë inputin shqisor. Perceptimi i lejon fëmijët të përshtaten dhe të bashkëveprojnë me mjedisin e tyre përmes përdorimit të shqisave të tyre. (Bjorklund, 2000). Zhvillimi senso-lëvizor është i lidhur ngushtë me zhvillimin fizik, sepse aftësitë motorike në rritje të fëmijëve u lejojnë atyre të eksplorojnë mjediset e tyre në mënyra të reja. Fëmijët mësojnë për botën e tyre duke përfshirë shqisat e tyre me mjedisin rreth tyre. Kjo është arsyeja pse mjediset stimuluese të përshtatshme dhe angazhimi dhe ndërveprimi i rëndësishëm janë nxitës për fëmijët e vegjël.

❖ **Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten**

Fëmijët janë plotësisht të varur nga prindërit /edukatorët e tyre gjatë vitit të parë të jetës. Sidoqoftë, ata bëhen më të pavarur në arritjen e objekteve dhe lëvizjen nga një vend në tjetrin.

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHË</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të ndërtojnë bazat për “lexim-shkrimin” e hershëm duke eksploruar materialet e shtypura dhe duke ndërtuar një aftësi për të “lexuar” këto materiale.</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon vetëdije për materialet e shtypura, p.sh., shikon një pamje në një libër. • Shtrihet dhe kap librat. • Përdor shqisat për të eksploruar librat, p.sh., eksploron libra me struktura dhe citësi të ndryshme. • Përdor duart për të manipuluar materialet e shtypura, p.sh., përpiqet për të kthyer faqet e një libri, kopertinën, mban objekte në duar. • Tregon ose nxjerr tinguj gjatë shikimit të librave me figura. • Fokuson vëmendjen ndërsa shikon materialet e shtypura për periudha të shkurtra kohe. 	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët bëhen pjesëmarrës ndërsa ata aktivizohen në veprimtari lexim-shkrimi me materiale të shtypura.</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon fotografinë në një libër dhe reagon, p.sh., buzëqesh kur sheh foton e qenit. • Fillon veprimtaritë e shkrim-leximit, p.sh., bën gjeste drejt librit ose përpiqet të kthejë faqet e një libri, albumi ose reviste. • Imiton gjeste dhe tinguj gjatë veprimtarive, p.sh., veprimet e duarve gjatë leximit, murmurit sikur lexon kur kujdestari/edukatori lexon një libër. • Rrit aftësinë për t’u përqëndruar për periudha më të gjata kohore në materiale të printuara me struktura të ndryshme. • Kap objektet dhe përpiqet për të shkruar, p.sh., bën një gjurmë të lehtë me një laps në një copë letër. <p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni këngë dhe vjersha fjalësh me rimë; • Shënoni dhe emërtoni fotografitë në libra. • Lexoni ose tregoni histori që përsërisin fjalë ose fraza; sigurohuni të thoni ose tregoni këto fjalë ose fraza në gjuhë amtare të fëmijës, nëse keni fëmijë bilingjë, nëse është e mundshme. • Krijoni zona të caktuara në çerdhe ku librat janë lehtësisht të arritshëm. • Sigurojini fëmijës mundësi për të mbajtur lloje të ndryshme të mjeteve të shkrimit në duart e tij, p.sh., lapsa të mëdhenj ose lapustila të trashë etj.
<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të ndërtojnë bazat për “lexim-shkrimin” e hershëm duke eksploruar materialet e shtypura dhe duke ndërtuar një aftësi për të “lexuar” këto materiale.</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon vetëdije për materialet e shtypura, p.sh., shikon një pamje në një libër. • Shtrihet dhe kap librat. • Përdor shqisat për të eksploruar librat, p.sh., eksploron libra me struktura dhe citësi të ndryshme. • Përdor duart për të manipuluar materialet e shtypura, p.sh., përpiqet për të kthyer faqet e një libri, kopertinën, mban objekte në duar. • Tregon ose nxjerr tinguj gjatë shikimit të librave me figura. • Fokuson vëmendjen ndërsa shikon materialet e shtypura për periudha të shkurtra kohe. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantoni libra nga kultura e sfera të ndryshme dhe i përfshini ato në rutinat e përditshme të fëmijës. • Lejoni fëmijën të hulumtojë librat duke “lexuar” sipas tij dhe duke kthyer faqet. • Ndani me fëmijën lloje të ndryshme të materialeve të shtypura, p.sh. libra, albume, revista, kuti drithërash... • Emërtoni dhe tregoni objektet në mjedisin e fëmijës. • Kaloni kohë me fëmijën duke lexuar dhe duke parë libra së bashku. 	

STANDARDI: Fëmijët tregojnë interes dhe kuptueshmëri të materialeve të shtypura**16 muaj deri në 24 muaj:**

Fëmijët fillojnë të demonstrojnë një kuptim të fjalëve dhe materialeve të shtypura.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Shfleton faqet e një libri, një nga një.
- Tregon për fotografite dhe veprimet e njohura në libra.
- Përsërit fjalët e njohura në një libër kur lexohen.
- Fillon të parashikojë se çfarë mund të ndodhë më pas në një libër të njohur, p.sh., krijon tinguj dhe lëvizje dhe / ose përdor fjalë për fotot.
- Shkarravit në mënyrë rastësore.
- Identifikon një libër të preferuar dhe sinjalizon të tjerët me gjeste që duhet të lexojnë bashkë me atë.

Strategjitë për ndërveprim:

- Siguroni mundësi për qasje në revista dhe libra gjatë gjithë ditës së fëmijës në çerdhe.
- Nxitni fëmijën të përsërisë fjalët dhe të tregojë për objektet që gjenden në revista dhe libra.
- Emërtoni objektet në mjedisin e fëmijës, p.sh., shtrati, dritarja, tavolina, gota, biberoni.
- Kaloni kohë cilësore me fëmijën gjatë së cilës leximi është në fokus; ndiqni shembullin e fëmijës gjatë kësaj kohe.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët përfshijnë edhe të tjerët në veprimtari lexim-shkrimi dhe kanë një vetëdije të rritur për të kuptuar për shumëllojshmërinë e tipeve të ndryshme të materialeve të shtypura që gjenden në mjedisin e tyre

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Imiton rolin e të rriturve kur angazhohet me materiale të shtypura, p.sh. pretendon të lexojë një libër ose revistë të mbushur me foto kafshësh ose kukulla.
- Merr pjesë në veprimtari të hershme të lexim-shkrimit në mënyrë të pavarur, p.sh., ulet në një qoshe dhe shfleton faqet e librit.
- “Reciton” pjesë nga një libër nga ato që mban mend.
- Shkarravit në mënyrë më të rregullt dhe fillon të emërtojë atë që ka vizatuar.
- Shpreh atë që ndodh më pas kur lexoni një libër të njohur me kujdestarin/edukatorin, p.sh., përdor gjeste, fjalë dhe / ose tinguj.

Strategjitë për ndërveprim:

- Sigurojini fëmijës libra me të cilët mund të gjejë lidhje, p.sh., një libër në lidhje me ushqime të ndryshme, ose rreth familjes.
- Nxitni fëmijën të mendojë se çfarë po ndodh në libër ose çfarë do të ndodhë tjetër, duke përdorur fotografite si udhëzues.
- Siguroni mundësi që fëmija të përdorë materiale të tilla si letra, lapsa, lapustila dhe bojëra.
- Krijoni një libër të veçantë me fotografinë e fëmijës dhe sigurohuni që ai të reflektojë fëmijën

GJATË KËSAJ PERIUDHE

FUSHA: ZHVILLIMI KONJITIV

Zhvillimi konjitiv te fëmijët e vegjël i referohet procesit të tyre të të mësuarit dhe zhvillimit të inteligjencës dhe aftësive të tjera mendore, të tilla si: kujtesa, arsyetimi, zgjidhja e problemeve dhe të menduarit. Të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, kulture, etnie, race, lindin për të mësuar dhe janë të gatshëm që në lindjen e tyre të përjetojnë botën përreth. Që nga fëmijëria e hershme fëmijët duhen stimuluar që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin e njohjes rreth njohurive të përgjithshme.

Kur atyre u ofrohet stimulim, ushqim dhe një mjedis i sigurt, ata përdorin të gjitha shqisat e tyre për të eksploruar atë që i rrethon. Fëmijët që në vitin e parë të lindjes, prekin dhe shijojnë çdo gjë që ata mundin dhe në këtë mënyrë fillojnë të mësojnë rreth formave, madhësisë, përbërjes dhe funksionimit të objekteve. Ata shohin dhe dëgjojnë objektet përreth tyre dhe në mënyrë të veçantë janë të tërhequr nga fytyrat dhe zërat.

Shkalla në të cilën fëmijët mësojnë gjatë tri viteve të para është e jashtëzakonshme; ata do të mësojnë më shumë në këto tre vite të para sesa në çdo pikë tjetër të jetës së tyre.

Zhvillimi konjitiv vërehet përmes sjelljeve specifike. Në foshnjërinë e hershme, fëmijët kanë aftësi të kufizuar për të shprehur të kuptuarit mendor të jashtëm. Kjo nuk do të thotë që ata nuk janë duke mësuar, ose se nuk janë në gjendje të mbledhin dhe përpunojnë informacione shqisore që po marrin. Fëmijët përdorin të gjitha shqisat e tyre për të marrë informacion dhe për të filluar të formojnë koncepte të thjeshta.

NËNFUSHAT:

❖ *Zhvillimi i konceptit*

Fëmijët përdorin ndërveprimet e tyre të përditshme për të krijuar mirëkuptim dhe për t'u dhënë kuptim njerëzve dhe objekteve në mjedisin e tyre. Në foshnjëri, fëmijët përdorin shqisat e tyre për të marrë informacione rreth mjedisit të tyre fizik. Ata mësojnë rreth vetive të objektit përmes eksplorimit fizik dhe ndërveprimeve të tyre me kujdestarët/edukatorët e tyre.

Fëmijët fillojnë të ndërtojnë skema, ose modele të organizuara të mendimit, për informacionin që marrin; këto skema së shpejti zhvillohen në përfaqësime mendore ose koncepte të sendeve dhe njerëzve. (Bjorklund, 2000)

❖ *Kujtesa*

Përvojat e hershme i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë konceptet dhe kategoritë themelore, duke i ndihmuar ata të krijojnë kuptimin e botës përreth tyre. Fëmijët fillojnë të krijojnë kujtime përmes bashkëveprimeve të përditshme me kujdestarët/edukatorët dhe mjedisin e tyre. Para zhvillimit të qëndrueshmërisë së objektit, fëmijët bëhen të njohur me njerëzit, objektet dhe veprimet. (Stern, 1985).

❖ **Marrëdhëniet hapësinore**

Marrëdhëniet hapësinore i referohen kuptimit të fëmijëve se si lëvizin sendet dhe njerëzit në lidhje me njëri-tjetrin.

Në foshnjëri, fëmijët përdorin shqisat e tyre për të vëzhguar dhe marrë informacione rreth objekteve dhe njerëzve në mjedisin e tyre.

Ata mund të shohin dhe ndjekin njerëzit dhe objektet me sytë e tyre. Ata përqendrohen në shqiptimin dhe kapjen e objekteve për të mësuar rreth vetive të tyre fizike.

Ndërsa rriten, fëmijët provojnë dhe gabime për të eksperimentuar me veprimet.

❖ **Të menduarit simbolik**

Fëmijët mësojnë për objektet, veprimet dhe njerëzit përmes vëzhgimeve, bashkëveprimit dhe eksplorimit. Ata marrin informacion brenda të gjitha shqisave të tyre për të krijuar një kuptim themelor të botës përreth tyre.

❖ **Shprehja Krijuese**

Shprehja krijuese i referohet mënyrës sesi fëmijët përdorin muzikën, lëvizjet, ndërtojnë dhe luajnë për të shprehur veten e tyre.

Që në moshë shumë të hershme, fëmijët shfaqin interes për

tingujt, ngjyrat, objektet dhe materialet. Në foshnjëri, fëmijët

përfshihen në eksplorimin ndijor; ata shqiptojnë objekte të ndryshme për të mësuar rreth tyre, dhe përdorin duart e tyre për t'i ndjerë dhe lëvizur ato. Gjatë kësaj periudhe, fëmijët janë të vetëdijshëm për tinguj të ndryshëm dhe shpesh dëgjohen duke gatur dhe duke belbëzuar.

Afërsisht rreth moshës një vjeçare, fëmijët janë në gjendje të trokasin duart dhe të lëvizin trupat e tyre sipas muzikës dhe ritmit. Gjatë vitit të dytë, fëmijët shprehin në mënyrë kreative mendimet dhe ndjenjat e tyre përmes lojërave simbolike, të njohura gjithashtu si lojëra pretenduese. Rreth moshës 3-vjeçare fëmijët ndërtojnë struktura gjithnjë e më komplekse, dhe këto veprimtari shpesh ndërthuren me lojërat e pretenduara.

❖ **Logjika dhe arsyetimi**

Fëmijët përdorin imitim, shkak dhe efekt, provë dhe gabim për të ndërtuar aftësitë e tyre logjike dhe arsyetuese. Fëmijët i mësojnë këto aftësi përmes ndërveprimeve të përditshme me kujdestarët e tyre. Që në fillim, fëmijët zbulojnë se veprimet dhe sjelljet e tyre kanë ndikim në sjelljet dhe veprimet e njerëzve dhe objekteve.

Ata mësojnë për shkakun dhe pasojën duke përsëritur të njëjtat veprime pa pushim në mënyrë që të japin të njëjtat rezultate. Gjatë vitit të dytë, logjika dhe aftësitë e arsyetimit të fëmijëve përmirësohen ndërsa përdorin gjykimin dhe provojnë edhe gabimin për të zgjidhur problemet. Ata kanë një kuptim më të mirë ndërmjet modeleve dhe marrëdhënieve, ndikimeve të sjelljeve të caktuara në objekte dhe njerëz dhe fillojnë të përdorin këto modele në mënyra të ndryshme. Nga moshë 36 muajsh, mund të komunikojnë shkakun dhe pasojën dhe zgjidhjen e problemeve në mënyrë më efektive.

❖ **Sasia dhe numrat**

Fëmijët kanë një vetëdije të hershme për konceptet e numrave. Në foshnjëri, fëmijët fillojnë të mësojnë për sasinë përmes bashkëveprimit me mjedisin dhe kujdestarët/edukatorët e tyre. Ata fillojnë të demonstrojnë të kuptuarit e "më shumë" përmes gjuhës së trupit.

Fëmijët e vegjël janë gjithashtu të vetëdijshëm se ekziston më shumë se një objekt në mjedisin e tyre. Kjo tregohet kur fëmijët lëshojnë një objekt për të arritur tek një tjetër. Megjithatë nuk janë në gjendje të përcaktojnë numrin e objekteve, ata krijojnë themelin për konceptin "më shumë". Ata nuk do të jenë në gjendje të përputhen me sasinë e saktë të sendeve me fjalët e tyre deri afër moshës 36 muajshe, por përdorin aftësitë imituese dhe lojën për të krijuar sensin e numrave.

❖ **Konceptet shkencore dhe eksplorimi**

Fëmijët mësojnë rreth koncepteve shkencore përmes eksplorimit të mjedisit të tyre të brendshëm dhe të jashtëm. Ata përdorin të gjitha shqisat e tyre për të marrë informacione të reja dhe të mësojnë në mënyrë aktive për botën e tyre.

Ata janë të interesuar dhe kureshtarë për gjërat e gjalla dhe fillojnë të bëjnë pyetje të thjeshta për natyrën. Ata gëzojnë të kalojnë kohën jashtë dhe marrin objekte për të vëzhguar, të tilla si gjethë, guralecë ose lule. Ata janë gjithashtu të aftë të identifikojnë karakteristikat e gjallesave me të cilat njihen.

❖ **Siguria dhe mirëqenia**

Në vitet e para të jetës, fëmijët varen nga kujdestarët/edukatorët e tyre për t'i mbajtur ata të sigurt dhe të shëndetshëm për zhvillimin e duhur. Fëmijët kanë filluar të rritin aftësinë e tyre për të njohur situata potencialisht të pasigurta ose jo të shëndetshme, por do t'ju duhet një mbështetje e kujdestarit/edukatorit. Fëmijët e ndërtojnë këtë aftësi duke vendosur besim te kujdestarët/edukatorët, të cilët janë të qëndrueshëm në plotësimin e nevojave të tyre. Aftësitë konjitive në rritje i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë se ekzistojnë rregulla të sigurisë, përgjatë të cilave ata ndërtojnë në kujtesën e tyre atë që lejohet dhe atë çfarë nuk lejohet për ta.

Nënfisha: Zhvillimi i konceptit

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësinë për të lidhur pjesë të informacionit për të kuptuar objektet, idetë dhe marrëdhëniet

<p>GCATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të marrin dhe organizojnë informacione përmes ndërveprimeve shoqërore dhe eksplorimit ndijor.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të njohin karakteristikat e objektit dhe të ndërtojnë vetëdijen për konceptet e thjeshta përmes ndërveprimeve dhe eksplorimeve.</p>
<p>Koncepti i referohet një nocioni të përgjithshëm ose një ideje abstrakte të formuar në mendje, rreth një dukurie të veçantë. Përvojat e hershme formojnë skema, të cilat formohen brenda koncepteve</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kthen kokën drejt tingujve. • Fillon të përqendrohet në objekte, tinguj dhe njerëz. • Eksploron në mënyrë aktive mjedisin përmes pesë shqisave. • Përpiqet për të përsëritur një veprim, p.sh., prek tryezën dhe përpiqet ta bëjë përsëri. • Përqendrohet dhe fillon të bëjë dallimin midis objekteve, tingujve dhe njerëzve të njohur dhe të panjohur. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon qëndrueshmërinë e objektit, duke qenë të vetëdijshëm që një objekt ekziston edhe kur nuk është fizikisht i dukshëm, p.sh., e heq mbulesën nga biberoni, qan kur kujdestari/edukatori largohet nga dhoma. • Përdor veprime fizike gjatë eksplorimit të objekteve, p.sh., rrokullis një top para-mbrapa në dysheme, hedh qëllimisht objektin në mënyrë të përsëritur në dysheme për t'u kapur. • Identifikon dhe tregon objektet dhe njerëzit në foto. • Fokuson vëmendjen tek objektet, njerëzit dhe tingujt.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni kujdes të përgjegjshëm dhe stimules; lexoni shenjat e foshnjës. • Siguroni objekte që fëmija mund të manipulojë, t'i shqiptojë dhe t'i kuptojë. • Imitoni veprimet që fëmija përpiqet të bëjë. • Angazhohuni në lojë me fëmijën; ndiqni shembullin e fëmijës. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni kujdes të përgjegjshëm dhe stimules; lexoni shenjat e foshnjës. • Siguroni objekte që fëmija mund të manipulojë, t'i shqiptojë dhe t'i kuptojë. • Imitoni veprimet që fëmija përpiqet të bëjë. • Angazhohuni në lojë me fëmijën; ndiqni shembullin e fëmijës. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni lojëra për të fshehur objektet nga fëmija dhe për të nxitur fëmijën t'i gjejë ato. • Demonstroni se si t'i bëni objektet e ndryshme të lëvizin, p.sh., të rrokulliset një top butësisht drejt fëmijës. • Emërtoni objektet që gjenden në mjedisin e fëmijës. • Bisedoni me fëmijën për objektet dhe karakteristikat e tyre, p.sh. "Të dija këto janë të kuqe". • Emërtoni objektet dhe fotografitë që tregon fëmija.

Skemat janë modele dhe procese të hershme që organizojnë informacione dhe ndihmojnë foshnjat të kuptojnë mjedisin e tyre.

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësinë për të lidhur pjesë të informacionit për të kuptuar objektet, idetë dhe marrëdhëniet

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët fillojnë të kuptojnë përfaqësimin e objektit dhe fillojnë të përdorin komunikim verbal dhe joverbal me përdorimin e objektit.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Pretendon të përdorë objektet në mënyrën e tij të synuar, p.sh., mban një telefon lodër në vesh dhe angazhohet në një bisedë duke murmuritur.
- Fillon të identifikojë dhe emërtojë objekte dhe njerëz.
- Përdor një objekt për të përfaqësuar një tjetër gjatë lojës, p.sh., përdor një lodër si telefon.
- Fillon të identifikojë karakteristikat e objektit, p.sh., "topi i kuq".
- Grupon me ndihmë disa objekte sipas karakteristikave të ngjashme, p.sh., ngjyra, forma ose madhësia.

Strategjitë për ndërveprim:

- Vazhdoni të klasifikoni mjedisin e fëmijës për atë vetë; prezantoni objekte të reja për fëmijën duke i emërtuar ato.
- Angazhohuni në lojë me fëmijën; ndiqni shembullin e fëmijës.
- Krijoni një lojë të thjeshtë ku fëmija mund të përpiqet të rendisë objektet sipas veçorive.
- Nxitni fëmijën të identifikojë objektet që janë të njëjta, p.sh. ato që përputhen për të njëjtën veprimtari.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët fillojnë të demonstrojnë aftësinë për të klasifikuar objektet bazuar në karakteristikat e zakonshme dhe fillojnë të zbatojnë njohuri për konceptet e thjeshta në situata të reja.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Identifikon karakteristikat e objekteve dhe njerëzve kur emërtohen, p.sh., ngjyrat.
- Fillon të rregullojë objekte në një rresht, p.sh., rreshton makinat lodra njëra pas tjetrit.
- Përdor përfaqësimin simbolik gjatë lojës, p.sh., merr një furçë flokësh dhe e përdor si telefon.
- Organizon me qëllim objekte të ngjashme, p.sh., ndan bllloqet plastike në një grup të kuq, një grup blu dhe një grup të verdhë.
- Identifikon kategoritë, p.sh., është në gjendje të tregojë të gjitha kafshët brenda një pamjeje edhe me lloje të ndryshme të objekteve të përfaqësuar.

Strategjitë për ndërveprim:

- Përfshini mësimin rreth ngjyrave në këngë, lexime dhe lojëra ndijore.
- Siguroni materiale dhe objekte të ndryshme me të njëjtën formë dhe ngjyrë, p.sh., bllloqet.
- Luani lojëra të thjeshta që përputhen me fëmijën; ofroni udhëzime sipas nevojës.
- Zgjeroni lojën e fëmijës duke paraqitur mënyra të reja për të përdorur objekte të njohura.
- Krijoni një lojë të thjeshtë ku fëmija mund të përpiqet të rendisë objektet me dy ose tre veçori.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nënfisha: Kujtesa

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësi për të fituar, ruajtur, rikujtuar dhe zbatuar përvojat e kaluara

GJATË KËSAJ PERIUDHE	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të formojnë kujtime nga përvojat e tyre, si dhe fillojnë të parashikojnë modele të caktuara për ndodhitë.</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kthehet drejt zërave, tingujve dhe / ose objekteve të njohura. • Parashikon ngjarje të njohura, p.sh., shtrihet për të arritur një shishe që ta futë në gojë. • Gjen një objekt që është fshehur pjesërisht. • Kujton që objektet dhe njerëzit ekzistojnë akoma edhe kur ato nuk janë fizikisht të pranishëm, p.sh., kërkojnë për prindin, pasi ai ka dalë nga çerdhja. 	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët mbajnë mend njerëz të njohur, rutina, veprime, vende dhe objekte</p> <p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjejnë objekte të fshehura, p.sh., heqin mbulesën për të zbuluar lodrën, sepse kanë parë kujdestarin/edukatorin ta fshehë. • Tregojnë vetëdijen për të rriturit e njohur që nuk janë të pranishëm, p.sh., mgjs ndodhen në çerdhe kërkojnë mamin dhe babin gjatë gjithë ditës. • Kërkojnë për objekte në vendndodhjen e tyre të zakonshme, p.sh., gjen librin e preferuar në raftin e librave. • Parashikojnë se çfarë ngjarje vjen më pas në rutinën e tij të përditshme, p.sh., ulet për vaktin e radhës pas një veprimtarie të caktuar.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni lodra dhe objekte interesante dhe të përshtatshme për moshën, për t'i eksploruar fëmija. • Angazhohuni dhe bashkëveproni shpesh me fëmijën gjatë ditës. • Fshihni lodrat nën batanije dhe prisni që fëmija të përgjigjet për t'i gjetur. • Luani lojëra të tilla si "ku është fshehur" ose, "lodra në kuti". 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Luani me fëmijën duke përdorur objekte të ndryshme të cilat mund t'i eksplorojë. • Vendosni rutinat; krijoni kartela fotografish me rutinën e përditshme kështu fëmija mund të fillojë të kuptojë se çfarë do të përbëjë gjatë ditës. • Luani lojëra të thjeshta që përfshijnë fshehjen e një lodre në një vend të afërt. • Përgjigjuni fëmijës në mënyrë të ndjeshme kur ai pyet për dikë që nuk është aktualisht atje, p.sh., "mami yt; ajo do të kthehet së shpejti për t'ju marrë". 	

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësi për të fituar, ruajtur, rikujtuar dhe zbatuar përvojat e kaluara**16 muaj deri në 24 muaj:**

Fëmijët njohin dhe parashikojnë serinë e hapave në veprimtaritë e njohura.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Kujton disa hapa në rutinat e njohura dhe i kryen këto rutina me pak ose aspak nxitje.
- Kujton një ngjarje në të kaluarën, p.sh., një vizitor special, ose festën e ditëlindjes së një mikui.
- Kërkon për objekte në vende të ndryshme.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët parashikojnë hapat në përvojat dhe veprimtaritë e tyre dhe kuptojnë sekuençën e ngjarjeve. Ata gjithashtu mund të mbajnë mend dhe kujtojnë ngjarjet e kaluara dhe shpjegojnë njohuritë e përvojave të kaluara me përvojat e reja.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Ndan me të rritur atë që ndodh në çerdhe atë ditë.
- Kryen rutinat në mënyrë të pavarur pa u kujtuar se çfarë vjen më pas në rutinën e përditshme.
- Përdor lojëra për të komunikuar rreth ngjarjeve ose përvojave të mëparshme, duke përfshirë rendin e ngjarjeve që kanë ndodhur, p.sh., një milk, një festë ditëlindjeje.
- Përkthen njohuritë e kaluara në përvoja të reja, p.sh., kujton një vizitë të dentistit, rrëfen çdo hap të përvojës mbi një bashkëmoshatar gjatë lojës.

Strategjitë për ndërveprim:

- Angazhohuni me fëmijët në biseda që kanë të bëjnë me përvojat e kaluara; bëni pyetje.
- Njoftoni fëmijën kur do të bëni një ndryshim në rutinën e përditshme.
- Pyesni fëmijën se çfarë mendon se mund të ndodhë tjetër kur lexoni një histori e njohur.

Strategjitë për ndërveprim:

- Dëgjoni tregimet e fëmijës; bëni pyetje me fund të hapur.
- Modeloni sekuenca gjatë lojës, p.sh. "Së pari do të dalim nga çerdhja, do të shkojmë në park, do të luajmë së bashku dhe në fund do të kthehemi në shtëpi."
- Lexoni një histori bashkë me fëmijën; pyeteni fëmijën nëse ai mund të kujtojë atë që ndodh në një pjesë të caktuar të historisë.
- Nxitni fëmijën të krijojë një histori rreth një fotografie që ai ka vizatuar.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nënfisha: Marrëdhëniet hapësinore

STANDARDI: Fëmijët shfaqin vetëdije për sa i përket objekteve dhe njerëzit lëvizin dhe përshtaten në hapësirë

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHË</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët përdorin vëzhgimin dhe eksplorimin shqisor për të filluar ndërtimin e të kuptuarit se si sendet dhe njerëzit lëvizin në marrëdhënie me njëri-tjetrin.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të përdorin gjykimin dhe gabimin në zbulimin se si sendet dhe njerëzit lëvizin dhe përshtaten në marrëdhënie me njëri-tjetrin.</p>
<p>Marrëdhëniet hapësinore i referohen mënyrës sesi objektet dhe njerëzit janë të vendosur në hapësirë në raport me objektet dhe njerëzit e tjerë.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon objektet dhe njerëzit në mjedisin e afërt, p.sh., shikon duart dhe këmbët e veta, ndjek kujdestarin/edukatorin me sy, kthen kokën drejt tingujve. • Arrin dhe kap objektet. • Eksploron përmes përdorimit të shqisave të ndryshme, p.sh., fillon të hapë gojën dhe / ose prek objektet. • Fokuson vëmendjen te një objekt në lëvizje dhe e ndjek atë, p.sh., shikon një zile lodrash pasi bie. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendosi objektet në një kovë dhe pastaj i zbraza ato; përsërit këtë veprim. • Fillon të identifikojë pengesat fizike dhe zgjidhjet e mundshme kur vjen rrotull p.sh., zvarritet rreth një karrigeje dhe poshtë saj. • Rrëzon sende të tilla si lodra dhe ndjek lëvizjen e tyre. • Diferencon midis objekteve të vogla dhe të mëdha, përdor njëriën dorë ose të dy duart në mënyra të ndryshme.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni lodra dhe objekte interesante dhe të përshtatshme për moshën për eksplorim nga fëmijët. • Angazhohuni dhe bashkëveproni shpesh me fëmijën gjatë ditës; ndiqni shembullin e fëmijës gjatë lojës. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni lloje të ndryshme të objekteve që fëmija mund t'i lëvizë, p.sh., makina lodra, topa, gota për të bërë fole. • Krijoni hapësira të sigurta loje në të cilat fëmija mund të zvarritet, të ngjitet dhe të lëvizë. • Siguroni kohë që fëmija të hulumtojë dhe bashkëveprojë në mjedisin e jashtëm.

STANDARDI: Fëmijët shfaqin vetëdije për sa i përket objekteve dhe njerëzit lëvizin dhe përshtaten në hapësirë**16 muaj deri në 24 muaj:**

Fëmijët kanë një sens më të qartë të madhësisë dhe drejtimit dhe e përdorin këtë njohuri për të zgjeruar të kuptuarit e tyre se si objektet lëvizin dhe përshtaten në marrëdhënie me njëri-tjetrin.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Kupton fjalë që karakterizojnë madhësinë, p.sh., të mëdha, të vogla.
- Provon dhe bën gabime të thjeshta për të kompletuar pazëllat e thjeshta, p.sh. përputh pjesë.
- Njeh drejtimin e duhur të objekteve, p.sh., kthen një flixhan me kokë poshtë.
- Fillon të kuptojë parafjalët e thjeshta, p.sh., nën, në, prapa...

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët mund të parashikojnë më mirë se si sendet dhe njerëzit do të përshtaten dhe të lëvizin në marrëdhënie me njëri-tjetrin. Fëmijët kanë njohuri për **karakteristikat e objekteve** dhe i zbatojnë këto njohuri pa pasur nevojë të mbështeten në gjykimin fizik.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Përdor fjalë dhe gjeje për të përshkruar madhësinë e sendeve.
- Percepton se ku është trupi i tij në lidhje me objektet, p.sh., është duke u futur pas një karrigeje.
- Plotëson pazëlla të thjeshta me më pak prova dhe gabime, p.sh., mund të përputhë një copë pazëll të saktë në tërësinë e saj, duke identifikuar madhësinë dhe formën, duke e parë thjesht atë.
- Përdor trupin në mënyrë aktive për të ndryshuar pozicionin e tij atje ku është, në lidhje me objektet, p.sh., ngjitet për t'u ulur në shtrat.

Strategjitë për ndërveprim:

- Përdorni rrefimin ndërsa ndihmoni fëmijën për të gjetur një zgjidhje, p.sh. "Le të përpiqemi ta kthejmë copëzën e pazëllit në këtë mënyrë".
- Sigurojini fëmijës mundësi për të zgjidhur problemet edhe pa ndihmën tuaj; • Minimizoni mundësinë që fëmija të irritohet.
- Filloni t'i kërkoni fëmijës të bëjë veprime të thjeshta që përfshijnë një parafjalë, p.sh., "A mund ta vendosni librin mbi tryezë?"

Strategjitë për ndërveprim:

- Siguroni veprimtari me pazëlla dhe veprimtari të tjera të motorikës fine për të angazhuar fëmijën.
- Angazhoni fëmijët në veprimtari lëvizjeje që promovojnë aftësi ekuilibri.
- Përshtatuani objektet e përditshme sipas madhësisë, formës dhe karakteristikave të tjera.
- Krijoni një grup pengesash të sigurta ku fëmija mund të vrapojë, të ngjitet, të zvarritet, të struket duke manovruar me trupin e tij.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Karakteristikat e objektit janë karakteristika të vëzhguara nga fëmijët tek objektet. Shembuj të karakteristikave të objektit përfshijnë: madhësinë, peshën, formën, ngjyrën dhe temperaturën.

Eksplorime të përditshme

Fëmijët eksperimentojnë me karakteristikat e objektit shumë herët. Në fillim, ata përdorin vëzhgimin për të marrë informacione nga mjedisi i tyre. Ata vërejnë kontraste në ngjyra dhe modele. Ata janë në gjendje të krijojnë fytyrat njerëzore dhe të fillojnë të dallojnë mes tyre. Me rritjen e tyre fëmijët përdorin eksplorimet fizike për të mësuar në lidhje me vetitë e objektit. Fëmijët kalojnë këtë eksplorim duke filluar thjesht nga futja e objektit në gojë ose përplasja e tij, përþjekja për ta shtrembëruar ose shtrënguar, në mënyrë që të mësojnë dhe eksplorojnë. Ata mësojnë të identifikojnë se cilat objekte paraqesin rezultate specifike.

Për shembull, ata mund të ndezin dhe çaktivizojnë një çelës të dritave të makinës lodër ose të shtypni butona në objekte të ndryshme për të prodhuar muzikë ose drita me ngjyra të ndryshme. Fëmijët vazhdojnë të bëhen gjithnjë e më të vetëdijshëm për karakteristikat e objektit ndërsa fillon e rritet njohja rreth tyre. Ata së shpejti do të jenë në gjendje të emërtojnë dhe të bëjnë dallimin midis ngjyrave dhe formave. Gjithashtu do të jenë në gjendje të identifikojnë ndryshimet në peshë dhe sasi. Përvojat shqisore, siç është loja me ujë dhe rërë, gjithashtu mbështesin fëmijët në dallimin midis materialeve të ndryshme.

Nënfusha: Të menduarit simbolik

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë të kuptuarit e koncepteve, përvojave dhe ideve përmes përfaqësimit simbolik

<p>GTATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët përdorin vëzhgimin, eksplorimin dhe bashkëveprimin shoqëror për të mësuar rreth objekteve, veprimeve dhe njerëzve</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët përdorin ndërveprimin shoqëror për të vazhduar nxjerrjen e kuptimit nga objektet, veprimet dhe njerëzit. Fëmijët kalojnë nga eksplorimi i objekteve tek të mësuarit se si të luajnë me objektet në mënyrat që ata synojnë të përdorin. Në fund të kësaj periudhe moshe, fëmijët fillojnë të përdorin një objekt për të përfaqësuar një objekt tjetër.</p>
<p>Përfaqësimi simbolik i referohet kuptueshmërisë së fëmijëve se si imazhe ose objekte të ndryshme mund të përfaqësojnë objekte të njohura.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor shqisat për të eksploruar objektet, p.sh., vëzhgon, fut në gojë, prek. • Bashkëvepron me kujdestarin/edukatorin dhe mjedisin. • Manipulon fizikisht me objektet, p.sh., rrotullon dhe kthen lodrat, hedh sendet. • Kombinon objektet në lojë. • Gjeneron një objekt që është fshehur pjesërisht. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron qëndrueshmërinë e objektit, p.sh., përfytyron objekte dhe njerëz që ekzistojnë ende, edhe kur nuk janë fizikisht të dukshëm. • Limiton veprimet e të rriturve, p.sh., bën zhurmë me zile ose raketake pasi ka vëzhguar një të rritur që e përfundon këtë veprim. • Angazhohet në lojëra të thjeshta të pretenduara, p.sh., pretendon të pijë çaj nga një flixhan çaji; pretendon të ushqejë një kukull me një biberon lodër, sikur ta kishte fëmijë; përdor një lodër si telefon dhe pretendon të flasë me mamën. • Identifikon njerëzit e njohur dhe / ose objektet në fotografi.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijoni një mjedis tërheqës që fëmija të eksplorojë; ndryshoni materiallet dhe lodrat në mjedisin e fëmijës rregullisht. • Ndërveproni dhe angazhoni në mënyrë shoqërore shpesh fëmijën gjatë gjithë ditës, p.sh., përdorni kohën e të ushqyerit për të komunikuar me lojëra me fëmijën. • Ndiqni shembullin e fëmijës gjatë lojës. • Siguroni lodra dhe përvoja që kanë një larmi ngjyrash, materialesh, tingujsh dhe aromash. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjiguni me entuziazëm kur fëmija demonstroi përdorime të reja për objektet që ai ka zbuluar. • Luani me fëmijën shpesh; ndiqni shembullin e tij. • Imitoni fëmijën gjatë lojës, p.sh., mbani një telefon të pretenduar prej tij në vesh. • Emërtoni objekte dhe njerëz që gjenden në mjedisin e fëmijës.

Qëndrueshmëria e objektit i referohet kuptimit të fëmijëve që objektet vazhdojnë të ekzistojnë edhe pse ato nuk mund të shihen ose nuk mund të dëgjohen më.

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë të kuptuarit e koncepteve, përvojave dhe ideve përmes përfaqësimit simbolik

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët demonstrojnë fillesat e të menduarit simbolik ndërsa fillojnë të emërtojnë objekte në jetën e përditshme. Fëmijët gjithashtu përdorin ndërveprime më komplekse sociale dhe përfshihen në lojë imagjinare për të kuptuar botën përreth tyre.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Pretendon se një objekt është me të vërtetë në rolin e një objekti tjetër duke përdorur zëvendësimin, p.sh., një fazoletë e përdor për pelenën e një foshnje.
- Gjen objektet pasi ato fshihen në afërsi.
- Angazhohet në lojë të pretenduar me objekte dhe përvoja të njohura, p.sh., vendos kukullën në karrocë dhe e nxjerr për shëtitje.
- Identifikon ose emërton vizatimet e tij, p.sh., tregon shkarravitjet e tij dhe thotë, "mami dhe babi"
- Komunikon emërtimet të objektet e njohura dhe / ose njerëzit, p.sh., thotë "qen" kur sheh kafshë me katër këmbë.

Strategjitë për ndërveprim:

- Angazhohuni dhe luani me fëmijën; ndiqni shembullin e fëmijës.
- Përfshihuni gjatë lojës së fëmijës, p.sh., "A po e merr edhe fëmijën për shëtitje në dyqan?"
- Përsëritni fjalët që fëmija po përpiqet t'u kushtojë kuptim, p.sh., të themi, "po, bebi", kur fëmija tregon një fotografi të një foshnje.
- Nxitni dhe lavdëroni fëmijën kur ai ndan arritjet me ju.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët përdorin aftësinë e tyre për të emërtuar dhe mendojnë në mënyrë simbolike për t'u përfshirë në ndërveprime gjithnjë e më komplekse shoqërore, eksplorime dhe lojë. Fëmijët i përdorin këto aftësi për të rikrijuar përvojat për zgjidhjen e problemeve dhe për të eksploruar marrëdhëniet dhe rolet.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- U cakton role bashkëmoshatarëve ndërsa janë të përfshirë në një lojë imagjinare.
- Mbështetet në sekuenat e lojës ndërsa është përfshirë në lojë, p.sh., fillimi, mesi dhe fundi.
- Komunikon karakteristikat e njerëzve ose të sendeve që nuk janë të pranishëm, p.sh., thotë: "Mami ime ka sy blu".
- Projekton ndjenja dhe fjalë mbi kafshët prej pellushi, p.sh., "Kali është i trishtuar".
- Merret me role të ndryshme për të rritur gjatë lojës dhe përdor si duhet mekanizmat, p.sh., pretendon të jetë mësues/e dhe e bën zërin kur flet si i rritur, ndërsa pretendon se po lexon një libër tek fëmijët e tjerë.

Strategjitë për ndërveprim:

- Ndërveproni me fëmijën gjatë realizimit të pretendimeve dhe ndiqni shembullin e tij.
- Bëni pyetje të hapura ndërsa luani me fëmijën me qëllim që të zgjerohet mendimi dhe gjuha.
- Vazhdoni të emërtoni dhe tregoni veprimet, objektet dhe përvojat për fëmijën.
- Nxitni fëmijën të përdorë objekte në mënyrë krijuese për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, p.sh., duke përdorur një mbulesë si një përparësë, sepse përparëset e tjera janë zënë të gjitha nga fëmijët e tjerë.


GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nënfusha: Shprehja krijuese

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësi për të përcjellë ide dhe emocione përmes shprehjes krijuese

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHË</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët ndërtojnë fillimet e shprehjes krijuese përmes bashkëveprimeve të përditshme me kujdestarët /edukatorët e tyre.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët gjithnjë e më shumë angazhohen me kujdestarin/edukatorin e tyre dhe tregojnë kënaqësi në veprimtari dhe ndërveprime që përqendrohen në muzikë, lëvizje, ndërtim dhe lojë.</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkon në mënyrë aktive nëpërmjet shqisave, objektet në mjedis. • Merr pjesë në bashkëveprime me kujdestarin/edukatorin , p.sh., vështron, buzëqesh, guet. • Demonstron interes për tingujt, këngët, muzikën dhe ngjyrrat. • Dëgjon dhe lëviz me tingujt e muzikës. • Manipulon me objektet, p.sh., i kap, i tund, bën zhurmë. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gezohet me këngë të njohura dhe fjalë-vjersha me rimë. • Fillon të përdorë një lojë simbolike ndërsa bashkëvepron, p.sh., mban një objekt si telefon në vesh dhe bën një "bisedë" me gjyshen. • Fillon të grumbullojë forma/bloqe të mëdha me ose pa mbështetje. • Merr pjesë në veprimtari muzikore duke performuar me shoqërim të muzikës me lëvizjet e duarve. • Angazhohet në veprimtari arti si ngjyrosja ose piktura me gishta.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni fëmijës zgjedhje për eksplorim; ndiqni shembullin e fëmijës. • Ndërveproni në mënyrë domethënëse me fëmijën gjatë gjithë ditës. • Bëni muzikën pjesë të çdo dite; këndoni këngë me fëmijën. • Siguroni lodra dhe veprimtari që nxitin lëvizjen, p.sh., një daulle lodër, një tunel për t'u zvarritur përmes etj. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këndoni këngë me fëmijën dhe modeloni çdo gjest shoqërues. • Sigurojini fëmijës mundësi të ndryshme për krijimin e veprave artistike. • Demonstroni kënaqësi në muzikë dhe merrni pjesë aktive me fëmijën ndërsa këndon. • Nxitni fëmijën të eksplorojë materiale të ndryshme ndërsa luan

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësi për të përcjellë ide dhe emocione përmes shprehjes krijuese




<p>16 muaj deri në 24 muaj: Fëmijët vazhdojnë të tregojnë rritje të aftësive kur angazhohen me kujdestarin/edukatorin e tyre në muzikë, lëvizje, ndërtim dhe veprimtari të lojës.</p>	<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët nisnin vetë dhe përfshihen në muzikë, lëvizje, ndërtim, si dhe luajnë në veprimtari për të bashkëvepruar me të tjerët dhe për të shprehur ide, ndjenja dhe emocione.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Imiton lëvizjet bazë gjatë një veprimtarie, p.sh., vendos një kuti kartoni në kokë. • Angazhohet në lojëra më të ndërlukuara, p.sh., përdor një banane lodër si telefon. • Kënaqet me përdorimin e instrumenteve ndërsa dëgjon muzikë. • Ndërton, duke përdorur objekte dhe materiale të ndryshme, p.sh., rreshton makina, rafte, kuti të vogla... • Kënaqet me prishjen e asaj që ka ndërtuar, p.sh., duke goditur mbi një piring bllaqesh me dorën ose me lodrën e tij. • Krijon vepra arti; përqendrohet dhe kënaqet më shumë me procesin sesa me produktin përfundimtar. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zgjedh lëvizjet që pasqyrojnë gjendjen shpirtërore, p.sh., kërcen lart e poshtë kur është i ngazëllyer. • Identifikon dhe diskuton personazhet që kanë kuptim për të. • Ndërton struktura gjithnjë e më komplekse dhe i zgjeron ato, p.sh., përdor bllaqe më të vogla për të ndërtuar kulla më të larta, rreshton materiale dhe shton përbërës të tjerë për të krijuar një "rrugë" që të çon deri te kulla e ndërtuar. • Përdor lojëra imagjinare për të përballuar frikën, p.sh., vendos përbindëshin brenda një kutie. • Luan duke u maskuar dhe fton kujdestarin/edukatorin të luajnë së bashku.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni mbështetje dhe instrumente që fëmija mund t'i përdorë gjatë muzikës dhe lëvizjes. • Angazhohuni në biseda rreth asaj që fëmija po krijon gjatë veprimtarive të artit. • Ekspozoni çdo vepër arti të fëmijës në një vend ku ai mund ta shoë atë dhe ta tregojë atë • Promovoni përvojat e lojërave si brenda, ashtu dhe jashtë mjedisit të çerdes. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekspozoni fëmijën në muzikë dhe valle nga kultura dhe prejardhje të ndryshme. • Siguroni mundësi për lojëra të pretenduara, në të cilat fëmija mund të vishet si personazhe të ndryshme, p.sh., një mjek, zjarrfikës ose princeshë • Nxitni shprehjen krijuese të fëmijës duke lavdëruar e motivuar përpjekjet e tij . • Merrni pjesë në lojën e fëmijës; vishuni, shtiruni dhe luani me fëmijën.

Nënfusha: Logjika dhe arsyetimi

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësi për të përdorur njohuritë, përvojat e mëparshme, provën dhe gabimin për të kuptuar se si ndikon në botën e tyre

GJATË KËSAJ PERIUDHE	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të ndërtojnë vetëdijen dhe të përdorin veprime të thjeshta për të ndikuar tek objektet dhe njerëzit në mjedisin e tyre.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët kombinonë veprime specifike për të pasur një efekt të njerëzit dhe objektet duke bashkëvepruar me ta në mënyra të ndryshme për të zbuluar se çfarë do të ndodhë.</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor komunikim verbal dhe joverbal për të gjeneruar përgjigje nga kujdestari/edukatori, p.sh., guet, shtrihet, qesh... • Përsërit veprime të ngjashme mbi objekte të ndryshme, p.sh., tund një lodër pellushi në të njëjtën mënyrë si një raketake për të dëgjuar zhurmën e saj. • Kërkon dhe gjen një objekt që ka rënë. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor objektet sipas qëllimit që kanë, p.sh., pretendon të pijë qumësht nga një biberon lodër. • Përiqet në mënyra të ndryshme për të lëvizur një objekt, për të parë se çfarë ndodh, p.sh., rrokullis topin butësisht në fillim dhe pastaj më fort për të parë se sa shpejt dhe sa larg do të shkojë. • Përdor veprime të ndryshme për një rezultat të synuar, p.sh., ndërton kulla me blloqe dhe pastaj i rrezon me dorën e tij, përsërit veprimtarinë dhe përdor një lodër tjetër për të bërë që kulla të bierë. • limiton gjuhën e trupit të të rriturve dhe veprimet e thjeshta, p.sh., vendos duart në bel ose pretendon të fshijë tryezën.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Merrni pjesë në bashkëveprimet shoqërore që fëmija nis vetë. • Siguroni lodra interesante që mund të manipulohen lehtë, p.sh., të shtypen, të lëshojnë tinguj, të bëjnë zhurmë ... • Luani lojëra të dyfishta me fëmijën, duke ndërruar rolet p.sh., "Të gjeta!" 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lejoni fëmijën të eksplorojë një larmi lodrash. • Tregojini fëmijës për lojë: "Shiko sa shumë e ke rrokullisur topin!" • Lëri liri fëmijës të provojë gjëra të reja duke i dhënë edhe pak mbështetje. • Demonstroni dhe shpjegoni marrëdhëniet midis objekteve dhe / ose njerëzve.

STANDARDI: Fëmijët shfaqin aftësi për të përdorur njohuritë, përvojat e mëparshme, provën dhe gabimin për të kuptuar se si ndikon në botën e tyre



<p>16 muaj deri në 24 muaj: Fëmijët kuptojnë se si veprime të qëllimshme dhe të zgjedhura mund të ndikojnë në objekte dhe njerëz të ndryshëm. Fëmijët gjithashtu fillojnë të lidhin objekte dhe ide duke u bazuar në përsëritjen dhe përvojën.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përsërit veprime pa pushim për të shkaktuar efektin e dëshiruar, p.sh., zbraz një kovë dhe rimbush atë me objekte të ndryshme. • Fillon të parashikojë pasojat e veprimeve të thjeshta dhe të njohura për të, p.sh., e di se lëvizja e çelësit të dritës bën që të ndizet ose fiket drita e makinës lodër. • Kupton funksionimin e objekteve, p.sh., shtupa përdoret për të pastruar dyshemenë. • Fillon të kuptojë sjellje të caktuara që kanë të bëjnë me kontekste të caktuara, p.sh., sillet ndryshe në çerdhe sesa në shtëpi.
<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët arrijnë të kenë një kuptim më të madh rreth shkakut të diçkaje dhe mund të parashikojnë dhe zgjedhin veprime specifike për të arritur një rezultat të dëshiruar. Ata gjithashtu fillojnë të zbatojnë përvojat dhe njohuritë e kaluara për të formuar ide.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njeh veprimet dhe objektet dhe mund të përgjithësojnë kuptimin, p.sh., sheh dikë që hap një çadër dhe mund t'i atribuojë faktin se po bie shi. • Bën një parashikim të asaj që do të ndodhë më pas në një sekuençë të ngjarjeve. • Zbaton përvojat e kaluara në situata të reja. • Shpreh shkakun dhe pasojën e situata të caktuara, p.sh., "Unë rashë dhe u lëndova".
<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni histori dhe biseda të përditshme për t'i kërkuar fëmijës të parashikojë se çfarë mund të ndodhë më pas. • Përdorni përvojat e kaluara të fëmijës për të kapërcyer përvojat e reja, p.sh., përdorni shkurtesa në trotuar për të shkruar në vend të ngjyrave dhe letrës. • Diskutoni dhe përjetoni shkakun dhe pasojën në ndërvëprimet e përditshme, p.sh., shtoni ngjyrë ushqimore në gotatën e ujit dhe i tregoni fëmijës se çfarë ndodh. 	<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurojini fëmijës përvoja që demonstrojnë shkak dhe pasojë, p.sh., objekte që prodhojnë tinguj pas kryerjes së një veprimi specifik. • Tregoni dhe shpjegoni përse duhen objektet dhe për çfarë përdoren gjatë ndërvëprimeve të përditshme. • Renditni bashkëveprimet e përditshme, p.sh., "Së pari do ta mbushim gotatën me ujë, pastaj do të vendosim lodra brenda saj".

Shkaku i referohet marrëdhënies midis arsyes pse ndodh dhe pasojës. Fëmijët kuptojnë se veprimet dhe fjalët specifike prekin objektet dhe njerëzit në mjedisin e tyre në mënyra të parashikueshme.

Nënfusha: Sasia dhe numrat

STANDARDI: Fëmijët shfaqin vetëdije për sasinë, numërimin dhe kompetencat numerike

GJATË KËSAJ PERIUDHE	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët zhvillojnë të kuptuarit e koncepteve të sasisë dhe numrit, ndërsa ata eksplorojnë dhe bashkëbejnë me objektet dhe njerëzit në mjedisin e tyre të përditshëm.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të identifikojnë se ka sasi të ndryshme të objekteve dhe njerëzve. Ata mund të përpiqen të përputhin në sasi numrat përmes përdorimit të fjalëve, simboleve dhe gjeesteve.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor tingujt dhe gjuhën e trupit për të sinjalizuar për më shumë, p.sh., fillon të qajë kur mbaron një shishe qumështi dhe është akoma i uritur. • Eksploron objektet një nga një, p.sh., e fut në gojë një lodër dhe e hedh për të kapur një tjetër, ose hedh lodra në një enë. • Shpreh më shumë dëshira përmes shenjave të fytyrës, tingujve, gjeesteve, dhe veprimeve, p.sh., zhurmës, hapjes së gojës, lëvizjeve... • Mban më shumë se një objekt në të njëjtën kohë, p.sh., kap një zile lodër në një dorë dhe përpiqet me tjetrën të kapë një bllok. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Arrin të kuptojë konceptin "më shumë" në lidhje me ushqimin dhe lojën; Tregon me gjeeste ose thotë, "më shumë". • Imiton numërimin, p.sh., ngjit shkallët dhe imiton "një, dy". • Përdor komunikim verbal dhe joverbal për të shprehur më shumë koncepte komplekse, p.sh., "disa", "përsëri", "të gjitha" • Fillon të kuptojë fjalët përshkruese dhe të zbatojë atributet e njerëzve, p.sh., tregon veten kur pyetet: "Kush është djali i madh?" • Fillon të përdorë fjalët për numrat për të emërtuar sasinë, edhe pse mund të gabojë. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Arrin të kuptojë konceptin "më shumë" në lidhje me ushqimin dhe lojën; Tregon me gjeeste ose thotë, "më shumë". • Imiton numërimin, p.sh., ngjit shkallët dhe imiton "një, dy". • Përdor komunikim verbal dhe joverbal për të shprehur më shumë koncepte komplekse, p.sh., "disa", "përsëri", "të gjitha" • Fillon të kuptojë fjalët përshkruese dhe të zbatojë atributet e njerëzve, p.sh., tregon veten kur pyetet: "Kush është djali i madh?" • Fillon të përdorë fjalët për numrat për të emërtuar sasinë, edhe pse mund të gabojë.
<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjuni menjëherë fëmijës por jo pa u menduar, kur ai sinjalizon për nevojat e tij. • Siguroni objekte të shumta dhe / ose materiale që fëmija të mund të eksplorojë. • Nxitni fëmijën të shqyrtojë objektet një nga një, p.sh., merrni në dorë një bllok dhe thoni "një". • Luani me fëmijën; llogaritni me zë të lartë në kohën që i jepni objekte të ndryshme. • Angazhohuni në lojëra të thjeshta me gjishta me fëmijën. 	<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Modeloni numërimin dhe renditjen për fëmijën çdo ditë përmes ndërvëprimeve, p.sh., "Së pari, ne do të ulemi në karrige, pastaj do të vendosim përparësen" • Tregojini me gjeeste fëmijës, koncepte p.sh., "aq i madh", duke ngritur krahët në ajër. • Këndoni këngë që përmbajnë numra. 	<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Modeloni numërimin dhe renditjen për fëmijën çdo ditë përmes ndërvëprimeve, p.sh., "Së pari, ne do të ulemi në karrige, pastaj do të vendosim përparësen" • Tregojini me gjeeste fëmijës, koncepte p.sh., "aq i madh", duke ngritur krahët në ajër. • Këndoni këngë që përmbajnë numra.

Atributet janë karakteristikat ose vetitë e objekteve, të tilla si forma, ngjyra ose madhësia

STANDARDI: Fëmijët shfaqin vetëdije për sasinë, numërimin dhe kompetencat numerike

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët njohin sasi të ndryshme të objekteve dhe njerëzve dhe flillojnë të përputhin me saktësi fjalët e numrave me sasinë e saktë.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Komunikon sasi të sendeve të njohura, p.sh., shesh dy mollë dhe thotë, "dy"
- Përdor gjeste joverbale për të demonstruar të kuptuarit e sasive, p.sh., mban dy gishta për të shprehur dy për diçka.
- Fillon të përdorë "një", "dy" dhe "tre" për të identifikuar sasi shumë të vogla pa i llogaritur ato.
- Fillon të përdorë fjalë përshkruese për njerëzit në një mënyrë më të ndërlikuar, p.sh., "ai i madh", "ajo fëmijë".

Strategjitë për ndërveprim:

- Përdorni koncepte numerike në veprimtarinë e përditshme, p.sh., "Dëshiron një biskotë apo dy?"
- Përdorni momente që fëmija mund të mësojë, p.sh., kërkoni që fëmija t'ju japë një lapustil nga grumbulli që ka gjatë punës së artit që po bën"
- Njihni përpjekjet e fëmijës për të përdorur koncepte numerike në ndërveprimet e përditshme, p.sh., "Po, ke të drejtë, ti je dy vjeç!

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët përdorin gjuhën për të demonstruar kuptimin themelor të përfaqësimit të numrit dhe identifikimit të sasisë.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Kupton renditjen progresive të numrave, p.sh., thotë numrat në seri deri në dhjetë.
- Fillon të numërojë objektet; mund të numërojë dy herë objektet dhe / ose të kalojë numrat.
- Fillon të identifikojë krahasimin e sasisë, p.sh., "Unë kam më shumë blloqe".
- U jep kuptim numrave; kupton konceptin e një numri të vogël ose një numri të madh.
- Përdor fjalë përshkruese kur komunikon për të tjerët, p.sh., "Ajo vrapoi shpejt", "Ai është i vogël", "Shiko sa lart jam" ...

Strategjitë për ndërveprim:

- Pranoni që përvoja dhe ekspozimi janë faktorë që ndikojnë nëse fëmija është i njohur me numrat ose jo.
- Angazhoni fëmijën të marrë pjesë në fjalë-vjersha që përmbajnë numra dhe matematikë.
- Përdorni fjalë përshkruese kur bashkëveproni me fëmijën, p.sh., "T je kaq i gjatë!"

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nënfusha: Konceptet shkencore dhe eksplorimi

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë njohuritë themelore dhe përdorin koncepte shkencore

<p>GCATË KËSAJ PERIUDHË</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët përdorin ndërveprime sociale së bashku me të gjitha shqisat e tyre për të zbuluar dhe eksploruar botën përreth tyre.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët përdorin të gjitha shqisat e tyre për të mbledhur me qëllim dhe për të vepruar; në informacionin e marrirë përmes bashkëveprimeve me mjedisin e tyre</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon njerëzit dhe objektet në mjedisin e tij. • Angazhohet në bashkëveprime shoqërore me të rritur të njohur. • Kërkon në mënyrë aktive objekte të reja që gjenden në mjedis, p.sh., me gojë, me shkopinj, me kapëse... • Përdor të gjitha shqisat e tij për të eksploruar dhe zbuluar gjëra të reja, p.sh., arrin të prekë shiun ose borën. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkon në mënyrë aktive objektet dhe përjeton përbërjen e tyre përmes shqisave të ndryshme, p.sh., ngjyra, cilësia, pesha, shija. • Përsërit veprime që tërheqin vëmendjen e tij ose të saj, p.sh., rrëzon objekte përtokë për të dëgjuar tingullin që bën. • Eksperimenton me materiale të ndryshme që gjenden në mjedisin e jashtëm, p.sh., prek me gishta në tokë, thërmon gjethë të thata ...
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijoni një mjedis stimules që fëmija të eksplorojë; ndryshoni rregullisht materialet dhe lodrat në mjedisin e fëmijës. • Ndiqni shembullin e fëmijës gjatë lojës. • Siguroni lodra dhe përvoja që kanë një larmi ngjyrash, materialesh, tingujsh dhe aromash. • Lejoni që fëmija të eksplorojë mjedisin e jashtëm, p.sh., të shkojë në shëtitje me karrocë, ta lëmë fëmijën të zvarritet në bar, të prekë baltë, gjethë... 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni mundësi që fëmija të hulumtojë dhe luajë jashtë. • Angazhohuni në biseda me fëmijën për natyrën, kafshët, dhe gjallesat e tjera; prezantoni libra që përfshijnë këto tema. • Sigurojini fëmijës shumë mundësi për lojë ndijore, p.sh. puding, brumë, ujë, rërë, baltë etj.


STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë njohuritë themelore dhe përdorin koncepte shkencore

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët fillojnë të përdorin eksperimente për të bashkëvepruar dhe për t'u përfshirë me mjedisin e tyre në mënyra të ndryshme. Për më tepër, shfaqet një interes i ri, i veçantë për gjallesat

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët përdorin aftësitë e tyre të komunikimit për të treguar interesat në vëzhgime, përvoja dhe angazhime me botën përreth tyre. Fëmijët në mënyrë aktive eksperimentojnë me mjedisin e tyre për të bërë zbulime të reja.



<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon interes për trupin e vet; mund të njohë emërtime për pjesë të caktuara të trupit. • Fillon kategorizimin e thjeshtë, p.sh., macet dhe qentë janë kafshë. • Bën pyetje të thjeshta për natyrën. • Përpiqet për detyra të reja gjatë veprimtarive të njohura, p.sh., luan në govatën e ujit dhe në vend që të përdorë duart, përpiqet të përdorë frumën për të bërë ujë të lëvizë. • Përdor lëvizjet dhe tingujt për të përfaqësuar një vëzhgim, p.sh., "gjarpri, ssssss!" ... 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fillon të identifikojë karakteristikat e kafshëve, p.sh., "Qeni leh". • Identifikon tipare të ndryshme të objekteve, ushqimeve dhe materialeve, p.sh., ngjyra, format, madhësia. • Nxjerr përvojën e kaluar për të përshkruar dhe komunikuar rreth vëzhgimeve dhe përvojave, p.sh., e di se çfarë ndodh kur dikush fryn një qiri, diskuton se çfarë ndodh me borën kur temperatura është më e ngrohtë. • Angazhohet në procese për të arritur një rezultat, p.sh., përzien tre ngjyra të ndryshme të bojës për të parë se çfarë ngjyre shfaqet.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni mundësi që fëmija të angazhohet në lojëra ndijore. • Bisedoni me fëmijët për kafshë të ndryshme, përmasat e tyre, ku jetojnë dhe çfarë tingujsh bëjnë ata. • Lejoni fëmijën të eksplorojë lule, insekte dhe gjallesa të tjera kur është jashtë. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Filloni t'i bëni fëmijës pyetje: çfarë, ku, kur dhe pse? • Përfshini pyetje "shkencore" dhe "kërkimore" në rutinën e përditshme të fëmijës. • Siguroni veprimtari dhe përvoja që i lejojnë fëmijës të zgjidhë probleme dhe të arrijë në përfundime, p.sh. ndërtoni, duke eksperimentuar me ndryshimet nga lëndët e ngurta në lëngjet. • Krijoni tema dhe veprimtari që përqendrohen te natyra, p.sh., ndani me fëmijën ciklin e jetës së një fluturë përmes librave dhe përvojave të jetës reale.

Edukim në natyrë

Fëmijët mësojnë me të gjitha shqisat e tyre, cili është vendi më i mirë për të përfshirë të gjitha shqisat. Ka shumë mundësi që fëmijët të shohin kafshë, ngjyra dhe njerëz të ndryshëm. Fëmijët mund të provojnë materiale të ndryshme ndërsa ata eksplorojnë pellgje, gjethe të thata dhe lule. Ata mund të ndiejnë shiun dhe erën, të dëgjojnë makina dhe kamionë. Këto përvoja të hershme u ofrojnë fëmijëve mënyra interesante dhe kuptimplote për të mësuar rreth natyrës, shkencës dhe mjedisit ku ata jetojnë. Mjedi i jashtëm është gjithashtu vendi ku fëmijët janë në gjendje të praktikojnë dhe zotërojnë aftësi fizike të tilla si ecja, vrapimi, kërcimi dhe ngjitja. Përvojat në mjedisin e jashtëm u ofrojnë fëmijëve përvoja pozitive për të shpenzuar energji, për t'u bërë pis dhe për të mësuar rreth botës përreth tyre.

Nënfusha: Siguria dhe mirëqenia

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi për të njohur situata të rrezikshme dhe përgjigjen në përputhje me rrethanat

<p>Referenca sociale është termi i përdorur për të përshkruar mënyrën se si fëmijët e vegjël marrin sugjerimet e tyre nga persona të tjerë të njohur për të vendosur se cilat emocione dhe veprime janë të përshtatshme.</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët së pari mbështeten në refleksat e tyre natyrore për të sinjalizuar nevojat themelore të mbijetesës te kujdestari/edukatori i tyre. Në fund të kësaj periudhe moshe, shfaqet vetëdije për trupin e tyre dhe besimin te kujdestari/edukatori, të cilët përkrahin fëmijët në plotësimin e nevojave dhe mbrojtjen e tyre në situata të pasigurta</p>	<p>7 deri 18 muaj: Aftësitë fizike në rritje të fëmijëve i lejojnë ata të eksplorojnë mënyra të reja të bashkëveprimit me mjedisin përreth tyre. Të motivuar nga këto aftësi të reja, fëmijët marrin rreziqe për të eksploruar dhe mësuar dhe demonstrojnë, përmes komunikimit verbal dhe joverbal, besim te kujdestari/edukatori i tyre për t'i mbajtur ata të sigurt.</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sinjalizon përmes refleksive dhe tingujve se ka nevoja, p.sh., demonstrojnë refleksë këmbënguljeje kur janë të uritur, qajnë kur nuk ndihen rehat... • Vëzhgon dhe hulumton në mënyrë aktive mjedisin. • Tregon interes për trupin e vet, p.sh. shikon ngultas duart, fut këmbët në gojë, godet barkun. • Përdor lëvizjet fizike për të eksploruar mjedisin, p.sh., përpiqet të arrijë diçka, ulet, rrokulliset, zvarritet. • Tregon besim te kujdestari/edukatori, p.sh., shtrin krahët për ta marrë, rehatohet kur e qetësojnë, kur zbutet, kërkon kujdestarin/edukatorin në situata të reja... 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor referencën sociale për të vlerësuar situata të pasigurta, p.sh., shikon drejt kujdestarit /edukatorit për sugjerime nëse duhet të vazhdojë diçka apo jo. • Ngjitet në mënyrë aktive për të arritur objektet e kërkuara gjatë lojës. • Përgjigjet ndaj sugjerimeve të kujdestarit/edukatorit në situata të pasigurta. • Heziton dhe demonstroi kujdes në situata të reja dhe / ose të ndryshme, p.sh., ndalon zvarritjen kur arrin në skajin e një sipërfaqeje të pabarabartë • U përgjigjet paralajmërimeve dhe ndryshimeve në tonin e zërit; ka nevojë për ndihmë dhe ridrejtim për të ndaluar sjelljen e pasigurt, p.sh., shikon pasi dëgjon një "jo" të rreptë por nuk ndalon domosdoshmërisht sjelljen ose veprimin.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plotësoni nevojat e fëmijës në mënyrë të shpejtë dhe të ndjeshme • Përgjigjuni duke u menduar paraprakisht kur bashkëveproni me fëmijën. • Siguroni një mjedis të sigurt, për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar një mbikëqyrje të vazhdueshme. • Qetësoni dhe ngushëltoni fëmijën sipas nevojës, p.sh., ta mbani, ta përkëdhelni, lëkundni. • Ndërveproni me fëmijën; uluni në dysheme dhe angazhohuni në eksplorim dhe lojëra. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni shprehje dhe gjeeste të futyrës për të komunikuar me fëmijën në situata të pasigurta, p.sh., tundje koke, buzëqeshje për të nxitur fëmijën të zvarritet drejt lodrës së re ... • Vendosni kufij; qëndroni të vendosur. • Siguroni një mjedis të sigurt, për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar mbikëqyrje të vazhdueshme. • Shpjegojuni fëmijëve pse ekzistojnë rregulla të caktuara

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi për të njohur situata të rrezikshme dhe përgjigjen në përputhje me rrethanat**16 muaj deri në 24 muaj:**

Fëmijët fillojnë të ndërtojnë kuptimin themelor të kufijve të tyre fizikë dhe situatave të pasigurta. Fëmijët janë ende të motivuar për të bashkëpunuar dhe eksploruar mjedisin pa marrë parasysh rreziqet dhe vazhdojnë të mbështeten te kujdestari/ edukatori për të ndihmuar në menaxhimin e impulseve të tyre

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Kupton "jo" dhe "ndal" kur komunikohet përmes fjalëve ose gjesteve.
- U përgjigjet paralajmërimeve dhe fillon të ndryshojë sjelljen në përputhje me rrethanat, p.sh., largohet nga priza pasi kujdestari/ edukatori thotë "jo"
- Kërkon rehati kur ka frikë.
- Imiton veprimet e të rriturve gjatë lojës, p.sh., i thotë kukullës : "mos e prek se digjesh (xhiç)" kur ecën pranë sobës së pretenduar.

Strategjitë për ndërveprim:

- Siguroni një mjedis të sigurt, për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar mbikëqyrje të vazhdueshme.
- Modeloni praktika dhe sjellje të sigurta për fëmijën, p.sh., mos hipni në karrige kur përpiqeni të arrini objekte.
- Mbështeteni fëmijën në situata të reja; lëri kohë të miqësoshet me njerëzit, objektet dhe veprimtaritë e reja.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët fillojnë të demonstrojnë aftësi të kufizuara për të brendësuar atë që kujdestari/edukatori komunikon në lidhje me sigurinë, rregullat dhe mirëqenien. Fëmijët vazhdojnë të veprojnë sipas impulseve, por fillojnë të zhvillojnë strategji për të mbrojtur veten në situata potencialisht të pasigurta

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- I kushton vëmendje rregullave të sigurisë, por ka ende nevojë për mbikëqyrje për të mbajtur veten të sigurt.
- Komunikon me një të rritur nëse diçka nuk është në rregull, p.sh., kur një bashkëmohatar lëndohet ose mungon.
- Kujton dhe fillon të zbatojë përvojat e kaluara në situatat e ardhshme, p.sh., ecën me kujdes dhe ngadale kur ka borë në tokë.
- I kujton rregullat një bashkëmohatar të ri, p.sh., e mban për dore kur ecin të dy jashtë.

Strategjitë për ndërveprim:

- Siguroni mbikëqyrje dhe udhëzime të vazhdueshme.
- Bisedoni me fëmijën për situata të pasigurta dhe ato që ai duhet të bëjë për të marrë ndihmë.
- Respektoni frikën e shprehur të fëmijës.
- Vendosni kufij; qëndroni të vendosur.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

FUSHA: QASJET NDAJ TË NXËNIT

Periodha e fëmijërisë së hershme është koha kur të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, përkatësie, kulture, race, mësojnë se si të nxënë. Qasja ndaj të nxënit është një fushë e veçantë e zhvillimit të fëmijës, sepse përfshin në vetvete aftësitë specifike që tashmë janë mësuar në fushat e tjera të zhvillimit. Secila fushë e zhvillimit reflekton përmbajtjen e njohurive apo aftësive specifike dhe ka të bëjë me mënyrën se si këto njohuri apo aftësi janë fituar në këto fusha.

Fëmijët kanë lindur të gatshëm për të mësuar dhe tre vitet e para janë koha kur fëmijët zhvillojnë zakonet në mënyrën se si ata afrohen dhe eksplorojnë botën e tyre. Në varësi të cilësisë së përvojave të tyre të hershme, fëmijët ose formojnë qëndrime të shëndetshme ose jo ndaj të nxënit (Gebhard, 2009).

Kurioziteti dhe interesi për mjedisin që i rrethon dhe për çdo gjë të re që ndodh në të, janë përbërësit e parë të qasjes ndaj të mësuarit. Marrja e nismës nga fëmijët dhe stimulimi nga të rriturit për ta zhvilluar atë, përbëjnë përbërësin tjetër të qasjes ndaj të nxënit në të cilën fëmijët zhvillojnë gatishmërinë e tyre për të mësuar, por edhe mënyrën se si ata e drejtojnë veten në këtë të mësuar. Këmbëngulja, një tjetër përbërës, tregon se si fëmijët në vazhdimësi merren me të njëjtën veprimtari, madje edhe pas përballjes me pengesa apo vështirësi të ndryshme. Krijueshmëria dhe imagjinata, si përbërës për të përshtatur materiale, veprimtari në situata të reja apo me qëllime të tjera, shihet si përbërësi i fundit i qasjes ndaj të nxënit.

Gjatë viteve të para të jetës, këto aftësi të fëmijëve janë kryesisht të ndërlidhura me kohën e kaluar me fëmijët dhe me cilësinë e bashkëveprimit të prindërve, kujdestarëve, edukatorëve, rrethit të tyre dhe moshatarëve.

NËNFUSHAT

❖ *Kurioziteti & Nisma*

Fëmijët lindin me një interes natyror për njerëzit dhe objektet që gjenden në mjedisin e tyre. Në fund të fundit, ata po shohin gjëra për herë të parë! Fëmijët përdorin të gjitha shqisat e tyre për të marrë gjithë këtë informacion të ri dhe përdorin aftësitë e tyre që vijjnë duke u zhvilluar për të kuptuar ato që shohin, dëgjojnë, shijojnë, nuhasin dhe prekin. Marrëdhëniet e sigurta ndërtojnë besimin që fëmijët kanë nevojë për të ushtruar kureshtjen e tyre. Fëmijët i përdorin këto modele të hershme për të ndërtuar vetëbesimin që u duhen për të filluar eksplorimin, për të provuar përvoja të reja dhe për t'u angazhuar me objekte dhe njerëz.

❖ *Zgjidhja e Problemeve*

Fëmijët ndërtojnë bazat e aftësive për zgjidhjen e problemeve përmes edukimit të marrëdhënieve, eksplorimit aktiv dhe bashkëveprimeve shoqërore.

Në foshnjëri, fëmijët mësojnë se veprimet e tyre dhe sjelljet kanë një efekt tek të tjerët.

Fëmijët mësojnë se ata kanë aftësinë për të zgjidhur një problem duke kryer veprime të caktuara. Fëmijët i ndërtojnë këto njohuri dhe i përkthejnë në mënyrën se si bashkëveprojnë dhe zgjidhin problemet në situatat e ardhshme. Ata zbulojnë se veprimet dhe sjelljet e tyre gjithashtu kanë një ndikim në objekte. Gjithashtu ata mësojnë se veprime të caktuara prodhojnë rezultate të caktuara

❖ **Besimi & Marrja e rrezikut**

Fëmijët e ndërtojnë besimin e tyre përmes marrëdhënieve të tyre me kujdestarët/edukatorët. Kujdestarët/edukatorët që plotësojnë nevojat e fëmijëve dhe përgjigjen në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpejtë, ushqejnë ndjenjat e vlerës së vetvetes te fëmijët. Fëmijët mësojnë të ndiejnë se janë të rëndësishëm dhe ata mësojnë të besojnë. Kjo ndërton vetëbesimin që u nevojitet atyre që të ndërmarrin rreziqe të përshtatshme zhvillimore.

Këto rreziqe përfshijnë detyra zhvillimore siç janë zvarritja, ecja, loja, provimi i përvojave të reja dhe ndërtimi i marrëdhënieve me moshatarët.

❖ **Këmbëngulja, Përpjekja dhe Vëmendja**

Fëmijët përdorin eksplorimin shqisor dhe ndërveprimin shoqëror për të mësuar rreth botës së tyre. Fëmijët e vegjël nuk kanë aftësi për të merren me objekte ose njerëz për periudha shumë të gjata kohore, ata ndërtojnë këtë aftësi me përvojat e hershme. Fëmijët tregojnë interes fillestar për botën e tyre duke vëzhguar thjesht.

Ata përqendrohen në fytyrat, modelet me kontrast të lartë, tinguj dhe përfundimisht, objekte specifike. Ndërsa rriten, fëmijët fillojnë të eksplorojnë fizikisht mjedisin e tyre. Ata përdorin duart për të prekur, tundur dhe lëvizur objekte. Ata gjejnë kënaqësi të përsërisin veprimet që u pëlqejnë. Angazhimi në këto përvoja promovon zhvillimin e këmbënguljes, përpjekjes dhe vëmendjes.

❖ **Krijueshmëria dhe Imagjinata**

Fëmijët janë nxënës aktivë kur hulumtojnë mjedisin e tyre. Ata së pari vëzhgojnë botën përreth tyre. I kushtojnë vëmendje tingujve, ngjyrave, lëvizjeve dhe përfshihen në bashkëveprime me kujdestarët e tyre. Ndërsa rriten, fëmijët bëhen më të qëllimshëm kur merren me mjedisin e tyre. Ata fillojnë të eksperimentojnë me mënyra të reja për të bërë gjëra të reja dhe zgjerojnë mënyrën se si bashkëveprojnë me objektet dhe njerëzit. Ndërsa këto njohuri nuk përkthehen në veprime novatore, ato krijojnë fazën e zhvillimit të krijimtarisë në të ardhmen.

Fëmijët përdorin objekte në mënyra të reja dhe të papritura. Ata fillojnë të imitojnë veprimet e të rriturve dhe të përdorin objekte për të përfaqësuar gjërat me të cilat janë njohur. Fëmijët përdorin gjuhën për të pretenduar se luajnë, përfshijnë të tjerët në ndërveprim lojrash dhe shprehin ndjenja dhe ide shpikëse.

Nënfusha: Kurioziteti & Nisma

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë interes dhe padurim për të mësuar rreth botës së tyre.

GJATË KËSAJ PERIUDHE	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët zbulojnë botën përmes eksplorimit dhe ndërveprimit shoqëror. Fëmijët reagojnë interes të veçantë për objektet, njerëzit dhe përvojat e reja.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Kontrolli fizik i trupit, fituar tashmë në këtë stad, u lejon atyre të hulumtojnë dhe ndërveprojnë në një mënyrë më të qëllimshme dhe më kuptimplote.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon mjedisin dhe njerëzit; gjurmon një lodër ndërsa lëviz nga një pikë në tjetrën • Tregon interes për veten e tij, p.sh., këqyr duart e tij, fut këmbët në gojë... • Kërkon në mënyrë aktive objekte të reja që gjenden në mjedis, p.sh. me prekje, duke i goditur lehtë, duke i futur në gojë. • Përpiqet për të filluar bashkëveprimin me të tjerët, p.sh., buzëqesh, shtrin krahët drejt kujdestarit/edukatorit. • Bëhet pjesë e vëmendjes së përbashkët bashkë me kujdestarin/edukatorin, p.sh., përqëndrohet tek i njëjti objekt. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon interes për objektet e reja duke manipuluar dhe kthyer objektin e ri. • Përdor objekte të njohura në mënyra të reja, p.sh., vendos një shportë lodrash në kokë. • Vepron drejt një veprimtarie të re duke u zvarritur ose duke ecur. • Fillon të demonstrojë preferencat për objektet dhe / ose materialet, p.sh., zgjedh një libër për të lexuar kur i jepen disa mundësi. • Angazhon të rriturit e njohur në ndërveprime domethënëse, p.sh., i tregon lodrën e preferuar, i sjell një libër për t'ia lexuar... 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon interes për objektet e reja duke manipuluar dhe kthyer objektin e ri. • Përdor objekte të njohura në mënyra të reja, p.sh., vendos një shportë lodrash në kokë. • Vepron drejt një veprimtarie të re duke u zvarritur ose duke ecur. • Fillon të demonstrojë preferencat për objektet dhe / ose materialet, p.sh., zgjedh një libër për të lexuar kur i jepen disa mundësi. • Angazhon të rriturit e njohur në ndërveprime domethënëse, p.sh., i tregon lodrën e preferuar, i sjell një libër për t'ia lexuar...
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijoni një mjedis pritës të tillë që fëmija të eksplorojë; ndryshoni rregullisht materialet dhe lodrat në mjedisin ku rri fëmija. • Krijoni mundësi në të cilat fëmija mund të eksplorojë mjedisin e tij edhe jashtë çerdhes; bisedoni me fëmijën për atë që po ndodh. • Siguroni shumëllojshmëri të materialeve ndijore, p.sh., libra që përfshijnë cilësi letre të ndryshme, lodra që dridhen ose që bëjnë zhurmë. • Përgjiguni shpejt në orvatjet e fëmijës për bashkëveprim, por jo pa u menduar. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni një mjedis që i lejon fëmijës të zgjedhë veprimtarinë ose lodrat që do të dëshironte të luante. • Siguroni materiale dhe objekte që mund të përdoren në më shumë sesa një mënyrë • Nxitni veprimtari që kanë kuptim për fëmijën, p.sh., një libër i preferuar ose një këngë e preferuar. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni një mjedis që i lejon fëmijës të zgjedhë veprimtarinë ose lodrat që do të dëshironte të luante. • Siguroni materiale dhe objekte që mund të përdoren në më shumë sesa një mënyrë • Nxitni veprimtari që kanë kuptim për fëmijën, p.sh., një libër i preferuar ose një këngë e preferuar.

Kurioziteti është një nxitje instiktive për të mësuar rreth botës. Fëmijët janë natyrisht kureshtarë dhe përdorin eksplorimet për të mësuar

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë interes dhe padurim për të mësuar rreth botës së tyre.



<p>16 muaj deri në 24 muaj: Fëmijët bëhen gjithnjë e më shumë kureshtarë për përvojat dhe veprimtaritë e reja që përfshijnë moshatarët dhe të rriturit; ata fillojnë të bashkëveprojnë dhe të kërkojnë përfshirje me të tjerët.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon interes për veprimtari të reja dhe gatishmëri për të provuar përvojat e reja. • Angazhohet në eksplorim aktiv në mjedis të reja, p.sh., kontrollon mbi një raft lodrash në një mjedis të panjohur më parë. • Fillon të luajnë me të tjerët . • Eksperimenton në mënyra të ndryshme për të përdorur materiale dhe objekte.
<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët demonstrojnë nishta duke marrë pjesë dhe duke u angazhuar në përvojat e reja. Fëmijët përdorin vëzhgimin, komunikimin dhe hetimin për t'i kuptuar këto përvoja.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon fëmijët e tjerë në lojë. • Kënaqet në arritjen e qëllimeve të thjeshta, p.sh., kur përfundon një pazëll, kur fryn një fluskë... • Bën pyetje ndërsa bashkëvepron me të tjerët, p.sh., "pse", "çfarë", "si". • Merr pjesë në një grup më të gjerë përvojash, p.sh., në natyrë, palestër, projekte arti... etj.
<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxitni fëmijën kur ai po provon diçka të re, ose kur po merr rreziqe të arsyeshme; tregoni ndjeshmëri ndaj temperamentit të fëmijës dhe sigurojini mbështetje sipas nevojës. • Angazhohuni në biseda me fëmijën dhe përgjigjuni pyetjeve të tyre në mënyrë të qartë dhe të sinqertë. • Referojuni interesit të fëmijës duke prezantuar libra dhe veprimtari të tjera. • Përforconi ndërvëprimet duke prezantuar mënyra të reja ose alternative për të përdorur materiale, objekte ose lodra. 	<p>Strategjitë për ndërvëprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurojini fëmijës zgjedhje të ndryshme për lojëra dhe veprimtari gjatë gjithë ditës. • Nxitni fëmijën të marrë pjesë në një veprimtari të re, por jo me forcë. • Modeloni ndërvëprime pozitive me fëmijën gjatë gjithë ditës. • Nxitni fëmijën të vërejë se çfarë bëjnë fëmijët e tjerë, p.sh. "Mira dhe Beni po bëjnë një picë me brumin e tyre të lojës".

Nënfisha: Zgjidhja e problemeve

STANDARDI: Fëmijët përpiqen me një sërë strategjish për të realizuar detyra, për të kapërcyer pengesa dhe për të gjetur zgjidhje për detyrat, pyetjet dhe sfidat

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët ndërtojnë bazat për zgjidhjen e problemeve përmes eksplorimit aktiv dhe ndërveprimit shoqëror.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të zbulojnë se veprime dhe sjellje të caktuara mund të jenë zgjidhje për sfidat dhe pengesat me të cilat hasen. Fëmijët gjithashtu mësojnë se si angazhohet kujdestari/edukatori i tyre për të ndihmuar në menaxhimin e këtyre sfidave.</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqendrohet në marrjen e vëmendjes së kujdestarit/edukatorit përmes përdorimit të tingujve, gjeesteve, shprehjeve të futyrës dhe të qarit. • Pëlqen veprimet e përsëritura. • Komunikon nevojën për ndihmë përmes shenjave verbale dhe / ose joverbale, p.sh., duke treguar, duke zgjatur krahët, duke u shprehur me zë. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përsërit veprime pa pushim për të kuptuar se si funksionon një objekt. • Fillon të pranojë që veprime të caktuara sjellin reagime të caktuara p.sh., nëse buzëqesh, reagimi i të rriturit do të jetë në të njëjtën mënyrë. • Përpiqet me një sërë strategjish fizike për të arritur qëllime të thjeshta, p.sh., tërheq fillin e një treni lodrash për ta afruar atë ose zvarritet për të marrë një top që është rrokullisur.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjuni shpejt në orvatjet e fëmijës për të pasur vëmendje, por jo pa u menduar. • Siguroni lodra dhe objekte interesante, të përshtatshme për moshën, për eksplorim nga fëmija. • Angazhohuni dhe bashkëveproni shpesh me fëmijën gjatë ditës. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstroni se si t'i provoni gjërat në mënyra të ndryshme dhe nxitni fëmijën të bëjë të njëjtën gjë, p.sh., përdorni një kovë plastike si daulle. • Drejtojeni me butësi fëmijës në zbulimet dhe eksplorimet që bëjnë dhe i lejoni atij pavarësi të mjaftueshme për të provuar gjëra të reja. • Përgjigjuni shpejt në përpjekjet e fëmijës për komunikim, por jo pa u menduar.

STANDARDI: Fëmijët përpigjen me një sërë strategjish për të realizuar detyra, për të kapërcyer pengesa dhe për të gjetur zgjidhje për detyrat, pyetjet dhe sfidat

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët kanë aftësi të zgjeruar për të zgjidhur sfidat që hasin gjatë përdorimit të objekteve dhe imitimit. Ata mund të marrin një rol më autonom gjatë kësaj faze, megjithatë, në shumicën e rasteve kanë nevojë për mbështetjen e kujdestarit/edukatorit.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Imiton sjelljen e kujdestarit/edukatorit për të përbushur një detyrë, p.sh., përpigjet për të mbyllur derën.
- Rrit aftësinë për të njohur dhe për të zgjidhur problemet përmes eksplorimit aktiv, lojës, provës dhe gabimit, p.sh., përpigjet të fusë një formë në kënde të ndryshme për ta bërë atë të përshtatet në një ndarës.
- Përdor objektet në mjedis për të zgjidhur problemet, p.sh., përdor një kovë për të zhvendosur lodrat e shumta në anën tjetër të dhomës.
- Përdor komunikimin për të zgjidhur problemet, p.sh., derdh ngjitesin gjatë një projekti arti dhe i bën gjeeste kujdestarit/edukatorit se i duhet ngjites tjetër.

Strategjitë për ndërveprim:

- Vlerësoni dhe motivoni përpjekjet e fëmijës për të gjetur zgjidhje për sfidat
- Tregojini fëmijës ndërsa e ndihmoni atë për të gjetur një zgjidhje, p.sh. "Le ta provojmë ta kthejmë pjesën e pazëllit nga kjo anë".
- I jepni fëmijës mundësi për të zgjidhur problemet me dhe pa ndihmën tuaj; minimizoni mundësinë që fëmija të irritohet.
- Përgjigjuni përpjekjeve për komunikim të fëmijës.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët fillojnë të diferencojnë cilat zgjidhje funksionojnë, me më pak prova. Ata bëhen gjithnjë e më autonomë dhe do të përpigjen të kapërcejnë së pari pengesat vetjake me mbështetje të kufizuar nga kujdestari/edukatori.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Kërkon ndihmë nga kujdestari/edukatori kur është e nevojshme.
- Fillon të zgjidhë problemet me më pak prova dhe gabime.
- Refuzon ndihmën, p.sh., fillimisht bën thirrje për ndihmë, por pastaj të shtyn me dorë dhe të largon.
- Tregon krenari kur kryen një detyrë.
- Përdor aftësi gjithnjë e më të rafinuara gjatë zgjidhjes së problemeve, p.sh., përdor pecetën e vet për të pastruar diçka që derdh, pa pyetur kujdestarin/edukatorin për ndihmë.

Strategjitë për ndërveprim:

- Ndiani shembullin e fëmijës dhe kushtojini vëmendje sugjerimeve të tij për ta ndihmuar në një detyrë.
- Ndani së bashku gëzimin dhe arritjet e fëmijës.
- Modeloni dhe tregoni aftësi për zgjidhjen e problemeve përmes lojës.
- Parashikoni për fëmijën kohë të pandërprerë për të marrë pjesë në një veprimtari.
- Jini disponueshëm për fëmijën dhe dalloni kur ai ka nevojë të drejtohet.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nënfusha: Besimi & Marrja e rrezikut

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë gatishmëri për të marrë pjesë në përvoja të reja dhe angazhohen me besim në marrjen e rreziqeve

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët fillojnë të krijojnë besim përmes ndërveprimeve të përditshme që ata përjetojnë me kujdestarët/edukatorët e tyre. Këto ndërveprime formojnë marrëdhënie të veçanta, të cilat nga ana e tyre krijojnë "bazën e sigurt" që fëmijët të marrin përsipër rreziqe dhe përvoja të reja.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të përdorin vetëbesimin e tyre që është duke u zhvilluar për t'u përfshirë në sjellje të thjeshta të marrjes së rrezikut, pasi ata eksplorojnë fizikisht mjedisin e tyre në kontekstin e një marrëdhënieje të sigurt.</p>
	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qan dhe përdor gjuhën e trupit për të sinjalizuar dhe për të përmbushur nevojat e tij, p.sh., eviton vështrimin ngultas. • Hulumton objektet e reja me padurim, p.sh., shtrëngon një lodër me synimin që të nxjerrë zë/tinguj. • Përdor qasje të ndryshme për përmbushjen e një detyre të thjeshtë, p.sh. duke u zgjatur, duke u zbrapsur, duke shqiptuar tinguj... • Orvatet për aftësi të reja në mënyrë vetjake, ndërsa "kontrollohet" nga edukatori/kujdestari, p.sh., fillon të lëvizë duke u zvarritur ndryshe, pastaj kthehet drejt kujdestarit/edukatorit për të marrë siguri para se të vazhdojë. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fillon të marrë rreziqe të mëdha, p.sh., zgjatet jashtë shtratit për të arritur një objekt. • Ka më shumë qëllimshmëri dhe ndihet më i sigurt kur luan dhe bashkëvepron, p.sh., kap, shtyn, hedh... • Përdor provën dhe gabimin për të zgjidhur një problem, p.sh., provon kënde të ndryshme kur përpiqet të vendosë se ku do të qëndrojnë gjatë lojës mes llojshmërisë së këndeve që i paraqiten për zgjedhje.
	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni motivim dhe kujdes të vazhdueshëm për ndërtimin e vetëbesimit të fëmijës. • Krijoni një mjedis ku fëmija ka qasje në lodra të përshtatshme për moshën. • Përdorni shenja verbale dhe joverbale për të nxitur dhe mbështetur fëmijën kur ai angazhohet në një veprimtari të re, p.sh., buzëqeshje, tundje koke, duartrokiteje... • Siguroni mbështetje në situata të reja, ndërsa i lejoni që të eksplorojë objekte të reja në mjedis. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguroni një mjedis interesant dhe të sigurt që fëmija të eksplorojë; qëndroni vigjilentë dhe ndërhyni kur është e nevojshme për ta mbajtur fëmijën të sigurt. • Mbani parasysh që fëmijës i duhet kohë për t'u përshtatur me aftësitë e reja, p.sh., fëmija papritmas mund të frikësohet nga zgjerimi i aftësitë të veta. • Nxitri fëmijën të provojë mënyra të reja për të bërë gjëra.

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë gatishmëri për të marrë pjesë në përvoja të reja dhe angazhohen me besim në marrjen e rreziqeve

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët rrisin besimin e tyre në kontekstin e një marrëdhënie të sigurt dhe fillojnë të përfshihen në detyra më komplekse dhe kërkojnë situata të reja

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Luan dhe hulumton i larguar tashmë nga figura atashuese; vazhdon të jetë i "kontrolluar" për siguri, p.sh., luan nëpër dhomë dhe shikon drejt kujdestarit/edukatorit, pastaj angazhohet përsëri në lojë.
- Kërkon ndihmë dhe siguri nga të tjerët që janë të njohur për të.
- Tregon besim në aftësi dhe arritje, p.sh. brohoret ose kërcen kur realizon një qëllim siç është plotësimi i një pazëlli të thjeshtë.
- Bëhet pjesë e një veprimtarie të re, pasi ka vëzhguar me kujdes në fillim.

Strategjitë për ndërveprim:

- Qëndroni në dispozicion të fëmijës gjatë lojës; përdorni sugjerime për të nxitur fëmijën të eksplorojë, p.sh., buzëqeshjen, tundjen e kokës dhe duartrokkitjet.
- Siguroni materiale dheveprimtari që janë sfiduese, por jo frustruese, p.sh., blloqe të mëdha, një pazëll e thjeshtë...
- Jini të ndjeshëm ndaj temperamentit të fëmijës; kuptoni që fëmijës mund t'i duhet më tepër kohë për t'u përfshirë në një përvojë të re; lejoni që fëmija të vëzhgojë derisa ai të jetë i gatshëm të marrë pjesë.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët përdorin vetëbesimin e tyre dhe fillojnë të marrin rreziqe emocionale përveç rreziqeve fizike, duke u mbështetur nga kujdestari/edukatori i tyre.

Treguesit për fëmijë përfshijnë:

- Përpiqet për të zgjidhur në mënyrë të pavarur konfliktet shoqërore pa shkuar automatikisht te kujdestari/edukatori, p.sh., përpiqet të marrë një objekt që ia mori një nga bashkëmohatarët.
- Demonstron padurim dhe vendosmëri gjatë zgjidhjes së problemeve ose gjatë detyrave të reja, p.sh., shtyn dorën e kujdestarit/edukatorit dhe nuk pranon ndihmë derisa të jetë i gatshëm ta kërkojë atë.

Strategjitë për ndërveprim:

- Vlerësoni emocionet që fëmija ndjen, p.sh., "E shoh që u mërzipte për lodrën".
- Modeloni sjellje të menduara dhe të ndjeshme përmes ndërveprimeve të përditshme.
- Sigurojini fëmijës mundësi për të zgjidhur problemin e tyre, duke ndërhyrë vetëm atëherë kur fëmija duket se është i irrituar dhe kërkon ndihmë.

GJATË KËSAJ PERIUDHE

Perspektiva e “marrjes së rrezikut”

Termi “marrje rreziku” mund të jetë pak shqetësues për kujdestarët/ edukatorët, sepse ata punojnë shumë për të siguruar që fëmijët të jenë gjithmonë të sigurt. Sidoqoftë, marrja e rrezikut “të duhur”, gjatë zhvillimit, është një sjellje pozitive dhe e natyrshme te fëmijët. Kur fëmijët ndiejnë besim tek kujdestarët/ edukatorët e tyre dhe ndihen të sigurt në aftësitë e tyre, ata marrin përsipër rreziqet e nevojshme për të mësuar aftësi të reja.

Me mbështetjen dhe nxitjen e kujdestarëve, fëmijët përpiqen të zotërojnë aftësi të reja dhe, kur të jenë të suksesshëm, të ndërtojnë ndjenja krenarie dhe vetvlerësimi.

Marrja e rrezikut nuk i referohet vetëm rreziqeve fizike siç janë zvarritja dhe ecja. Marrja e rrezikut gjithashtu i referohet rreziqeve emocionale që fëmijët marrin përmes marrëdhënieve të tyre me të tjerët. Këto rreziqe që duhet të ndërmarrin fëmijët janë të rëndësishme për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme shoqërore në të ardhmen.

Nënfusha: Këmbëngulja, Përpjekja dhe Vëmendja

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi për t'u përfshirë në përvoja dhe për të zhvilluar ndjenjë qëllimi dhe vazhdimi logjik

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët vëzhgojnë, hulumtojnë, ndjekin dhe bashkëveprojnë me botën përreth tyre</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendosi dhe mban kontakte me sy me kujdestarin/edukatorin • Fokuson vëmendjen te tingujt, njerëzit dhe objektet. • Përsërit veprime interesante pa pushim. • Tregon preferencat duke përdorur shenja joverbale, p.sh., kthen kokën, shkelmon me këmbë... 	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të bëhen më këmbëngulës në bashkëveprimin me njerëzit, eksplorimin e objekteve dhe përmeshjen e detyrave. Ndërsa aftësia e tyre për të mbajtur vëmendjen rritet, ata akoma shpërqendrohen lehtësisht nga objektet dhe ngjarjet e tjera në mjedis.</p>	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në ndërveprime reciproke p.sh., luan kukamfshehti me një të rritur. • Përsërit veprimtaritë pa pushim, p.sh., fut me sukses të gjitha format në kutinë përkatëse, i hedh ato dhe fillon përsëri. • Përpiqet të ndihmojë në veprimtari të vetëndihmës, p.sh., ushqyerja, pastrimi... • Tregon preferenca personale.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Angazhohuni dhe luani shpesh me fëmijën. • Siguroni lodra dhe objekte interesante dhe të përshtatshme për moshën, për t'i eksploruar pa e tepruar; kufizoni numrin e lodrave, ngjyrave dhe tingujve që gjenden në mjedis. • Përgjigjuni përpjekjeve të komunikimit të fëmijës, duke u menduar paraprakisht. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndani arritjet me fëmijën; nxiteni fëmijën përmes detyrave. • Angazhohuni dhe luani me fëmijën çdo ditë. • Ndiqni shembullin e fëmijës kur bën veprimtari. • Lëreni fëmijën të ndihmojë në veprimtari të vetëndihmës kur ai tregon interes. • Pranoni preferencën e fëmijës, p.sh. "Ju doni gotën blu, ja ku është." ose "Unë e shoh që kërkon një libër, por tani është koha për të ngrënë." 			

Këmbëngulja është aftësia për të realizuar një proces përmes arritjes së një qëllimi të veçantë. Fëmijët demonstronjë këmbëngulje kur ata punojnë përmes sfidave për të përfunduar detyrat dhe / ose veprimet.


STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi për t'u përfshirë në përvoja dhe për të zhvilluar ndjenjë qëllimi dhe vazhdimi logjik

16 muaj deri në 24 muaj:

Fëmijët rrisin aftësinë për t'u përqendruar në detyrat e orientuara drejt qëllimit. Në këtë fazë, këmbëngulja dëshmohet nga procesi i angazhimit të fëmijës për të zbuluar se si të arrijë qëllimin, në vend të arritjes së rezultatit përfundimtar.

21 muaj deri në 36 muaj:

Fëmijët mund të ndjekin detyrat për periudha më të gjata kohore dhe aftësia e tyre për të vazhduar në detyra më të vështira rritet. Për më tepër, fëmijët tani janë në gjendje të marrin pjesë në më shumë se një ngjarje në mjedisin e tyre; kjo aftësi u lejon atyre të qëndrojnë të përqendruar edhe kur ka shpërqendrim.



<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqendrohet për periudha më të gjata kohore në veprimtari. • Përsërit përvojat që e gëzojnë atë, p.sh., thotë "më shumë" pasi i lexon librin e tij të preferuar. • Shfaq preferenca për veprimtari, p.sh., lexon me kujdestarin/ edukatorin, luan në këndin e rërës, preferon të ulet pranë kujdestarit/ edukatorit. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bën zgjedhje bazuar në preferencat e tij, ndonjëherë edhe në kundërshtim me zgjedhjet e të rriturve, p.sh., "Jo qumësht, dua lëng". • Përpiqet për të provuar një detyrë të vështirë me kalimin e kohës. • Praktikon një veprimtari shumë herë për ta zotëruar atë, edhe pse mund të ketë pengesa. • Tregon interes për të përfunduar në mënyrë të pavarur detyrat rutinë, p.sh., zhvesh xhupin, vesh këpucët ...
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurojini fëmijës manipulues të ndryshëm që ai të eksplorojë në mënyrë të pavarur, p.sh., pazëlla, tabela me kunjë, libra, etj. • Festoni edhe ju për arritjet e fëmijës në mënyrë të vërtetë. • Ofroni mbështetje dhe udhëzime nëse fëmija zhgënjehet kur luan; përgjigjuni menjëherë fëmijës nëse kërkon ndihmë. • Njihuni me veprimtaritë e preferuara të fëmijës dhe i përdorni ato për të identifikuar lodra dhe materiale të tjera, për të cilat fëmija interesohet. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lejoni fëmijën të bëjë zgjedhje të caktuara gjatë gjithë ditës. • Mbështetni fëmijën në ndërtimin e vëmendjes duke zgjeruar ndërveprimet, p.sh., shtoni një përvojë të re në bashkëveprimin aktual. • Mendoni si ta mbështesni më mirë fëmijën në plotësimin e detyrave komplekse; merrni parasysh aftësitë e ndryshme të secilit. • Mundësoni për fëmijën përgjegjësi të vogla, p.sh., ndarja e gotave gjatë kohës së drekës ose mbajtja e derës për për të hyrë shokët.


Nënfusha: Krijueshmëria dhe Imagjinata

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi krijuese dhe imagjinatë për të rritur të kuptuarit dhe njohuritë e tyre për botën

<p>GJATË KËSAJ PERIUDHE</p>	<p>Lindja në 9 muaj: Fëmijët vëzhgojnë dhe bashkëveprojnë me mjedisin përreth tyre dhe fillojnë të ndërtojnë aftësitë e nevojshme për të manipuluar objektet dhe materiallet në mënyra të ndryshme.</p>	<p>7 deri 18 muaj: Fëmijët fillojnë të përdorin shumicën e mjeteve dhe materialeve me një qëllim të synuar. Fëmijët fillojnë të eksperimentojnë përdorimin e këtyre objekteve dhe materialeve në mënyra të reja dhe të papritura.</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon materiale, sende dhe njerëz me kuriozitet. • Kërkon në mënyrë aktive objekte të reja që gjenden në mjedis duke i prekur, goditur dhe duke futur në gojë. • Arrin objektet në afërsi. • Imiton tinguj, lëvizje dhe shprehje të futyrës siç bën kujdestari/edukatori. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Imiton veprimet e një bashkëmoshatari, p.sh., godet tavolinën me gotë. • Përdor objektet me një qëllim të caktuar, p.sh., rrotullon një makinë lodër • Kalon kohë më të madhe duke hulumtuar dhe mësuar rreth objekteve, p.sh., harxhon më shumë kohë me një lodër të re në mënyrë që ta kuptojë më mirë. • Fillon të përdorë objektet në mënyra të reja dhe të papritura, p.sh., vendos një shportë në kokë. • Imiton veprimet e njerëzve të tjerë në një mënyrë të këndshme, p.sh., i tund gisht kukullës dhe i thotë, "jo, jo, jo!" 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Imiton veprimet e një bashkëmoshatari, p.sh., godet tavolinën me gotë. • Përdor objektet me një qëllim të caktuar, p.sh., rrotullon një makinë lodër • Kalon kohë më të madhe duke hulumtuar dhe mësuar rreth objekteve, p.sh., harxhon më shumë kohë me një lodër të re në mënyrë që ta kuptojë më mirë. • Fillon të përdorë objektet në mënyra të reja dhe të papritura, p.sh., vendos një shportë në kokë. • Imiton veprimet e njerëzve të tjerë në një mënyrë të këndshme, p.sh., i tund gisht kukullës dhe i thotë, "jo, jo, jo!"
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijoni një mjedis motivues që fëmija të eksplorojë: ndryshoni rregullisht materiallet dhe lodrat në mjedisin e fëmijës. • Ndiqni shembullin e fëmijës gjatë lojës. • Angazhohuni me fëmijën kur ai është duke eksploruar, p.sh. tregoni çfarë bën objekti ose lodra. • Siguroni lodra dhe përvoja që kanë një larmi ngjyrash, materialelesh, tingujsh dhe aromash. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reagoni me entuziazëm kur fëmija tregon përdorime të reja për objektet që ai ka zbuluar. • Siguroni materiale që mund të përdoren në më shumë se një mënyrë. • Ndryshoni shpesh objektet dhe lodrat e fëmijës. • Luani shpesh me fëmijën dhe nxitni krijueshmërinë. • Imitoni fëmijën gjatë lojës. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reagoni me entuziazëm kur fëmija tregon përdorime të reja për objektet që ai ka zbuluar. • Siguroni materiale që mund të përdoren në më shumë se një mënyrë. • Ndryshoni shpesh objektet dhe lodrat e fëmijës. • Luani shpesh me fëmijën dhe nxitni krijueshmërinë. • Imitoni fëmijën gjatë lojës.

Përfaqësimi simbolik i referohet kuptueshmërisë së fëmijëve se si një imazh ose objekte të ndryshme mund të përfaqësojnë objekte të njohura

STANDARDI: Fëmijët demonstrojnë aftësi krijuese dhe imagjinatë për të rritur të kuptuarit dhe njohuritë e tyre për botën



<p>16 muaj deri në 24 muaj: Fëmijët fillojnë të zgjerojnë mënyrën si të përdorin krijimtarinë, imagjinatën përmes përdorimit të përfaqësimit simbolik në lojë</p>	<p>21 muaj deri në 36 muaj: Fëmijët përfshijnë kreativitetin e tyre dhe imagjinatën në mënyrë më komplekse ndërsa luajnë, komunikojnë dhe zgjidhin problemet</p>
<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pretendon për një objekt sikur është një tjetër duke përdorur zëvendësimin, p.sh., përdor një makinë lodër për të larë flokët. • Pretendon sikur luan me objekte dhe përvoja të njohura, p.sh., vendos kukullën në karrrocë dhe shtyn karrrocën për shëtitje. • Bën pjesë edhe të rriturit e njohur në lojëra pretenduese, p.sh., i jep të rriturit një flixhan lodër dhe pretendon të derdh "çaj" në të. • Komunikon në mënyra krijuese, p.sh., luan me fjalë duke rimuar, duke kënduar; përdor lëvizjet dhe vallëzimin. 	<p>Treguesit për fëmijë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor sende dhe lodra në mënyra të reja dhe të papritura; zëvendëson një objekt për një tjetër për të zgjidhur problemin. • Merr role të njohura gjatë lojës, p.sh., kuzhinier në kuzhinën e pretenduar. • Shpreh ide krijuese ndaj bashkëmohatarëve ndërsa luan; bëhet drejtues për bashkëmohatarët, p.sh., "Ti do të jesh polic dhe do të veshësh këtë." • Krijon një projekt artistik; krijon histori të thjeshta për të shoqëruar projektin.
<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Luani me fëmijën; ndiqni shembullin e saj. • Përdorni rrefimin gjatë lojës me fëmijën, p.sh., "Do ta merrni fëmijën për shëtitje në dyqan?" • Nxitni përplekjet krijuese të fëmijës. • Angazhohuni aktivisht me fëmijën ndërsa luan; tregoni entuziazëm dhe kënaqësi kur luan. 	<p>Strategjitë për ndërveprim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërveproni me fëmijën gjatë pretendimeve dhe ndiqni shembullin e tij. • Bëni pyetje të hapura kur luani me fëmijën në mënyrë që të zgjeroni mendimet dhe gjuhën e tyre. • Nxitni fëmijën të mendojë për ide të reja, p.sh., "Si mendoni, çfarë ndodh kur fluturoi fluturon lart?"

PLANIFIKIMI DHE PROJEKTI EDUKATIV/PEDAGOGJIK

Projektimi i shërbimit të çerdheve në nivel makro dhe mikro

Referuar shërbimit të çerdheve është e nevojshme të specifikohen dy dokumente, të cilat sqarojnë procesin e projektimit të shërbimit të çerdheve në dy nivele, atë makro – kur flasim për *projektin edukativ* (plani i ofertës edukative) dhe atë mikro – kur flasim për *njësine edukative*.

Projekti edukativ (prej këtu PE) përbën dokumentin kryesor të një makroprojektimi, i cili parashikon një shtrirje kohore të ndryshueshme, zakonisht vjetore ose semestrare. Në këtë dokument përkufizohen, në linja të përgjithshme, hapat që parashikohen të ndërmerren në aspektin edukativ, duke iu referuar proceseve, elementëve përmbajtësorë, kritereve dhe aspekteve pedagogjike mbi të cilat mbështetet PE.

Njësia edukative paraqitet si dokument në nivel mikro (mikroprojekt) në përbërje të të cilit gjejmë kornizën teorike të referimit, formulimin e objektivave të përgjithshëm dhe atyre specifike, specifikimin e përfituesve të shërbimit dhe hapave të punës, përcaktimin e veprimtarive, metodologjisë që do të zbatohet dhe kohën e realizimit,

Planifikimi konsiderohet *i gjithë procesi konceptual dhe operativ i planit*, nga identifikimi i qëllimeve të të vepruarit edukativ deri tek verifikimi i rezultateve. Pra, planifikimi dallon nga koncepti i projektimit. Projektimi, në dallim nga plani i cili zgjat në kohë, duke qenë një produkt operativ i procesit të planifikimit, i cili ripërpunohet në mënyrë të vazhdueshme, është i destinuar të përfundojë në momentin kur realizohet konkretisht ideja rreth së cilës është hartuar edhe projekti. Koncepti i planit referuar shërbimit për FFH, na jep idenë se ekzistojnë elementë të qëndrueshëm të cilët shfaqen gjatë gjithë procesit vendimmarrës si themelet e veprimit edukativ të cilët përkufizohen dhe riformulohen në mënyrë të vazhdueshme.

Gjithsesi, në këtë dokument do të përdoret termi **“projekt”** për t’ju referuar *projektit edukativ* i cili nënkupton t’i *paraprijë një veprimi të mundshëm duke u mbështetur në supozime* (Cappuccio, 2008) të përpikta kulturore, pedagogjike, identitare dhe organizuese. Referuar kësaj perspektive, të projektosh një shërbim për FFH, siç mund të jetë shërbimi i ofruar nga institucionet e çerdheve, do të thotë të paraprish, të tentosh realizimin e një ideje e cila shtyn në përmbushjen optimale të objektivave edukative të vlefshëm jo vetëm për fëmijën, por edhe për familjen, komunitetin dhe realitetin kulturor në të cilin ato bëjnë pjesë. Ky përkufizim gjen mbështetje në:

modelin hipotetik-deduktiv të Djuitt (Dewey) si prototip të “një menduari reflektiv” që shikon tek projekti (t’ paraprish një ideje si zgjidhjae një problemi) dhe në mundësinë t’u realizuar si një mekanizëm nëpërmjet të cilit është e mundur të pasurohet njohja njerëzore duke përdorur eksperiencën e kaluar si mjet për t’i bërë ballë problemeve të reja. (Becchi, E., Bondioli, A., Ferrari, M., & Gariboldi, A., 2002) .

Pra, projekti pedagogjik/edukativ paraqitet si një kërkim-veprim, ku i lihet hapësirë ekipit të punës, i cili harton dhe vë në jetë projektin, eksperimenton dhe propozon ide dhe situata edukative të reja dhe bashkëkohore, në evolucion të vazhdueshëm.

Çdo çerdhe duhet të hartojë projektin edukativ (pedagogjik) për t'u përgjigjur në dy drejtime, atë *institucional* dhe atë *pedagogjik*.

Në aspektin *institucional*, PE ka për qëllim të kualifikojë shërbimin e vet së jashtmi, duke përshkruar tipologjinë, organizimin, potencialin dhe propozimet edukative që nxiten prej tij. Në këtë drejtim, PE shërben si mjet nëpërmjet të cilit institucionet, nëpërmjet organeve të tyre kompetente, verifikojnë që një shërbim i përmbush apo jo kriteret e nevojshme për t'u konsideruar si "cilësor", apo pse jo edhe "ekselent".

Ndërkohë, në aspektin *pedagogjik*, PE cilësohet si dokumenti që drejton rrugëtimin edukativ që do të bëjnë fëmijët, punonjësit e shërbimit dhe familjet duke ndjekur një logjikë ekologjike ku marrin pjesë të gjithë aktorët kryesorë dhe mjediset e së përditshmes. Këtu dallojmë edhe rëndësinë e hartimit të PE nga një ekip ku marrin pjesë jo vetëm edukatorët, por edhe figurat e tjera që kujdesen për fëmijën si, punonjësit mbështetës, të cilët janë përditë në kontakt me fëmijët në çerdhe, si dhe prindërit si edukatorët parësorë të fëmijëve të tyre. E domosdoshme shfaqet nëvoja që PE të pasqyrojë një *karakter etik* i cili cilëson përgjegjësitë, angazhimin në formën e një pakti apo premtimi për të realizuar qëllimet dhe objektivat të specifikuar në kohë dhe në mënyrat se si do të përmbushen. Pra, dokumenti duhet të jetë sa më transparent, në të gjitha pikat që përmban, për t'i lejuar subjektet që do ta konsultojnë të njohin dhe kuptojnë qëllimet, metodat që do të përdoren për të arritur objektivat si dhe argumentimet që mbështesin ato.

Qartësia në specifikimet e arsyeve, objektiveve dhe metodave është e domosdoshme për monitorimin dhe vlerësimin të të gjithë procesit projektues, duke lehtësuar dhe identifikimin dhe autorësinë e burimeve të menduara për realizimin e projektit.

Përsa i përket strukturës së PE, ajo duhet të karakterizohet nga:

- a) koherenca e brendshme
- b) qartësia e ideve orientuese
- c) mundësi konkrete për realizim
- d) planifikimi i kohës dhe burimeve materiale dhe njerëzore.

Në nivel teorik PE mund të artikulohet në tre pjesë:

ideja bazë – janë parimet/ parakushtet edukative, pedagogjike dhe kulturore, në bazë të të cilave përkufizohen dhe shpjegohen zgjedhjet edukative-didaktike të cilat do të reflektohen në program;

identifikimi i shërbimit dhe organizimi – në këtë pjesë realizohet karta e identitetit të shërbimit, duke përfshirë historinë e zhvillimit të shërbimit, aspektet kulturore dhe normative, struktura fizike dhe ajo funksionale. Të gjithë këta elementë kanë prirje të jenë të qëndrueshëm gjatë ofrimit të shërbimit apo të ndryshojnë për një kohë të gjatë.

projektimi edukativ – përkufizohet mënyra sipas të cilët ekipi edukativ do të projektojë veprimtaritë didaktike për vitin edukativ. Kjo pjesë integrohet dhe plotësohet në mënyrë periodike me produkte që dalin nga takimet e programuara (mikroprojekte apo njësi didaktike) të cilat zhvillohen gjatë vitit. Pra shërben si udhëzues i punës që do të zhvillohet gjatë gjithë vitit.

Për një skemë të përmbajtjes së projektit edukativ shikoni skedën e mëposhtme

ELEMENTËT E PROJEKTIT EDUKATIV

1. IDET E THEMELORE

- 1.1. Ideja e shërbimit
- 1.2. Ideja e fëmijës
- 1.3. Ideja e familjes
- 1.4. Ideja e të nxënit
- 1.5. Ideja e profesionalizmit
- 1.6. Ideja e komunitetit

2. IDENTIFIKIMI I SHËRBIMIT DHE ORGANIZIMIT

- 2.1. Historia
- 2.2. Identiteti dhe tipologjia e shërbimit
- 2.3. Qellimi dhe objektivat
- 2.4. Shtrirja dhe pozicionimi i strukturës
- 2.5. Organizimi i hapësirave
 - 2.5.1. Hapësirat për veprimtari
 - 2.5.2. Hapësirat për kujdesjen dhe rutinat
 - 2.5.3. Hapësirat që përdoren ekskluzivisht nga të rriturit
 - 2.5.4. Hapësirat e përbashkëta
 - 2.5.5. Hapësirat e jashtme
- 2.6. Organizimi i personelit
 - 2.6.1. Ndarja e organikës së personelit (numri, formimi, personel i brendshëm dhe i jashtëm)
- 2.7. Organizimi i kolektivit
 - 2.7.1. Marrëdhëniet e brendshme
 - 2.7.1.1. Mbledhjet e ekipit/ve
 - 2.7.1.2. Komiteti i menaxhimit
 - 2.7.2. Marrëdhëniet e jashtme
 - 2.7.2.1. Komunikimi dhe raportimi me familjet
 - 2.7.2.2. Asambleja e prindërve (e përgjithshme dhe me seksione)
 - 2.7.2.3. Intervistat në momentin e pritjes dhe të ribashkimit
 - 2.7.2.4. Intervistat individuale (intervista e parë dhe intervistat gjatë vitit)
 - 2.7.2.5. Mjetet e komunikimit (ditaret personale, udhëzimet dhe urdhëresat...)
 - 2.7.2.6. Komiteti për organizimin e veprimtarive dhe propozimeve (komiteti i mensës, i festave, i formimit)
- 2.8. Strukturimi i kontekstit edukativ
 - 2.8.1. Kompozimi i grup-seksioneve (numri i fëmijeve, mosha, figurat dhe hapësirat e referimit)
 - 2.8.2. Strukturimi i ditës edukative duke identifikuar veprimtaritë e ditës
 - 2.8.3. Kalendari edukativ (festa, mbyllja e shërbimit...)

3. PROJEKTI EDUKATIV

- 3.1. Tipologjia e projektit vjetor (me laboratore, me sfond të integruar dhe me projekte)
- 3.2. Projekte periodike (mujore, dymujore, tremujore)
- 3.3. Vlerësimi
 - 3.3.1. Vlerësimi i fëmijës
 - 3.3.2. Vlerësimi i projektit
 - 3.3.3. Vlerësimi i shërbimit të ofruar

Ideja e shërbimit.

Konsiston në përkufizimin e mënyrave me anë të të cilave drejtuesit e shërbimit dhe punonjësit kualifikojnë, së jashtmi dhe së brendshmi, shërbimin që ofrojnë. Kualifikimi i jashtëm ka si objektive të paraqesë shërbimin komunitetit, duke e njohur këtë të fundit me qëllimet e shërbimit të cilat vënë në qendër të vëmendjes nevojat e territorit, marrëdhëniet, aksesueshmërinë dhe qëndrueshmërinë edhe me agjensitë e tjera që veprojnë në territor. Kualifikimi i brendshëm u jep mundësi punonjësve të përshkruajnë idenë që ata kanë rreth mjedisit edukativ, i projektuar në shërbim të fëmijëve dhe familjeve.

Ideja e fëmijës.

Kur projektohet në fushën e edukimit duhet të jetë i qartë ideali drejt të cilit synohet dhe objekti hulumtues. Qartësimi i idesë së fëmijës ndihmon punonjësit të ndajnë të njëjtin këndvështrim dhe të kuptuar të objektit në fokus (fëmijës) në mënyrë të tillë për të orientuar projektimet që do të hartojnë. Të njohësh objektin e studimit (dhe të punës) ndihmon në evitimin e sjelljeve dhe të praktikave të cilat s'kualifikojnë konceptimin e drejtë dhe lejon të ndërmerren veprime të cilat tentojnë të realizojnë idealin e pranuar, duke evituar kështu gjithëçka që largon nga ky ideal. Pra, të konsiderosh fëmijën si person, nxit edukatorët të punojnë me një subjekt që vetëpërcaktohet, i cili ka nevojat e veta dhe është në gjendje të ndryshojë subjektet e tjera me të cilët hyn në kontakt. Në të njëjtën mënyrë, të mendosh për të realizuar plotësisht potencialin e një fëmijë do të thotë të përdorësh një larmi metodash dhe veprimtarish, të cilat e bëjnë të pavarur dhe e aftësojnë të sillet dhe të veprojë në mënyrë kompetente.

Ideja e familjes

Duke iu referuar konceptit të familjes, realizohen projekte të cilat konsiderojnë familjen protagoniste në procesin edukativ të fëmijës. Në ndryshim nga konceptimi më i hershëm i edukimit, i cili vendoste në qendër fëmijën, çerdhja përkrah teorinë ekologjike të Bronfenbrenner ku në qendër, për zhvillimin social të fëmijës, vendosen të gjitha mjediset ku vepron fëmija, ku rol thelbësor kanë marrëdhëniet e para të jetës që ndërton fëmija në kontekstin familjar.

Ideja e të nxënit

Duke u nisur nga ideja se si nxë fëmija, projektohen stimujt të cilat lehtësojnë të nxënë të fëmijës.

Ideja e profesionalizmi.

I referohet llojit të përgatitjes dhe të aftësive vepruese dhe njerëzore që një punonjës duhet detyrimisht të ketë për të punuar në këtë shërbim. Ideja e profesionalizmit specifikon cilësinë e të qenurit dhe të vepruarit përtej njohjeve të përvetësuar.

Ideja e komunitetit

Tregon lidhjen që duhet të ketë projektimi i brendshëm me specifikat e territorit dhe ato kulturore në të cilat integrohet shërbimi.

Historia

Përshkruan lindjen dhe evoluimin e shërbimit deri në ditët aktuale dhe perspektivat e së ardhmes.

Identiteti dhe tipologjia e shërbimit.

Specifikon elementë që i përkasin llojit të shërbimit, publik apo privat, laik apo fetar, të vetëm apo në rrjet.

Qëllimet dhe objektivat

Në një projekt edukativ qëllimet që do të propozohen do të kenë në qendër, fëmijën, familjen, shërbimin dhe komunitetin. Çdo qëllim do të artikullohet me objektiva të përgjithshëm dhe specifike.

Shtrirja dhe pozicionimi i strukturës.

Jepen të dhëna rreth vendndodhjes së shërbimit, adresa, zona, lagjja dhe karakteristika sociodemografike të zonës.

Organizimi i hapësirës

Përshkruhen mjediset e shërbimit dhe struktura e tyre. Mund të ndahen në makrofusha:

- **hapësira për veprimtari.** – strukturimi i seksioneve në kënde. Hapësirat e seksioneve zakonisht organizohen referuar moshës të fëmijëve që pret (të vegjlit, motakët dhe të rriturit). Hapësirat janë të menduara për t'u krijuar mundësi fëmijëve të lëvizin në mënyrë të pavarur dhe të eksperimentojnë në mënyra aktive kompetencat e veta. Hapësirat duhet gjithashtu të lejojnë zhvillimin e veprimtarive edhe në kontekste të ndryshme ndërvepruese: marrëdhënie midis bashkëmohatarëve në çifte, në grupe të vogla dhe grupe të mëdha. Përveç seksioneve, hapësirat për veprimtari mund të jenë salloni apo mjedise të tjera për veprimtari specifike apo laboratoriale.
- **hapësira për kujdesin dhe rutinat** – janë hapësira e banjove (si zona e shërbimeve higjienike ashtu edhe ajo e ndërrimit të pelenave), zona e pritjes dhe e ndarjes, e ngrënies dhe e gjumit. Në këto zona fëmijët eksperimentojnë rutinat e ditës në çerdhe, të cilat janë funksionale për përdorimin e hapësirave dhe për përvetësimin progresiv të pavarësisë në lëvizje dhe në veprime.
- **hapësira që përdoren ekskluzivisht nga të rriturit** – janë mjedise ku fëmija nuk mund të hyjë, por shërbejnë si zyra, mjedise për mbledhje, intervista me prindërit, dhomat e zhveshjes dhe banjot e personelit, magazina dhe dhoma e mjeteve;
- **hapësirat e përbashkëta** – përkufizohen mjediset e përbashkëta midis disa shërbimeve të së njëjtës strukturë (p.sh. çerdhe dhe kopësht)
- **hapësirat e jashtme** – oborri, i cili konsiderohet një mjedis edukativ i rëndësishëm, hyrja në çerdhe dhe zonat e parkimit.

Organizimi i personelit

Në këtë pjesë përshkruhet hierarkia e personelit, rolet, detyrat dhe kompetencat e secilit. Pra, përcaktohen se kush dhe sa persona kryejnë një detyrë të caktuar, formimi që kanë dhe formimi i kërkuar i personelit të brendshëm.

Organizimi i kolektivit

Kolektiv do të kuptojmë të gjitha asamblëtë, mbledhjet dhe takimet e personelit, të prindërve dhe të personave të tjerë që kanë lidhje me shërbimin. Në kontekste të tilla ndërtohen lidhje të natyrave të ndryshme të cilat mund të ndahen në të brendshme dhe të jashtme:

- **marrëdhënie të brendshme** – mbledhjet dhe takimet e personelit të brendshëm të shërbimit apo atij administrativ. Mund të përmenden mbledhjet e ekipit midis personelit edukativ dhe

të komitetit për menaxhim, për të diskutuar rreth zgjedhjeve të karakterit të përgjithshëm të shërbimit;

- **marrëdhënie të jashtme** – midis personelit të brendshëm dhe familjeve. Përshkruhen mënyrat dhe mjetet e komunikimit, asamblëtë e prindërve, intervistat me prindërit dhe komitetet e formuara si pjesë të shërbimit.

Strukturimi i kontekstit edukativ

Gjithçka që ka lidhje me organizimin pedagogjik të mjedisit edukativ ku mund të përmenden:

Kompozimi i grup-seksioneve (numri i fëmijëve, moshë, figurat dhe hapësirat e referimit);

Strukturimi i ditës edukative duke identifikuar veprimtaritë e ditës;

Kalendari edukativ (festat kombëtare, mbyllja e shërbimit, fillimi dhe fundi i vitit edukativ dhe të veprimtarive të ndryshme, programimi i festave, asambleve, intervistave, etj.)

PROJEKTIMI EDUKATIV

Duhet të specifikojmë se *projektimi edukativ* është “varibël” pasi i nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme të cilat reflektojnë zgjedhjet pedagogjike që bën vazhdimisht ekipi edukativ. Çdo vit, personeli edukativ zgjedh temat dhe metodat që do të ndiqen për të realizuar veprimtaritë e ndryshme edukative të cilat do të propozohen për t’u realizuar me grup-seksionet përkatëse. Veprimtaritë duhet të përfshijnë kontekste të ndryshme eksperience: **psikomotorika, grafo-piktura, manipulimi i objekteve dhe ndërtimi, loja me gjasme dhe përfshirja në role tregimi, me qëllim për të aktivizuar në mënyrë të integruar marrëdhëniet, emocionet, kompetencat dhe njohuritë midis fëmijëve.** (Cappuccio, 2008).

Gjithashtu, në fillim të vitit edukativ ekipi zgjedh temat që do të trajtohen dhe mënyrat e projektimit (me laboratorë, me projekte, etj.) të cilat më pas do të strukturohen në mënyrë më specifike gjatë takimeve (javore, mujore, dymujore, tremujore, semestrare) përgjatë vitit. Programimi me projekte, mund të konsiderohet më i plotë pasi veprimtaritë që propozohen përpunohen në **njësi edukative**.

Skema e një projekti mund të jetë:

Titulli i projektit

1. Objektivat e përgjithshëm
2. Objektivat specifikë
3. Grup-seksionet e angazhuara
4. Hapësirat që do të përdoren
5. Veprimtaritë
6. Metodologjia
7. Burimet materiale
8. Roli i edukatorëve
9. Koha e realizimit
10. Mënyrat e vlerësimit.

Në mënyrat e vlerësimit, vëzhgimi është një nga mënyrat më të mira për t'u përdorur. Mund të përdoren skedat e vëzhgimit paraprakisht të ndërtuara, video, foto, materiale të ndërtuara nga puna me fëmijët, etj.

Vlerësimi do të kryhet për **fëmijën, projektin dhe shërbimin.**

Vlerësimi i fëmijës mund të konsiderojë treguesit e zhvillimit të fëmijës duke përdorur skedat e vëzhgimit, të cilat mund të plotësohen me frekuencë tremestrale, semestrale dhe vjetore ose mund të parashikohen gjatë zhvillimit të një projekti specifik duke vëzhguar treguesit në fund apo gjatë zhvillimit të projektit.

Vlerësimi i projektit ka të bëjë me verifikimin e rezultateve dhe të mënyrave të zbatimit të projekteve të ideurara. Zakonisht, personeli edukativ verifikon projektet përgjatë zhvillimit të tyre si dhe rezultatet e arritura duke i krahasuar vazhdimisht me objektivat dhe qëllimet e përvaktuara që në fillim. Vlerësimi *përgjatë zhvillimit* të projekteve krijon mundësinë për të riformuluar veprimtaritë dhe për të përshtatur objektivat me përgjigjet që japin famijët gjatë zbatimit të tyre. Vlerësimi përfundimtar është i domosdoshëm për të parë nëse projekti ka mundur realizimin e qëllimeve të parashikuara dhe për të vendosur nëse projekti mund të ripropozohet apo duhet braktisur.

Vlerësimi i shërbimit (*customer satisfaction*) konsiston në mbledhjen e të dhënave me anë të pyetësorëve, rreth cilësisë së shërbimit, të drejtuar përfituesve të shërbimit, personelit të brendshëm dhe personave të tjerë që interesohen dhe bashkëpunojnë për ofrimin e shërbimit.

Pra elementët karakterizues të projektit edukativ mund të përmbliidhen si më poshtë:

Elementët karakterizues të PE

Kush e harton PE

Ekipi edukativ (edukatorët dhe personeli ndihmës) me pjesëmarrje aktive

Kujt i drejtohet

-Personelit të brendshëm

-Familjeve

-Subjekteve të jashtme (institucioneve si Bashkive apo drejtorive përkatëse)

Qëllimet

Përshkrimi dhe argumentimi i zgjedhjeve dhe metodologjisë edukative të shërbimit për FFH

Dokumentet të cilave iu referohet dhe të cilat e plotësojnë

Kuadri ligjor

Karta e shërbimeve

Rregullore e shërbimit

Projekti edukativ i institucionit

Rregullore e shërbimit pediatrik

Manuale i shërbimit të mencës

Mënyrat e informimit të subjekteve përfitues të shërbimit

Nëpërmjet dokumentave në format letër që i jepen çdo familjeje përfitues të shërbimit (informacion i përmbledhur)

Publikim në site

Publikim në hapësirën informuese të shërbimit (bacheche informative)

Prezantim në asamblenë me familjet

Prezantim në mbledhjet e komitetit të menaxhimit të shërbimit

Koha e hartimit

Viti të cilit i referohet

Njësia edukative

Njësi edukative përkufizohet një ide projekt i cili mund të zhvillohet në një kohë të shkurtër nga 2-4 orë pune. (Restiglian, 2012).

Parimi mbi të cilin mbështetet çdo projekt është ai i bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm, në këtë rast edukatorëve, të cilët duhet t'i referohen së njëjtës kornizë teorike, e cila do të drejtojë dhe frymëzojë shërbimet dhe veprimtaritë që do të ofrohen në këto shërbime. Të propozosh një veprimtari në vend të një veprimtarie tjetër, apo të përdorësh strategji dhe materiale të ndryshme do të thotë se je duke iu referuar teorive të zhvillimit dhe menaxhimit të punës, të cilat duhet të jenë qartësuar dhe kuptuar që në hapat e parë nga i gjithë ekipi i punës dhe më pas nga familjet. Gjithashtu, përdorimi i një gjuhe specifike dhe shkencore do të thotë të bësh transparente proceset dhe reflektimet që shoqërojnë hapat e punës, duke ritur kështu cilësinë e shërbimit të ofruar. Pra është e nevojshme që elementët përmbajtësorë të njësisë edukative të jenë të qartë për edukatorët dhe familjet.

Titulli	Shërben për të identifikuar njësinë edukative, duke e karakterizuar në dallim nga të tjerat edhe pse e kufizuar në kohë.
Motivimi	Njësia edukative duhet të akordohet më veprimtaritë e përgjithshme që organizon struktura. Pra, NE është një vjen si një mini projekt i cili duhet të përkufizohet teorikisht dhe në kohë në lidhje me PE, dhe me makro-projektet e tjera të mbështetura nga enti menaxhues dhe familjet. NE motivohet dhe integrohet qëllimisht në rrugetimin edukativ të fëmijës nëpërmjet referencave psiko-socio-pedagogjike.
Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë	Përcaktohen një ose dy objektiva të përgjithshëm, duke konsideruar se i referohemi gjithnjë makro-projekti vjetor apo periodik dhe një numër i vogël objektivash specifikë të fokusuar mbi kompetencat që do të ketë arritur fëmija në fund të eksperiencave të parashikuara. Objektivat specifikë artikulohen me anë të foljeve (p.sh. fëmija dallon objektet e paraqitura)
Përfituesit	Përshkrimi i përfituesve nga veprimtaritë që do të zhvillohen është e domosdoshme, duke ditur se puna me dy, tre apo pesë fëmijë, apo fëmijë të moshave të ndryshme kërkon përshtatje të strategjive, hapësirave, mjeteve, etj.

<p>Krijimi (rregullimi) i mjedisit- setting edukativ</p>	<p>Propozimi i një veprimtarie pa menduar për hapësirën e nevojshme për realizimin e saj mund të rrezikojë dështimin e realizimit të veprimtarisë. P.sh. veprimtaritë me fokus zhvillimin motor, apo veprimtaritë muzikore shpesh kërkojnë hapësira më të gjëra, jo shumë të shpërndara, të sigurta, me dritë dhe të rehatshme (materialet e rregulluara, muret dhe këndet e përshtatura). Është mirë që fëmijët të mund të përdorin të gjitha hapësirat e strukturës. Për më të vegjlit mund të përshtaten hapësirat e klasës duke krijuar kënde të vogla atelier dhe laboratorë.</p>
<p>Burimet njerëzore</p>	<p>Është e nevojshme të përcaktohen nevojat për burimet njerëzore që duhen për realizimin e NE, duke konsideruar edukatorët e çerdhes por mund të mendohet edhe për “edukatorë apo personel ekspert” në një fushë të caktuar (gjuhë e huaj, muzikë, veprimtari psikomotorike, etj.), ose pjesëmarrja e gjyshërve apo vullnetarë për veprimtari si, leximi dhe tregimi i historive/ përallave apo shëtitje në park etj.</p>
<p>Mjetet dhe materialet</p>	<p>Përfshihen të gjitha mjetet dhe objektet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të parashikuara (lexues disqesh, bojrat për piktura, topa për zhvillimin motorik, materiale të pastrukturuara për t’u manipuluar, veshje të ndryshme për lojën me role, gota dhe vazo për lojërat me ujë, etj)</p>
<p>Koha</p>	<p>Është e nevojshme të theksohet se koha për zhvillimin e veprimtarive të NE është fleksibel dhe e përshtatur në bazë të nevojave dhe ritmeve që shfaqin fëmijët e ndryshëm. Duhet pranuar se e gjithë koha që fëmija kalon në çerdhe në të gjitha momentet që e karakterizojnë, rutinat apo veprimtaritë ekstra-rutinë, ka karakter edukativ</p>
<p>Përshkrimi i veprimtarive</p>	<p>Përshkrimi i veprimtarive parashikon specifikimin e: -metodave të punës dhe strategjive që do të përdoren (punë individuale apo në grupe të vogla); -fazat e veprimtarisë; -rregullat që do të vendosen për zhvillimin e veprimtarisë (rregullat e fillimit, zhvillimit dhe përfundimit të veprimtarisë si dhe rregullimi i materialeve në vendete tyre); -lidhje me veprimtaritë e kryera më parë apo me ato që do të pasojnë.</p>
<p>Monitorimi dhe vlerësimi</p>	<p>Monitorimi i veprimtarive përgjatë gjithë fazave të zhvillimit të tyre duke kryer vëzhgime sistematike nga edukatorët të cilët ndihmohen për mbledhjen e të dhënave nga skeda vëzhgimi të parapërgatitura, të cilat mund të shoqërohe me relacione përshkruese, fotografi apo filmime. Ky proces është pjesë e procesit të vlerësimit dhe për të është diskutuar dhe pranuar nga kolegët dhe familjet duke reflektuar bashkarisht nëse do të ketë ndryshime në faza të ndryshme të zhvillimit të veprimtarive.</p>
<p>Reflektime rreth mundësive për përmirësim dhe zhvillime të reja</p>	<p>Njësitë edukative janë të lidhura njëra me tjetrën dhe të gjitha i referohen PE. Nga rezultatet e arritura gjatë zhvillimit të një NE mund të reflektohen dhe /apo propozohen ndryshime në NE të tjera të parashikuara. Gjithashtu NE mund të krijojnë lidhje me projekte të tjera teritoriale apo me struktura të tjera që ofrojnë shërbime për fëmijët e moshës 0-3 vjeç apo edhe për ata të moshës 3-6 vjeç duke reflektuar një vazhdimësi horizontale (trasferime apo pjesëmarrje të të fëmijëve në struktura të ndryshme) ashtu si dhe vertikale (kalimi i fëmijëve në kopësht)</p>

MODELE TË NJËSIVE EDUKATIVE

Titulli: Toke

Fokus-Pritja

- **Qëllimi** – arritja e pavarësisë të fëmijës të moshës 12-24 muaj, në momentin e shkëputjes nga figurat e atashimit. Ky projekt zhvillohet pasi janë përmbyllur fazat e futjes dhe përshtatjes.⁴
- **Motivimi-** Pritja e fëmijës në çerdhe nënkupton të gjitha ato veprimtari që ndërmerren për të lehtësuar ndarjen e fëmijës nga prindi. Është një nga momentet që karakterizohet nga emocione të forta, të rëndësishme si për fëmijën ashtu edhe për prindin, të cilat duhen respektuar dhe në të njëjtën kohë mbështetur dhe udhëhequr me kompetencë. Prindërit jetojnë këto momente me ndjenja komplekse, ata mund të shfaqin lidhje të forta me fëmijët ose jo , por gjithësesi kanë nevojë për mbështetje për të shoqëruar në mënyrë të qetë fëmijën e tyre. Është e domosdoshme të krijohet një klimë pritjeje pozitive për të krijuar marrëdhënie besimi të cilat do të forcohen me kalimin e kohës; është e nevojshme të dëgjohen me kujdes dyshimet dhe pasiguritë që shfaqin prindërit. Gjithashtu, përvoja e përkrahjes së fëmijëve është e rëndësishme të njihet uniciteti dhe origjinaliteti duke nisur nga përshëndetja me emër, përsëritja e disa zakoneve dhe ritualeve të cilat shërbejnë si ura lidhjeje me jetën familjare, mundësia për të mbajtur me vete një objekt të preferuar (objekti tranzicional). Shoqërimi i fëmijës në çerdhe duke u mbajtur për dore favorizon kalimin dhe futjen në strukturë duke treguar se një shkëputje e parë ka ndodhur. Është një përpjekje pavarësie e cila angazhon në të njëjtën mënyrë si prindin ashtu edhe fëmijën.
- **Objektivat e përgjithshëm**
 - ✓ Krijimi i një klime pozitive pritjeje
 - ✓ Favorizimi i ndarjes dhe i krijimit të besimit
 - ✓ Fuqizimi i vetëvlerësimit dhe e sigurisë për veten
 - ✓ Fuqizimi i lidhjes së besimit midis fëmijës dhe edukatores/it
- **Objektivat specifikë**
 - ✓ Fëmija përshëndet prindin
 - ✓ Fëmija hyn vetë në çerdhe
 - ✓ Fëmija ndahet nga objekti tranzicional
- **Përfituesit/target grupi**
 - ✓ tetë fëmijë të grupmoshës 12-24 muaj
- **Hapësira dhe rregullimi i mjedisit (setting) edukativ**
 - ✓ Hapësira e zgjedhur për veprimtarinë edukative është seksioni më afër portës së hyrjes të çerdes. Në çdo strukturë duhet të ketë një zonë ku prindërit apo shoqëruarit e fëmijëve nuk mund të kalojnë, nëse nuk kanë mbulesat e këpucëve. Kjo është hapësira që ndan hapësirën

4. Shiko: Aneks 1: Plan ndërhyrje vazhdimësie vertikale

e edukatorëve nga hapësira e veprimit të prindërve. Nuk ka nevojë për shumë mjete për të mobiluar dhe rregulluar këtë hapësirë; e rëndësishme është të jetë e mirë evidentuar ndarja midis hapësirës së prindërve dhe atë të edukatorëve për të siguruar efikasitet në veprimtaritë edukative.

- **Burimet njerëzore**

- ✓ Edukatorja/kujdestarja e grupit

- **Mjetet dhe materialet që do përdoren**

- ✓ Një kukull e butë, melodi të ndryshme, një kuti me kapak të madh dhe me ngjyra, një tapet i butë me jastëkë të mëdhenj.

- **Koha**

- ✓ rreth 10 minuta

- **Përshkrimi i veprimtarisë/ve**

Edukatorja/kujdestarja kur vjen fëmija shkon e takon dhe e përshëndet; i prezanton një personazh, kukullën e butë (p.sh. rosakun Kua) – i cili do që të shoqërojë fëmijën gjatë ditës që do të kalojë në çerdhe. Kua është lozonjar, i dashur dhe do ta shoqërojë fëmijën përgjatë gjithë vitit. Ai sjell çdo ditë një kuti dhuratë me surpriza për fëmijën, të cilat fëmija duhet t'i zbulojë bashkë me Kua-në. Në kuti vihen objekte të cilat do të jenë në qendër të veprimtarive ditore (p.sh një libër për të lexuar së bashku, një krem, një shall, një pako me miell, etj.). Nëse fëmija tregon gatishmëri, përshëndet nënën apo babain dhe shkon vetë të hapë kutinë ose i ftuar nga edukatorja/kujdestarja ndihmon këtë të fundit për të hapur kutinë së bashku. Nëse fëmija nuk tregon gatishmëri, afrohet nga edukatorja/kujdestarja, e cila do të kërkojë ta përkëdhelë fëmijën në trup me anë të kukullës, edhe duke u ulur përtokë së bashku në një kënd të krijuar posaçërisht për pritjen. Mund të ndodhë që më shumë se një fëmijë të vijë në çerdhe në një ditë kohë dhe atëhere, duhet të menaxhohet hapja e kutisë së surprizave së bashku. Kur rituali është kuptuar nga fëmija, mundet që hapja e kutisë të zhvendoset në një mjedis tjetër më të brendshëm, për të nxitur futjen e fëmijës në kërkim të kutisë me surpriza. Më tutje, mund të mendohet që hapja e pakove me surpriza të bëhet në grup, ku rituali bëhet më skenik dhe pasurohet me elementë të tjetër si muzika me volum më të lartë në sfond dhe zhurma e dauleve që paralajmërojnë hapjen e kutisë me surpriza.

- **Monitorimi dhe vlerësimi**

Monitorimi kryhet duke përdorur vëzhgimin dhe mbledhjen e të dhënave me anë të një skede sasiore në fushat e mëposhtme: fusha e pavarësisë, fusha e pjesëmarrjes, fusha e emocioneve (Shiko skedën 1). Përdorimi i një skede vëzhgimi cilësore (shiko skedën 2) sjell të dhëna rreth një vlerësimi të përgjithshëm të sjelljes në lidhje me pavarësinë dhe detyrën e dhënë, duke shtuar kështu elementë të tjerë vëzhgimit.

- **Reflektime rreth mundësive për përmirësim dhe zhvillime të reja**

Momenti i përshëndetjes në kohën e pritjes është shumë delikat dhe i vështirë, si për çështjet që i përkasin sferës emocionale, të cilat aktivizohen, ashtu edhe për çështje menaxhuese, duke ditur që fëmijët vijnë në orare shumë të ndryshme njëri nga tjetri dhe familjet shfaqin mënyra të ndryshme për menaxhimin e ndarjes. Respektimi i kohës së fëmijës nga prindërit në momentin e mëngjesit, nga koha kur zgjohen deri në momentin kur shkojnë në çerdhe, është pak i praktikuar dhe ka prirje të ngutë fëmijën për të arritur në kohë në çerdhe. E njëjta situatë prezantohet

shpesh edhe në momentin e ribashkimit prind –fëmijë, i cili po ashtu shfaqet si moment i ngutshëm dhe i ngarkuar me ankth dhe stres familjar. Mund të mendohet që personazhi i cili pret fëmijën në çerdhe, i lë këtij të fundit diçka që fëmija mund ta marrë me vete në shtëpi për të lehtësuar rikthimin dhe ribashkimin e tij, përsëri të nesërmen në çerdhe, duke krijuar kështu një urë emocionale mes çerdhes dhe familjes.

Skeda 1

Skedë vëzhgimi (pritja) (përshtatur nga Restiglian, 2012)

Emri dhe mbiemri		Mosha në muaj	
Data e hyrjes		Mosha në muaj në hyrje	
Edukatorja:		Data:	Vendi:
Veprimtaria:		Ora e fillimit	Ora e përfundimit

Fusha e pavarësisë

	Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Asnjëherë
Fëmija:	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Hyn vetë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Hyn duke kapur për dore edukatoren	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Hyn i nxitur verbalisht	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Hyn duke u mbajtur në krah nga edukatoria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Lëshon objektin tranzicional me nxitje verbale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Lëshon vetë objektin tranzicional	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Fusha e pjesëmarrjes

Fëmija:				
Ndjek propozimin e edukatores	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ndjek pjesërisht propozimin e edukatores	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Nuk ndjek propozimin e edukatores	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Fusha emocionale

Fëmija:				
Përsëndet vetë prindin	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përsëndet prindin duke u nxitur verbalisht	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përsëndet prindin duke u nxitur fizikisht	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Mundohet të kapet pas prindit në çdo lloj mënyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Qan dhe shfaqet i shqetësuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Injoron prindin	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Vëzhgime të tjera:

Skeda 2

Skedë vëzhgimi individuale (pritja) (përshtatur nga Restiglian, 2012)

Emri i fëmijës			
Mosha në muaj:		Frekuenton çerdhen prej	
Veprimtaria/të:			
Kohëzgjatja e veprimtarisë:			
Kohëzgjatja e vëzhgimit:			
Karakteristika të sjelljes së fëmijës gjatë veprimtarisë			

1. Shëno se si fëmija krijon lidhje me trupin e vet kur i propozohet veprimtaria

2. Shëno se si fëmija krijon lidhje me fëmijët e tjerë kur i propozohet veprimtaria

3. Shëno si hyn në marrëdhënie fëmija me edukatoren/kujdestaren kur i propozohet veprimtaria

4. Shëno si sillen fëmija, çfarë bën në mënyrë të pavarur, çfarë bën kur nxitet verbalisht, kur i tregohet në model, çfarë bën kur me ndihmë

5. Shëno si fëmija krijon lidhje me kontekstin e përgatitur

6. Trego si angazhohet fëmija në lidhje me detyrën që i është dhënë nga edukatorja/kujdestarja duke evidentuar gjendjet emocionale dhe shprehje fizike

7. Trego në vlera kohore përqëndrimin e fëmijës për dorëzimin e detyrës

8. Vëzhgime të tjera

Edukatorja/kujdestarja:

Data:

PLAN NDËRHYRJE VAZHDIMËSIE VERTIKALE (NGA ÇERDHJA NË KOPËSHT)

Institucioni _____

Lloji i shërbimit: Çerdhe

A)-Pritja

Mars – hapja e regjistrimeve
ditë e hapur në çerdhe

Qershor - asamble me të gjitha familjet e fëmijëve të regjistruar
çështje të asamblesë:
1) prezantimi i personelit dhe e strukturës organizative me pjesëmarrje të përfaqësues
të Drejtorisë për Arsimin Parashkollor
2) prezantimi i shërbimit të çerdhes me pjesëmarrje të koordinatorit pedagogjik
3) sqarimi i rreth afateve kohore të dorëzimit të dokumentave të nevojshëm për futjen
në çerdhe
4) vizitë e mjediseve të çerdhes dhe shpjegimi i përdorimit të tyre

Shtator - **java e parë:** dy ditët e para për rregullimin e seksioneve (këndeve)
tre ditët në vazhdim – intervista individuale me prindërit
java e dytë: fillimi i futjes së fëmijëve që frekuentonin çerdhen vitin e kaluar dhe futja
e një grupi fëmijësh të rinj, të cilët qëndrojnë në çerdhe në mënyrë progresive duke
shtuar kohën e qëndrimit (nga një orë ditën e parë, në tre orë ditën e pestë duke
konsumuar dhe një vakt ditën e gjashtë dhe nga dita e 11 qëndrim edhe në orët e pas
drekës)

Shtator/tetor - vazhdon futja e grupeve të vogla të fëmijëve për secilin seksion me faza
15 ditore (siç përshkruhet më lart)

Tetor/nëntor - takim me familjet në grupe të vogla për të diskutuar për fazën e futjes

Nëntor - zgjedhjet e përfaqësuesve të prindërve

Janar - Takim i seksionit me temë “verifikimi i futjes” dhe prezantimi i planit të punës për
periudhën janar-qershor

Maj/qershor - festa e fund vitit organizuar nga prindërit
intervista individuale të fund vitit
takim i seksionit me temë “verifikimi i planit të punës” me prezantime filmike

Përfundimi i çerdhes

Deri në mars - përpunimi i projektit për transferimin i dakordësuar midis edukatorëve të çerdhes dhe mësuesve të kopshtit

deri në qershor –takim midis edukatorëve dhe mësuesve për verifikimin e veprimtarive të projektit dhe kalimin e informacionit të grup-seksionit; përgatitja e materialeve për të shpënë në kopësht sipas projektit të rënë dakord kalimi i materialeve të përgatitura nga prindërit takime midis fëmijëve të çerdhes dhe kopshtit

deri në tetor - takime me mësuesit e kopshtit për shkëmbim opinionesh rreth fëmijës verifikimi i projektit për transferim i realizuar

VËZHIMI DHE VLERËSIMI

Vëzhgimi dhe vlerësimi, po aq sa edhe dokumentimi, janë elemente themelore të hartimit të projekteve edukative. Të dyja këto procese duhet të kryhen në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.

Vëzhgimi i rregullt i përvojave që realizohen brenda konteksteve edukative, në mënyrë spontane mes fëmijëve me njëri-tjetrin apo mes fëmijëve dhe të rriturve, përbën bazën e domosdoshme për organizimin apo korrigjimin e ndërhyrjes së operatorëve. Vëzhgimi, në fakt, i përdorur në mënyrë të përditshme, përfaqëson mjetin kryesor për të njohur nevojat e individëve dhe të grupit dhe për të monitoruar dinamikat e brendshme të mjedisit edukativ.

Vëzhgimi pedagogjik përshkruan pa interpretuar, pra nuk mat dhe rrjedhimisht përjashton përdorimin e kriterëve të ngurta sasiorë, duke preferuar në vend të tyre kontekstualizimin e sjelljeve me qëllimin për të riekulibruar propozimet dhe ndërhyrjet.

Evoluimi i vazhdueshëm natyral i faktorëve të brendshëm në çerdhet dhe kopshtet, mes të cilëve edhe evoluimi i marrëdhënieve ndërpersonale dhe profesionale, kërkon një proces konstant të vlerësimit të kontekstit edukativ. Vlerësimi i paraprin, shoqëron dhe pason projektet formuese, parashikon veprime periodike verifikimi, në mes të veprimtarive apo në përfundim të tyre, të zhvilluara në mënyrë të njëkrahshme apo të shumëkrahshme, promovon bilancin kritik të përvojës së kryer dhe orienton ato të ardhshme, duke marrë një funksion spikatës formues dhe stimulues të përmirësimit të vazhdueshëm.

Vlerësimi ka të bëjë me të gjithë aspektet e shërbimeve të edukimit, që nga të nxënëti deri te mirëqenia e fëmijëve, që nga profesionalizmi i personelit deri të organizimi dhe cilësia e shërbimit. Ai duhet parë nën një prizëm krejtësisht formativ, si mundësi për të njohur, bashkëndarë dhe rinegociuar domethëniet e projekteve formative.

Vlerësimi është një proces që u kërkohet të gjithë atyre që, me funksionet dhe rolet e tyre të ndryshme, janë të angazhuar në sistemin e integruar të edukimit dhe konfigurohet si një veprim publik. Ai parashikon pjesëmarrjen e grupeve të punës, grupeve të koordinimit pedagogjik, grupeve të koordinimit organizativo-menaxhues dhe familjeve.

DOKUMENTIMI SI REFLEKTIM MBI PËRVOJËN

Dokumentimi është një mjet që i bën të mundur grupit të punës që të përpunojë dhe transformojë përvojat e jetuara në një të dhënë kulturore, duke ndërtuar kujtesën e ngjarjeve dhe projekteve e duke dhënë mundësinë për të reflektuar mbi to për të vlerësuar koherencën e tyre me qëllimet edukative. Si i tillë, dokumentimi përfshihet brenda kuadrit të projektimit të veprimit edukativ, duke përfaqësuar një pjesë të pandarë të tij dhe jo një element anësor apo përmbyllës. Ai bën të mundur që t'u jepet një vlerë e të bëhen të qartë e të vlerësueshëm proceset e të nxënimit individual dhe në grup të fëmijëve dhe të rritur, duke i shndërruar këta në pasuri të përbashkët.

Për të ruajtur dobishmërinë dhe vlerën formuese të tij, është e nevojshme që të garantohet edhe karakteri i tij sistematik, duke përcaktuar kritere, afate dhe modalitete të qarta e të konsoliduara në kohë dhe duke planifikuar momente për analizimin e tij.

Përveç domethënies nga pikëpamja e brendshme, dokumentimi bart edhe një qëllim të jashtëm, sepse bën të mundur përhapjen e ideve dhe përvojave duke kontribuar në grumbullimin dhe asimilimin e një kulture të bashkëndarë të punës me fëmijët.

Dokumentimi është edhe një instrument i dobishëm për krijimin e vijimësisë edukative me familjet duke shërbyer si një fill lidhës mes përvojave të kontekstit familjar dhe atyre të kontekstit edukativo-shkollor, me qëllimin për të garantuar projekte dhe ndërhyrje edukative harmonike dhe të orientuar kah shkëmbimi i informacioneve dhe përballja në mbështetje të përvojës së rritjes së çdo fëmije.

Veç kësaj, dokumentimi i përgjigjet realizimit të një vijimësie vertikale mes institucioneve të ndryshme (çerdheve/ kopshteve/ institucionet e arsimit fillor/ shërbimeve territoriale të edukimit).

ROLET DHE FUNKSIONET E PERSONELIT NË ÇERDHE

Drejtuesi i institucionit të çerdhes

Drejtuesi i institucionit të çerdhes është përgjegjës i çerdhes dhe i realizimit korrekt të detyrave institucionale që lidhen me projektin edukativ. Drejtuesi i çerdhes kujdeset dhe garanton organizimin e brendshëm, menaxhimin ekonomik dhe administrativ të çerdhes. Drejtuesi i çerdhes, mbikëqyr punën e koordinatorit pedagogjik dhe menaxhon personelin dhe përfituesit e shërbimit.

Roli i koordinimit pedagogjik (koordinatori pedagogjik)

Koordinimi pedagogjik ka një funksion të rëndësishëm për shërbimet dhe kualifikimin e tyre të vazhdueshëm. **Grupi i koordinimit pedagogjik** përbëhet nga specialist, veprimtaria koordinuese e të cilëve ka për detyrë të vlerësojë lidhjet mes mjediseve edukativo-shoqërore dhe sferave administrativo-menaxhuese, me qëllimin për të promovuar një njësim dhe koherencë më të mirë të Projektit Pedagogjik.

Veç kësaj, grupi i koordinimit ka përgjegjësinë të promovojë kërkimin në bashkëpunim me universitetin dhe me agjenci të tjera të territorit, të sjellë risi dhe të ofrojë formim, duke ndihmuar në përpunimin

e modeleve orientuese të hartimit të projekteve të edukimit të çerdheve dhe kopshteve. Koordinimi pedagogjik është mjeti kryesor përmes të cilit sistemi promovon cilësinë e shërbimeve për fëmijët.

Një nga detyrat e koordinatorit pedagogjik është të kërkuarit e një marrëdhënieje konstante bashkëpunimi me territorin, mbështetja e sistemit të integruar të shërbimeve dhe kërkimin e burimeve kulturore dhe formuese aktive në qytet.

Koordinatori pedagogjik përfaqëson një figurë qendrore në sistemin e programimit, rregullimit dhe vlerësimit të shërbimeve. Një vëmendje e veçantë i duhet dhënë, përveç profilit profesional, edhe vijimësisë së koordinimit, në mënyrë të tillë që ai të mund të mbështetet në detyra fikse dhe të pandërprera.

Koordinatori duhet të ketë **si kompetenca pedagogjike** (për të kryer detyrat që lidhen me mbështetjen, mbikëqyrjen, vlerësimin dhe formimin) ashtu edhe **menaxhuese** (që kanë të bëjnë me modalitetet e organizimit, oraret e hapjes së shërbimeve dhe marrëdhënien e grupit të punës me bashkëbisedues të ndryshëm të jashtëm).

Edhe në marrëdhënien me familjet, koordinatori pedagogjik kryen **funksione këshillimi edukativ dhe mbështetje të prindërimit**, duke konfirmuar perceptimin e përgjithshëm se shërbimet për fëmijët janë hapësira dialogu dhe kërkimi të bashkëpërgjegjësisë edukative.

Bashkia garanton, edhe përmes përdorimit të fondeve rajonale për kualifikimin e ofertës formative për grupmoshën 3-5 vjeç dhe një marrëveshjeje specifike në rrjet mes institucioneve shkollore të interesuara, aktivizimin e funksionit të koordinimit pedagogjik për kopshtet shtetërore.

Edukatori në çerdhe

Edukatori në çerdhe ka përgjegjësi për ndërhyrjet edukative dhe garanton përmbushjen e nevojave të fëmijëve që lidhen me:

- veprimtaritë social-pedagogjike dhe rekreative
- të ushqyerin
- higjienën personale
- sigurinë

duke iu referuar teknikave psiko-pedagogjike të fëmijërisë me qëllim përmbushjen e nevojave që shfaqen në këtë moshë, si dhe duke ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe bashkëpunuese me prindërit.

Personeli edukativ në veçanti:

- ndërton marrëdhënie që mbështesin mirëqenien e prindërve dhe fëmijëve
- pozicionohet si figurë referimi për fëmijët dhe familjet e tyre
- kujdeset për futjen graduale të fëmijës në çerdhe
- garanton dhe mbështet marrëdhënien prind-edukator-fëmijë
- mbështet dhe vlerëson pjesëmarrjen e prindërve duke i informuar vazhdimisht për zhvillimet e veprimtarive dhe progresin e fëmijës.

Edukatorët kanë për detyrë të realizojnë programin e ndërhyrjeve dhe projekteve të menduara dhe hartuara nga kolektivi. Gjithashtu, edukatorët kujdesen për hapësirat, mjetet dhe lodrat që ndihmojnë

zhvillimin e fëmijës, garanton që hapësirat të jenë të qeta dhe të kënaqshme, me një vëmendje të veçantë për vaktet, gjumin dhe veprimtaritë e udhëhequra.

Kërkohet një përditësim i njohurive nga vetë edukatorët në mënyrë sistematike, si dhe formim i vazhduar profesional-edukativ i tyre. (Associazione Minori e Futuro, 2019)

Personeli ndihmës në çerdhe

Personelit ndihmës në çerdhe i atribuohen detyra specifike si: pastrimi i lodrave dhe orendive, rregullimi i mjediseve të brendshme dhe të jashtme, pastrimi i strukturës së brendshme dhe të jashtme të godinës, personeli i kuzhinës që merret me përgatitjen e vakteve, duke ndjekur menunë e miratuar.

BIBLIOGRAFIA

- Associazione Minori e Futuro. (2019). Minori e Futuro . Retrieved ottobre 2019, from minoriefuturo.org.
- Becchi, E., Bondioli, A., Ferrari, M., & Gariboldi, A. (2002). *Idee guida del nido d'infanzia*. Bergamo: Bergamo: Edizioni Junior.
- Bjorklund, D. F. (2000). *Children's Thinking: Developmental Function and Individual Differences*. California: California: Wadsworth.
- Brazelton, T. B. (1992). *Touchpoints: Your child's emotional and behavioral development*. New York: Perseus.
- California Department of Education. (2012). *California Infant/Toddler Curriculum Framework*. Sacramento: California Department of Education/Child Development Division (CDE/CDD).
- Cappuccio, G. (2008). *PROGETTARE PERCORSI EDUCATIVO-DIDATTICI AL NIDO*. Editore: Junior.
- Chen, J.-Q. (2002). Class Lecture. In *Course: Cognition, Language, and Play*. Chicago, Illinois: Erikson Institute.
- Eckman, P. (1992). *An argument for Basic Emotions. Cognition and emotion (3/4)*. Lawrence Erlbaum Associates Limited.
- European Commission. (2014). *Proposal for key principles of a Quality Framework for Early Childhood Education and Care*. Directorate-General for Education and Culture.
- Gebhard, B. (2009). *Early experiences matter: a guide to improved policies for infants and toddlers*. Retrieved from Zero to Three:
http://main.zerotothree.org/site/DocServer/Policy_Guide.pdf?docID=8401
- Gonzalez-Mena, J. (2001). *Multicultural issues in child care*. California: California: Mayfield Publishing Group.
- Gopnik, A., Meltzoff, A.N., & Kuhl, P.K. (1999). *The scientist in the crib*. New York: New York: Perennial.
- ISSA. (2016). *A Quality Framework for Early Childhood Practice in Services for Children under Three Years of Age*. ISSA – International Step by Step Association.
- IZHA & UNICEF. (2016). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor*. Tiranë: IZHA.
- Karen, R. (1998). *Becoming Attached: First Relationships and How They Shape Our Capacity to Love*. New York: New York: Oxford University Press.
- M. Cole, P. Hakkarainen & M. Bredikyte. (2012., October). *Culture and Early Childhood Learning*. Retrieved February 04, 2020, from Culture: <http://www.child-encyclopedia.com/sites/default/files/dossiers-complets/en/culture.pdf>.

- MASHT. (2018). Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Prishtinë : Qeveria e Kosovës & MASHT.
- OECD. (2001). Starting strong: Early childhood education and care. Paris: OECD Publishing.
- Restiglian, E. (2012). Progettare al nido. Teorie e pratiche educative. Roma: Carroci Faber.
- Rockel, J. (2009). A pedagogy of care: moving beyond the margins of managing work and minding babies. Australian Journal of Early Childhood, 34.
- S. Vosniadou. (2001). How children learn. Brussels, Belgium: International Bureau of Education-UNESCO.
- Shelov, S.P. & Altman, T.R. (2009). Caring For Your Baby and Young Child, Birth to Age Five. .American Academy of Pediatrics.
- Shulman, Bernard H. & Mosak, Harold H. (1977, May). Birth order and ordinal position. Journal of Individual Psychology, Vol 33((1)).
- Stern, D. (1985). The interpersonal world of the infant. New York: New York: Basic Books.
- UNESCO. (2014). Early childhood care and education: Addressing quality in formal pre-primary learning environments . Paris: In press. Paris: UNESCO.
- Unicef & Ministria e Shëndetësisë. (2005). Arti i rritjes së fëmijëve. Tiranë: Pegi.
- UNICEF. (2014). Protecting children's rights. Retrieved from http://www.unicef.org/crc/index_protecting.html.
- UNICEF. (2018). Learning through play-Strengthening learning through play in early childhood education programmes. New York: UNICEF.
- University of Illinois. (2012). Illinois Early Learning Guidelines For Children Birth to Age Three. Illinois: Robert R. McCormick Foundation.
- Webster-Stratton, C. (1999). How to promote children's social and emotional competence. London: Paul Chapman Publishing Ltd.




Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)

 Savethechildrenal

 SaveChildrenAlb

 savethechildreninalbania